



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# NDIHMËTAR PËR KUPTIMIN E XHUZIT TRIDHJETË

Zejd Abdullah Omer

HYRJE .....	21
PARATHËNIE .....	22
SUREJA “EN NEBE‘Ë” .....	23
PËRMBAJTJA E SURES .....	24
KUPTIMI I FJALËVE.....	24
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	25
Ç‘NA MËSOJNË AJETET .....	26
PYETJE DHE USHTRIME.....	26
AJETET 17 - 30 .....	27
KUPTIMI I FJALËVE.....	27
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	28
Ç‘NA MËSOJNË AJETET .....	29
PYETJE DHE USHTRIME.....	29
AJETET 31 – 40 .....	30
KUPTIMI I FJALËVE.....	31
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	31
Ç‘NA MËSOJNË AJETET .....	32

PYETJE DHE USHTRIME.....	33
SUREJA "EN NAZIATË " .....	33
PËRMBAJTJA E SURES .....	34
KUPTIMI I FJALËVE.....	34
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	35
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	36
PYETJE DHE USHTRIME.....	37
AJETET 15 - 26 .....	37
KUPTIMI I FJALËVE.....	38
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	38
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	40
PYETJE DHE USHTRIME.....	40
AJETET 27 - 33.....	41
KUPTIMI I FJALËVE.....	41
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	41
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	42
PYETJE DHE USHTRIME.....	42

AJETET 34 - 46.....	43
KUPTIMI I FJALËVE.....	43
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	44
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	45
PYETJE DHE USHTRIME.....	45
SUREJA "ABESE " .....	46
PËRMBAJTJA E SURES .....	46
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	47
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	48
PYETJE DHE USHTRIME.....	49
AJETET 17 - 23 .....	49
KUPTIMI I FJALËVE.....	50
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	50
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	51
PYETJE DHE USHTRIME.....	51
AJETET 24 - 32.....	52
KUPTIMI I FJALËVE.....	52

KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	52
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	53
PYETJE DHE USHTRIME.....	53
AJETET 33 - 42.....	54
KUPTIMI I FJALËVE.....	54
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	55
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	55
PYETJE DHE USHTRIME.....	56
SUREJA "ET TEKUIR " .....	57
PËRMBAJTJA E SURES .....	57
KUPTIMI I FJALËVE.....	58
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	58
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	59
PYETJE DHE USHTRIME.....	59
AJETET 15 - 29 .....	60
KUPTIMI I FJALËVE.....	61
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	61

Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	62
PYETJE DHE USHTRIME.....	63
SUREJA "EL INFITAR " .....	63
PËRMBAJTJA E SURES .....	64
KUPTIMI I FJALËVE.....	64
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	65
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	66
PYETJE DHE USHTRIME.....	66
SUREJA "EL MUTAFFIFIN" .....	67
PËRMBAJTJA E SURES .....	68
KUPTIMI I FJALËVE.....	69
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	69
Ç'NA MËSOJNË HADITHET.....	70
PYETJE DHE USHTRIME.....	71
AJETET 18 - 36 .....	71
KUPTIMI I FJALËVE.....	72
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	73

Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	74
PYETJE DHE USHTRIME.....	75
SUREJA "EL INSHIKAK " .....	75
PËRMBAJTJA E SURES .....	76
KUPTIMI I FJALËVE.....	76
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	77
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	78
PYETJE DHE USHTRIME.....	78
AJETET 16 - 25 .....	79
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	80
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	81
PYETJE DHE USHTRIME.....	81
SUREJA "EL BURUXH " .....	82
PËRMBAJTJA E SURES .....	82
KUPTIMI I FJALËVE.....	83
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	83
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	86

PYETJE DHE USHTRIME.....	86
AJETET 12 - 22 .....	87
KUPTIMI I FJALËVE.....	88
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	88
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	89
PYETJE DHE USHTRIME.....	89
SUREJA "ET TARIK " .....	90
PËRMBAJTJA E SURES .....	91
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	91
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	92
PYETJE E USHTRIME .....	92
AJETET 11 - 17.....	93
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	93
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	94
PYETJE DHE USHTRIME.....	94
SUREJA "E'LA " .....	95
PËRMBAJTJA E SURES .....	96

KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	96
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	98
PYETJE DHE USHTRIME.....	98
AJETET 14 - 19 .....	99
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	99
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	100
PYETJE DHE USHTRIME.....	100
SUREJA "EL GASHIJE" .....	101
PËRMBAJTJA E SURES .....	102
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	102
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	104
PYETJE DHE USHTRIME.....	104
AJETET 17 - 26 .....	105
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	105
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	107
PYETJE DHE USHTRIME.....	107
SUREJA "EL FEXHR" .....	108

PËRMBAJTJA E SURES .....	108
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	109
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	110
PYETJE DHE USHTRIME.....	111
AJETET 15 - 30 .....	111
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	112
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	113
PYETJE DHE USHTRIME.....	114
SUREJA "EL BELED ".....	115
PËRMBAJTJA E SURES .....	116
KUPTIMI I FJALËVE.....	116
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	116
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	117
PYETJE DHE USHTRIME.....	118
AJETET 11 - 20.....	118
KUPTIMI I FJALËVE.....	119
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	119

Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	120
PYETJE DHE USHTRIME.....	121
SUREJA "ESH SHEMS" .....	122
KUPTIMI I FJALËVE.....	123
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	123
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	124
PYETJE DHE USHTRIME.....	124
AJETET 11 - 15.....	125
KUPTIMI I FJALËVE.....	126
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	126
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	127
PYETJE DHE USHTRIME.....	128
SUREJA "EL LEJL" .....	128
PËRMBAJTJA E SURES .....	129
KUPTIMI I FJALËVE.....	129
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	130
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	131

PYETJE DHE USHTRIME.....	131
AJETET 12- 21.....	132
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	133
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	134
PYETJE DHE USHTRIME.....	134
SUREJA “ED DUHA” .....	135
PËRMBAJTJA E SURES .....	135
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	136
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	138
PYETJE DHE USHTRIME.....	139
SUREJA “ESH SHERH” .....	140
PËRMBAJTJA E SURES .....	140
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	141
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	142
PYETJE DHE USHTRIME.....	143
SUREJA “ET TIN” .....	143
PËRMBAJTJA E SURES .....	144

KUPTIMI I FJALËVE.....	144
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM SURES.....	145
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	146
PYETJE DHE USHTRIME.....	147
SUREJA “EL ALAK” .....	148
PËRMBAJTJA E SURES .....	148
KUPTIMI I FJALËVE.....	149
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	149
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	150
PYETJE DHE USHTRIME.....	151
AJETET 9 - 19 .....	151
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	152
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	154
PYETJE DHE USHTRIME.....	155
SUREJA “EL KADËR” .....	155
PËRMBAJTJA E SURES .....	156
KUPTIMI I FJALËVE.....	156

KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE .....	157
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	157
PYETJE DHE USHTRIME.....	158
SUREJA "EL BEJJINE" .....	158
PËRMBAJTJA E SURES .....	160
KUPTIMI I FJALËVE.....	160
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	160
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	162
PYETJE DHE USHTRIME.....	162
SUREJA "EZ ZELZELE " .....	163
KUPTIMI I FJALËVE.....	164
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	164
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	165
PYETJE DHE USHTRIME.....	166
SUREJA "EL ADIJATË " .....	167
PËRMBAJTJA E SURES .....	168
KUPTIMI I FJALËVE.....	168

KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	168
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	169
PYETJE DHE USHTRIME.....	170
SUREJA "EL KARIA" .....	170
PËRMBAJTJA E SURES .....	171
KUPTIMI I FJALËVE.....	171
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	172
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	172
PYETJE DHE USHTRIME.....	173
SUREJA "ET TEKATHUR" .....	174
PËRMBAJTJA E SURES .....	174
KUPTIMI I FJALËVE.....	175
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	175
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	176
PYETJE DHE USHTRIME.....	178
SUREJA "EL ASR " .....	178
PËRMBAJTJA E SURES .....	179

KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	179
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	180
PYETJE DHE USHTRIME.....	181
SUREJA "EL HUMEZE " .....	181
PËRMBAJTJA E SURES .....	182
KUPTIMI I FJALËVE.....	182
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	183
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	184
PYETJE DHE USHTRIME.....	184
SUREJA "EL FIL" .....	185
PËRMBAJTJA E SURES .....	185
KUPTIMI I FJALËVE.....	185
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	186
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	187
PYETJE DHE USHTRIME.....	188
SUREJA "KUREJSH " .....	188
PËRMBAJTJA E SURES .....	189

KUPTIMI I FJALËVE.....	189
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	190
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	190
PYETJE DHE USHTRIME.....	191
SUREJA “EL MAUN ” .....	192
PËRMBAJTJA E SURES .....	192
KUPTIMI I FJALËVE.....	192
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	193
Ç’NA MËSOJNË AJETET .....	194
PYETJE DHE USHTRIME.....	194
SUREJA “EL KEUTHER ” .....	195
PËRMBAJTJA E SURES .....	195
KUPTIMI I FJALËVE.....	195
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	196
SUREJA “EL KAFIRUN ” .....	196
PËRMBAJTJA E SURES .....	197
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	197

Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	198
PYETJE DHE USHTRIME.....	199
SUREJA "EN NASR " .....	199
PËRMBAJTJA E SURES .....	200
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	200
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	201
PYETJE DHE USHTRIME.....	202
SUREJA "EL MESED" .....	202
PËRMBAJTJA E SURES .....	203
KUPTIMI I FJALËVE.....	203
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	204
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	205
PYETJE DHE USHTRIME.....	205
SUREJA "EL IHLAS " .....	206
PËRMBAJTJA E SURES .....	206
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	207
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	208

PYETJE DHE USHTRIME.....	208
SUREJA "EL FELEK ".....	209
PËRMBAJTJA E SURES .....	210
KUPTIMI I FJALËVE.....	210
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	210
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	212
PYETJE DHE USHTRIME.....	212
SUREJA "EN NAS ".....	213
KUPTIMI I FJALËVE.....	214
KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES .....	214
Ç'NA MËSOJNË AJETET .....	215
PYETJE DHE USHTRIME.....	216

## HYRJE

Falënderimi i takon All-llahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu, s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë Ai, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç All-llahut, i Cili është Një, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

“O ju që besuat, kini frikë All-llahun me një sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni pos vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë).” (3:102)

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë All-llahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.” (4:1)

“O besimtarë, përmbajuni mësimëve të All-llahut dhe thoni fjalë të drejta. Ai (All-llahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tuaja, e kush respekton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh.” (33:70,71).

Thënia më e vërtetë është thënia e All-llahut, kurse udhëzimi më i mirë, udhëzimi i Muhammedit. Veprat më të këqija janë ato të shpikurat, andaj çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është lajthitje nga Rruga e Vërtetë, kurse çdo lajthitje përfundon në xhehenem.

## PARATHËNIE

Lavdërimet i takojnë vetëm All-llahut të Madhërishëm, i Cili zbriti Kur'anin e Shenjtë për t'i nxjerrë njerëzit nga humbja e për t'i udhëzuar ata në rrugën e drejtë. Paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi Muhammedin, më të fundin e të Dërguarve dhe të Profetëve, i cili e përcolli Kur'anin te njerëzit. All-llahu qoftë i kënaqur me shokët e tij besnikë, të cilët e mbrojtën këtë Kur'an.

Këtë tefsir<sup>1</sup> e hartuam në mënyrë që Kur'ani i Shenjtë të kuptohet më lehtë. Ky xhuz, si të gjithë xhuzet e tjerë, ka të veçantën e tij. Ata të cilët dëshirojnë t'i përkushtohen Kur'anit duhet të fillojnë nga ky xhuz. Xhuzi përmban 37 sure, në të cilat flitet për shtyllat e Islamit dhe themelet e Teuhidit.

Të mos mendojë ndokush se, meqë suret e këtij xhuzi janë të shkurtra, ato kuptohen lehtë; përkundrazi, mund të mos kuptohen lehtë.

---

*1) Komentimi i Kur'anit.*

*Poshtëshënimet janë të redaktorit.*

Tefsiri përfshin pesë çështje:

1. Përmbajtjen e sures, që e ndihmon lexuesin të kuptojë thelbin e saj.
2. Kuptimin e fjalëve. Është shpjeguar kuptimi i fjalëve të paqarta.
3. Komentimin e përgjithshëm të ajeteve. Është bërë një komentim i kuptueshëm, duke iu larguar fjalëve të huaja e të vështira dhe duke ruajtur kuptimin e asaj që është në Kur'an.
4. Ç'na mësojnë ajetet. Tregohet ç'na mësojnë ajetet, për të lehtësuar kuptimin e qëllimit të tyre.
5. Pyetje dhe ushtrime.

Komentimi i sureve përfundon me disa pyetje.

Suret e gjata i kemi ndarë në pjesë, sipas temave që trajtojnë.

Shpresoj, që nga ky libër të përfitojnë shumë lexues, të cilët duan ta kuptojnë Kur'anin e Shenjtë.

Autori

## **SUREJA “EN NEBE’Ë”**

(E zbritur në Mekë, ka 40 ajete)

Ajetet 1 - 16

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për çfarë e pyesin njëri-tjetrin? 2. Për lajmin e madh tronditës. 3. Me të cilin ata janë në kundërshtim. 4. Jo, të mos pyesin, sepse ata do ta kuptojnë! 5. Përsëri, jo, sepse ata do ta kuptojnë. 6. A nuk e bëmë Ne tokën të përshtat-shme (për të jetuar)? 7. Ndërsa malet shtylla? 8. Dhe Ne ju krijuam ju në çifte. 9. Dhe gjumin tuaj ua bëmë për pushim. 10. Natën ua bëmë mbulesë, 11. Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim. 12. Ne kemi krijuar mbi ju një shtatëshe të fortë. 13. Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron. 14. Dhe prej reve kemi lëshuar shi të madh. 15. Me të cilin rrisim drithëra e bimë. 16. E kopshte të dendura.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për Ditën e Kijametit e për xhenetin e xhehene-min dhe jep argumente për fuqinë e All-llahut të Madhërishëm.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Për çfarë pyesin ata - Për çfarë e pyesin femohuesit (qafirët) njëri-tjetrin.

Lajmin e madh tronditës - Lajmin e Ditës së Gjykimit.

Një shtatëshe të fortë - Shtatë qiej të lidhur fort me njëri-tjetrin.

Ndriçues që flakëron - Dielli.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Në fillim të sures All-llahu i Madhërishtëm i qorton qafirët, duke mohuar mendimet dhe dyshimet e tyre për Ditën e Kijametit. All-llahu thotë se për çdo gjë, që pyesin njëri-tjetrin ose që e bisedojnë mes tyre ata e kanë gabim, sepse disa prej tyre nuk e besojnë atë, kurse disa dyshojnë në të. Prandaj, edhe mendimet e tyre janë të pavlera. Është me të vërtetë e habitshme që qafirët mohojnë Ditën e Ringjalljes dhe kthimin e tyre tek All-llahu. All-llahu i Madhërishtëm siguron se do të vijë ai çast, kur do të vërtetohet thënia për Ditën e Kijametit.

All-llahu i Madhërishtëm është Fuqplotë mbi gjithçka. Kjo duket qartë. All-llahu e bëri tokën të gjerë për njeriun dhe e përshtati atë për jetesë. All-llahu e forcoi tokën duke krijuar malet si shtylla. Më pas krijoi njerëzit, krijoi mashkullin dhe femrën, që të mbështeten te njëri-tjetri dhe të shumohen. All-llahu i Madhërishtëm e bëri jetesën e njerëzve me rregullsi, krijoi natën, që njeriu të flejë e të qetësohet, krijoi ditën, që njeriu të punojë për të fituar riskun.

All-llahu krijoi shtatë qiej gjigandë, njëri mbi tjetrin, dhe i zbukuroi ato me yje të shndritshëm, që të përfitojnë prej tyre njerëzit. All-llahu krijoi retë, prej të cilave shiu zbret vullshëm e nga ai përfitojnë krijesat.

Të gjitha këto flasin për fuqinë e All-llahut. Fuqinë e All-llahut e tregojnë edhe krijesat madhështore, si njeriu. All-llahu mundet ta krijojë atë për së dyti, e kjo do të ndodhë në Ditën e Kijametit.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. Dita e Kijametit është e vërtetë.
2. Besimi në Ditën e Kijametit është një prej shtyllave të besimit (Imanit).
3. Gjithësia që na rrethon, e mbushur me krijesa të mëdha e të çuditshme, tregon për fuqinë e All-llahut dhe madhërinë e tij si Krijues.
4. All-llahu është i Mëshirshëm me njerëzit. Ai ka krijuar shumë gjëra për të cilat ata kanë nevojë.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Çfarë kupton nga thënia e All-llahut: “Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim”?
2. Sa është numri i qiejve që ka krijuar All-llahu dhe cili ajet e tregon këtë gjë?

3. Thoni emrat e tri krijesave, që janë përmendur në ajete, e të cilat i sheh rreth teje e më pas trego ajetet.

## **AJETET 17 - 30**

17. S'ka dyshim se Dita e Gjykimit është caktuar. 18. Është Dita, kur i fryhet bririt e ju vini grupe-grupe. 19. Dhe hapen dyert e qiellit. 20. Dhe malet shkulen e bëhen pluhur. 21. E xhehenemi është në pritë. 22. Ai është vendstrehimi i atyre që e tepruan në mëkate. 23. Aty do të mbe-sin (përgjithmonë). 24. Aty nuk do të shijojnë as freskim, as ndonjë pije. 25. Përveç ujit të valë e kalbësirave. 26. Si ndëshkim të merituar. 27. Ata nuk besonin se do të jepnin llogari. 28. Dhe argumentet tona i përgënjeshtroan me këm-bëngulje. 29. Ndërsa Ne gjithçka e kemi ruajtur me shkrim të saktë. 30. E ju, pra vuani. Ne vetëm se do t'jua shtojmë vuajtjen tuaj.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Përgënjeshtroan - Femohuesit ngulin këmbë se nuk ka Ditë Gjykimi.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Ajetet tregojnë se All-llahu e bëri Ditën e Gjykimit për t'u kërkuar llogari krijesave. Pasi All-llahu ta ketë urdhëruar Israfilin që t'i fryjë bririt, do të dalin njerëzit nga varret dhe engjëjt do t'i shoqërojnë për tek All-llahu për të dhënë llogari. Në këtë Ditë të tmerrshme çdo gjë, që ishte në këtë botë do të ndryshojë. Qielli do të çahet e do të hapet nga të gjitha anët. Malet e patundura do të fluturojnë në hapësirë, si të ishin re. Çdo gjë do të ndryshojë e kjo botë do të marrë fund. Këtu fillon Bota e Përtejme (ahireti).

Zjarri i xhehenemit do të jetë në pritje të njerëzve që do të hyjnë në të, për shkak të punëve të këqija që ata bënë.

Në xhehenem nuk do të ketë as ajër të pastër, as ushqim të freskët e të shijshëm; do të ketë vetëm ujë të nxehtë dhe qelb që rrjedh nga trupat e tyre të djegur. Ky është dënimi i madh që do ta vuajnë banorët e xhehenemit për shkak të punëve të këqija që bënë në këtë botë. Ky është dënimi i merituar për ta. All-llahu nuk i bën padrejtësi askujt.

Banorët e Zjarrit thoshin se nuk ka Ditë Gjykimi. Ata përgënjeshtrojnë ajetet e Zotit, që flisnin për këtë Ditë. Engjëjt i regjistronin fjalët e tyre në një libër, që ata të dënohen nga All-llahu.

Abdullah ibn Omer ibn Hatabi (All-llahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Nuk ka zbritur për ata që do të hyjnë në Xhehe-nem ajet më i rëndë se: “E ju, pra, vuani, se Ne vetëm se do t'ju shtojmë vuajtjen tuaj.”

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Dita e Kijametit ka çastin e saj të caktuar, të cilin e di vetëm All-llahu.
2. Ditën e Kijametit do të ndryshojë gjithçka në tokë.
3. Engjëjt regjistrojnë fjalët e njerëzve dhe veprat e tyre për t'u kërkuar atyre llogari në Ditën e Gjykimit.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përmendni tri emra të Ditës së Gjykimit.
2. Çfarë pinë banorët e xhehenemit?
3. Në cilin ajet thuhet se qafirët e mohuan Ditën e Gjykimit?
4. E lidhni fjalinë e kolonës A me fjalinë që i përshtatet nga kolona B.

A

All-llahu nuk i bën padrej-tësi askujt.

Kjo botë do të ndryshojë Ditën e Kijametit.

Dita e Gjykimit është Dita e Kijametit.

B

Ditën e Kijametit malet do të bëhen si retë.

Zoti do të gjykojë mes njerëzve Ditën e Kijametit.

Femohuesi do të hyjë në Zjarr për shkak të punëve të tij të këqija.

5. Ç'do t'i ndodhë qiellit në Ditën e Kijametit?

## AJETET 31 – 40

31. S'ka dyshim se të devotshmit kanë përfitime të mëdha. 32. Ata kanë kopshte e vreshta. 33. Edhe vajza të një moshe. 34. E gota të mbushura plot verë. 35. Aty nuk dëgjojnë fjalë të kota, as gënjeshtër. 36. Të gjitha këto janë shpërblime e dhurata nga Zoti yt. 37. Zoti i qiejve e i Tokës, dhe ç'ka ndërmjet tyre, i Cili është Mëshirues e të Cilit nuk mund t'i flasë askush pa lejen e Tij. 38. Atë Ditë (Ditën e Gjykimit) Xhibrili dhe engjëjt qëndrojnë të rreshtuar, askush nuk flet veç atij, që lejon Mëshiruesi dhe që thotë të vërtetën. 39. Ajo është Dita e vërtetë dhe, kush dëshiron, le t'i kthehet rrugës për te Zoti i vet. 40. Ne i paralajmëruam (idhujtarët) për një dënim të afërt në Ditën, kur njeriu (besimtar) shikon se çfarë ka bërë, e jobesimtari thotë: “Ah, sa mirë do të ishte për mua sikur të isha dhe!”

## KUPTIMI I FJALËVE

Fitime - Sevape dhe shpërblime.

Nuk mund të flasë askush - Ditën e Gjykimit mund të flitet vetëm me lejen e All-llahut të Madhërishëm.

Xhibrili ose (Xhebraili) - Është engjëlli që u shpall shpalljen profetëve.

Sikur të isha dhé - Ditën e Kijametit qafirrit do t'i pëlqente të mos ishte krijuar fare, nga tmerret që do të shohë.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Ajetet e mësipërme tregojnë se All-llahu u ka premtuar qafirëve xhehenemin, ku ata do të vuajnë përjetësisht. Ajetet flasin edhe për mrekullinë dhe shpërblimin që All-llahu u ka premtuar besimtarëve. All-llahu i shpërblen ata duke i futur nëpër kopshte shumë të bukura e të këndshme, me plot pemë e fruta të shijshme. Në xhenet ka edhe vajza të reja e të bukura të cilat quhen hyri. Gotat do të mbushen plot me pije të freskëta. Banorët e xhenetit nuk dëgjojnë fjalë të vrazhda; ata dëgjojnë vetëm përshëndetje me “Selam!” nga engjëjt, ata dëgjojnë vetëm fjalë të ëmbla. Të gjitha këto të mira janë shpërblim nga All-llahu për besimtarët që bëjnë vepra të mira dhe që u largohen harameve.

Ditën e Gjykimit engjëjt, me në krye Xhibrilin, do të qëndrojnë të gjithë të rreshtuar e të ndrojtur, sepse Ai është Zoti i qiejve, është Zoti i Tokës, është Zoti i gjithçkaje. Asnjë nga engjëjt nuk flet, përveç atij të cilin e lejon All-llahu. Engjëlli që do të flasë, do të thotë vetëm fjalë të bukura, për të mirën e besimtarëve.

Dita e Gjykimit është një ditë e vërtetë dhe ora e saj nuk është e largët. Muslimani beson në këtë Ditë dhe bën vepra të mira në këtë botë, që të shpëtojë, kur të gjykohet në Botën e Përtejme.

Jobesimtari do të donte të mos ishte ringjallur në atë Ditë. Atij do t'i pëlqente më shumë të ishte bërë dhé.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. All-llahu u ka premtuar të devotshmëve xhenete dhe kënaqësi të shumta, si shpërblim për punët e mira që bënë në këtë botë.
2. Të gjitha krijesat do të jenë të ndrojtura dhe të frikësuara përpara All-llahut të Madhërishëm dhe asnjë nuk mund të flasë pa lejen e All-llahut të Madhërishëm.
3. Jobesimtari do të donte të mos ishte krijuar kurrë e të mos ishte ringjallur.
4. All-llahu i udhëzon njerëzit të kryejnë vepra të mira, të besojnë në Ditën e Gjykimit dhe të përgatiten për Ditën e Gjykimit.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Flisni për tri nga kënaqësitë që u ka premtuar All-llahu besimtarëve në xhenet.
2. Përse ua ka premtuar All-llahu i Madhërishëm kënaqësitë atyre që do të hyjnë në xhenet?
3. Cili ajet thotë se Xhibrili nuk do të jetë i ndrojtur e i frikësuar përpara All-llahut?
4. Çfarë do të dëshironte qafiri në Ditën e Kijametit?
5. Në vend të pikave vendosni fjalën e duhur, duke u mbështetur tek ajetet:
  - a) Muslimani është me edukatë; ai nuk flet fjalë të .....
  - b) I shkrova vëllait tim musliman .....
  - c) I ofrova mikut tim një gotë .....
6. Përmendni dy çështje që i mësojmë nga ajetet.

## **SUREJA “EN NAZIATË “**

(E zbritur në Mekë, ka 46 ajete)

Ajetet 1 - 14

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për ata që marrin shpirtrat me rrëmbim. 2. Dhe ata që marrin shpirtrat me lehtësim. 3. Dhe ata që notojnë me shpejtësi. 4. Edhe ata që nxitojnë si të ishin në garë. 5. Për ata që organizohen (për kryerjen e çdo urdhri). 6. Ditën, kur vrullshëm bëhet dridhja. 7. E pas saj vjen tjetra. 8. Atë Ditë zemrat janë të tronditura. 9. Shikimet e tyre janë të poshtëruara. 10. Ata thonë: “A thua do të bëhemi përsëri kështu si jemi? 11. Edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbura?” 12. Ata thanë: “Atëherë, ai do të jetë një kthim i dëshpëruar për ne.” 13. Po, ajo nuk do të jetë tjetër veçse një thirrje. 14. Dhe ata do të zgjohen plotësisht për t’u gjykuar.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure flet për Mesazhin Islam, për Ditën e Ringjalljes, për politeistët dhe Faraonin.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Marrin shpirtrat me rrëmbim - Është fjala për engjëjt që u marrin jetën jobesimtarëve.

Ata që marrin shpirtrat me lehtësim - Engjëjt, të cilët u marrin shpirtrat besimtarëve.

Notojnë - Fluturojnë në hapësirë (engjëjt).

Nxitesit - Engjëjt, të cilët shpejtojnë për të kryer detyrat që u ka caktuar All-llahu.

Çdo çështje rregullojnë - Ata kujdesen që gjithçka mbi tokë të shkojë sipas rregullit të vendosur nga All-llahu.

Dridhja - Quhet fryrja e parë e Surit në Ditën e Kijametit, kur do të dridhet gjithçka mbi tokë.

Pason tjetra - Është fryrja e dytë e Kijametit; prej saj do të ringjallen njerëzit.

Të poshtra - Janë me turp; veprat e tyre i kanë bërë ata të poshtëruar.

Kështu si jemi - Në këtë jetë.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Fillimi i sures flet për çastin e Ditës së Kijametit dhe për disa çaste të Ditës së Gjykimit e për betimin e All-llahut të Madhërishtëm në disa nga krijesat e Tij. All-llahu i Madhërishtëm betohet në engjëjt, që u marrin shpirtrat qafirëve me forcë dhe për engjëjt që u marrin shpirtrat besimtarëve me lehtësi; për engjëjt që notojnë në qiell dhe që janë të gatshëm për të kryer detyrën. Engjëjt, për të cilët është betuar All-llahu, kujdesen që punët e njerëzve të shkojnë sipas urdhrave të Tij. All-llahu, kur i krijoi engjëjt, u caktoi atyre detyra, që kanë të bëjnë me njeriun dhe me krijesat e tjera. Engjëjt janë ndër krijesat më madhështore të All-llahut të Madhërishtëm, prandaj dhe All-llahu i Madhërishtëm betohet në to - për të vërtetësuar ato që do të ndodhin Ditën e Kijametit. Në fillim të kësaj Dite, engjëlli do t'i fryjë Britit. Kjo quhet fryrja e parë. Do të dridhet dhe do të

shkatërrohet çdo gjë. Do të vdesin të gjitha krijesat. Më pas do të vijë fryrja e dytë. Kjo është fryrja e Ringjalljes. Do të dalin njerëzit të gjallë nga varret dhe do të japin llogari përpara All-llahut të Madhërishëm. Pejgamberi (paqja dhe bekimi i All-llahut goftë mbi T'ë!), kur bëhej e treta e natës, ngrihej dhe thoshte: *“O njerëz! Kujtoni All-llahun. Erdhi dridhma (e Kija-metit) e parë. Erdhi edhe dridhma tjetër. Erdhi vdekja me të vetat.”* (E përcjell Ahmedi)

Kur All-llahu t'i ringjallë njerëzit nga varret për t'i gjykuar, qafirët do të tremben e do të tmerrohen, sepse ata e mohuan këtë Ditë. Qafirët thoshin në këtë botë: *“Ne nuk mund të ringjallemi pas vdekjes, kur do të jemi bërë kocka të kalbura e të thërrmuara si dheu.”* Por, kur All-llahu me fuqinë e Tij t'i ringjallë ata pas vdekjes, do ta shohin ç'ditë e rëndë do të jetë ajo për ta, sepse ata nuk u përgatiten për të, sepse ata nuk bënë punë të mira, sepse ata nuk besuan.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu betohet në çdo krijesë që dëshiron.
2. Engjëlli do t'i fryjë Bririt (Surit) dy herë. Herën e parë do të dridhet gjithçka e do të vdesë gjithçka mbi Tokë. Në fryrjen e dytë All-llahu do t'i ringjallë të gjithë njerëzit për t'i gjykuar.
3. Në Ditën e Kijametit qafirët do të ndjehen të frikësuar dhe të poshtëruar, sepse ata e mohonin këtë Ditë në këtë botë.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. A i lejohet muslimanit të betohet në engjëj?
2. Sa herë do t'i fryjë Bririt Israfil?
3. Çfarë do t'u ndodhë njerzve kur t'i fryhet Bririt për të dytën herë?

## AJETET 15 - 26

15. A të ka ardhur ty rrëfimi i Musait? 16. Kur Zoti i tij e pati thirrur në Luginën e bekuar Tuva.  
17. “Shko te Faraoni, se vërtet ai e ka tepruar 18. Dhe thuaj: “A ke ndërmend të past-rohesh?”  
19. Unë të udhëzoj te Zoti yt e ti t’ia kesh frikën Atij.” 20. Dhe ai (Musai) ia tregoi mrekullinë e madhe. 21. Por ai (Faraoni) e përgënjeshtroi dhe e kundërshtoi. 22. Pastaj u kthye dhe iku me të shpejtë. 23. I tuboi (magjistarët) dhe u mbajti fjalim. 24. E u tha: “Unë jam Zoti juaj më i lartë.”  
25. Atëherë, All-llahu e dënoi atë tmerrshëm, për këtë të fundit dhe për atë të parën. 26. Nga ky ndëshkim merr mësim ai që e ka frikë All-llahun.

## KUPTIMI I FJALËVE

Tuva - Emri i luginës.

E ka tepruar - E ka tepruar me mëkate.

Të pastrohesh - Të pastrohesh nga mëkatet.

Mrekullinë e madhe - Bastunin e Musait, i cili u kthye në gjarpër.

Iku me të shpejtë - Iku për t'u përgatitur kundër Musait.

I tuboi dhe u mbajti fjalim - Tuboi magjistarët dhe njerëzit e tij.

E dënoi atë - All-llahu e shkatërroi Faraonin

Për këtë të fundit dhe atë të parën - Dënimin në këtë botë me mbytjen e tij dhe dënimin në Botën e Përtejme.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

All-llahu i Madhërishëm tregon në këto ajete një pjesë të historisë së Musait dhe të Faraonit. All-llahu i Madhërishëm e thirri Musanë në Luginën e Shenjtë dhe i foli atij në Sham: *“Ti je i Dërguari*

*Im. Shko te Faraoni dhe populli i tij e u thuaj të largohen nga kufri dhe të bëjnë vepra të mira e të dobishme. Thuaji ta besojnë All-llahun e t'ia kenë frikën Atij, sepse Ai e ka dënimin të rëndë.”*

Musai shkoi te Faraoni, sipas urdhrorit të Zotit, që ta ftonte atë në rrugë të drejtë, të besonte All-llahun e Madhërishëm. Që ta siguronte Faraonin, se ai ishte i Dërguari i Zotit, i tregoi një argument madhështor. Hodhi shkopin kur, papritur, ai u kthye në gjarpër e lëvizte para Faraonit. Kjo ishte një mrekulli që iu dha Musait (paqja qoftë mbi të) nga All-llahu i Madhërishëm. Por, edhe kur pa këtë gjë, Faraoni nuk besoi dhe i tha Musait: *“Kjo është magji.”* Pastaj Faraoni thirri këshilltarët e tij. Ata i thanë të tubonte të gjithë magjistarët për të mundur Musanë. Faraoni u thoshte njerëzve: *“Unë jam zoti juaj më i madh, nuk ka tjetër përveç meje.”*

U mblodhën njerëzit në një shesh të madh. Erdhën edhe magjistarët me litarë e shkopinj nëpër duar. Kur i hodhën mbi tokë, njerëzve iu duk sikur ato ishin gjarpërinj. Në atë çast e hodhi shkopin edhe Musai. Shkopi iu bë gjarpër e filloi të gëlltiste shkopinjtë dhe litarët e magjistarëve që ishin përtokë. Kur magjistarët e panë këtë, e besuan Musanë si të Dërguar të Zotit, sepse ata e njihnin shumë mirë magjinë e ajo që bëri Musai (paqja qoftë mbi të) nuk ishte magji, por mrekulli nga All-llahu i Madhërishëm. Magjistarët besuan në Zotin e vetëm dhe e mohuan Faraonin si zot. Faraoni mbeti në kufirin e tij e më pas i vrau magjistarët, sepse ata besuan.

All-llahu i Madhërishëm e dënoi rëndë Faraonin për shkak të kufrit dhe përgënjeshtimit të tij. All-llahu i Madhërishëm e mbyti atë në det e trupin ia nxori në breg. Kjo ndodhi në këtë botë, kurse në Ditën e Gjykimit ai dhe ndjekësit e tij do të vuajnë dënimin më të rëndë në xhehenem. Nga çfarë thuhet në sure përfiton vetëm ai që i frikësohet All-llahut të Madhërishëm.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Musai (paqja e All-llahut qoftë mbi të) është i Dërguar i All-llahut të Madhërisëm te Faraoni.
2. Gjykimi i All-llahut të Madhërisëm është i pandryshue-shëm. All-llahu i Madhërisëm i ndihmon Profetët dhe besimtarët dhe i shkatërron qafirët.
3. All-llahu u tregon njerëzve histori të popujve të mëparshëm, që ata të nxjerrin mësimë.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Ku i foli All-llahu Musait?
2. Çfarë i kërkoi All-llahu Musait?
3. Cili qe argumenti që vërtetonte se Musai ishte i Dërguari i Zotit?
4. A u bind Faraoni nga argumenti i Musait?
5. Si e dënoi All-llahu Faraonin në këtë botë?
6. Përse na e përmend Kur'ani historinë e Musait dhe të Faraonit?
7. A mund të jetë dikush i krijuar dhe krijues në të njëjtën kohë?

## AJETET 27 - 33

27. A është më i rëndë krijimi juaj apo i qiellit? E Ai e ngriti atë! 28. Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë. 29. Natën e errësoi edhe ditën e ndriçoi. 30. Pastaj tokën e shtriu. 31. Dhe prej saj nxori ujin e saj dhe kullotat e saj. 32. Kurse kodrat ia përforcoi. 33. Si risk për ju dhe për kafshët tuaja.

## KUPTIMI I FJALËVE

Ia ndriçoi - All-llahu bëri që dita të ndriçohet me rrezet dhe dritën e Diellit.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

All-llahu, pasi përmend fundin e Faraonit, ua tregon keto ajete femohuesve që e mohuan Ditën e Ringjalljes. All-llahu u thotë jobesimtarëve: *“Krijimi juaj është më i lehtë se krijimi i qiejve, sepse qielli është i lartë e i fortë.”* All-llahu ka krijuar Hënën, e cila bën dritë natën; ka krijuar Diellin, i cili rrezaton ditën. All-llahu krijoi edhe Tokën dhe e bëri atë me një shtrirje të gjerë, që të jetë sa më e përshtatshme për njerëzit. Nga toka nxorri ujin dhe bëri që të mbijnë bimët dhe pemët. Ai e forcoi Tokën me malet; Ai krijoi kafshët që njeriu të përfitojë prej tyre. Të gjitha këto për njeriun.

Idhujtarët e pranojnë se All-llahu është Krijuesi i qiejve dhe i tokës. All-llahu thotë: *“Kur i pyet ata se kush i krijoi qiejt dhe tokën, ata thonë All-llahu.”* Por idhujtarët duhet të besonin në fuqinë e All-llahut për t’i ringjallur njerëzit në Ditën e Gjykimit, sepse Ai që krijoi qiejt dhe tokën nuk e ka të vështirë të ringjallë njeriun.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërisëm ka fuqi që ta ringjallë njeriun, sepse krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i vështirë sesa krijimi i njeriut.
2. All-llahu e krijoi qiellin në mënyrë të përsosur dhe vendosi në të Diellin dhe Hënën, që të përfitojnë njeriu dhe krijesat e tjera.
3. All-llahu krijoi Tokën dhe e bëri atë të sheshtë. All-llahu krijoi ujin dhe e përforcoi Tokën me malet. Ai e bëri Tokën të përshtatshme për të jetuar njerëzit.
4. All-llahu është Bujar e dëshiron që njerëzit të bëjnë një jetë të mirë.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përmendni emrat e disa kafshëve.

2. Ç'thonë idhujtarët për Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?

## **AJETET 34 - 46**

34. E kur të vijë Vala e Madhe. 35. Atë Ditë njeriu kujton se çfarë ka punuar. 36. E xhehenemi shfaqet dukshëm për atë që e sheh. 37. E përsa i përket atij që e ka tepruar. 38. Dhe i dha përparësi jetës së kësaj bote. 39. xhehenemi do të jetë vendi i tij. 40. E kush iu afrua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve. 41. Ka vend xhenetin. 42. Ty të pyesin për Ditën e Kijametit: “Kur do të ndodhë?” 43. Po sa je në gjendje ti t’ua kujtosh atë? 44. Vetëm Zoti yt është në dijeni për të. 45. Ti je vetëm qortues i atij që ia ka frikën Ditës së Gjykimit. 46. Ditën kur ta përjetojnë atë, do t’u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Vala e madhe - Dita e Kijametit.

Çfarë ka punuar - Ditën e Gjykimit njeriu do t’i shohë të gjitha veprat që ka bërë në këtë botë, të mira e të këqija, të vogla e të mëdha.

I dha përparësi jetës së kësaj bote - Mendoi vetëm për këtë botë e jo për Botën Tjetër.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

All-llahu i Madhërishtëm thotë se “Çasti i Kijametit”, ose siç quhet “Vala e madhe”, do të marrë përpara gjithçka në këtë Gjithësi. All-llahu do t’i tubojë njerëzit për t’u kërkuar llogari. Atëherë, të gjithë do të kujtojnë punët e tyre, të mirat dhe të këqijat. Do të duket qartë edhe xhehenemi, që ta shikojnë ata të cilët bënë vepra të këqija, që përgënjeshtroan Ditën e Kijametit dhe që pëlqyen këtë botë mbi Ahiretin. Këta njerëz do të hyjnë në xhehenem.

Kurse ata që e patën frikë All-llahun në këtë botë dhe nuk bënë punë të këqija, ata që u penduan për të këqijat e bëra, All-llahu do t’i fusë në xhenete të pafund, ku do të jetojnë të kënaqur përgjithmonë.

Njerëzit e pyetën Muhammedin për çastin, kur do të vinte kjo Ditë, e ai iu përgjigj qartë se çastin e kësaj Dite nuk e dinte askush përveç All-llahut dhe se All-llahu nuk ia ka treguar asnjë krijese Orën e Saj, as Profetëve, as engjëjve etj.

All-llahu i Madhërishtëm i rikujton Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) se detyra e tij ishte të udhëzonte njerëzit dhe t’u tregonte atyre rrugën e drejtë për të pasur frikë nga All-llahu i Madhërishtëm, ta besonin Atë dhe Ditën e Kijame-tit.

Dita e Kijametit është aq e frikshme, saqë njerëzit do ta harrojnë këtë botë. All-llahu do t’i pyesë: *“Sa keni jetuar mbi tokë?”* Ata do të thonë: *“Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës; pyesni ata që dinë të numërojnë!”* (El- Mu’minunë: 112-113)

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Ditën e Kijametit njeriu do të kujtojë të gjitha veprat që ka bërë në këtë botë.
2. “Vala e Madhe” është një nga emrat e Ditës së Kijametit.
3. Zjarri do të jetë vendi i jobesimtarëve, kurse xheneti vendi i besimtarëve.
4. Orën e Ditës së Kijametit nuk e di askush përveç All-llahut.
5. Ai që e ka frikë All-llahun do të shpëtojë në atë Ditë.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Ajetet kanë përmendur dy cilësi të atyre që do të hynë në Zjarr. Cilat janë ato?
2. Ç'kuptim ka ajeti: “E, xhehenemi shfaqet për atë që e sheh.”
3. Ajetet kanë përmendur dy cilësi të atyre që do të hynë në xhenet. Cilat janë ato?
4. Në ajetet e mësipërme përmendet detyra e të Dërguarve. Cila është ajo?
5. A e di i Dërguari të fshehtën?

## SUREJA “ABESE “

(E zbritur në Mekë, ka 42 ajete)

Ajetet 1 - 16

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Ai u vrenjt dhe u kthye, 2. Sepse atij i erdhi i verbëri (dhe e ndërpreu). 3. E ku mund ta dish ti? Ndoshta ai do të pastrohet nga të këqijat, 4. Ose do të përfitojë nga këshilla. 5. E ai nuk ndien nevojë, pse ka pasuri. 6. Ti atij i kushton vëmendje! 7. Ti nuk mban përgjegjësi pse ai nuk pastrohet. 8. Ndërsa ai që nxiton dhe vjen tek ti 9. Dhe ai e ka frikë All-llahun. 10. E ti nuk i kushton vëmendje atij. 11. Jo ashtu! Në të vërtetë, ajo është këshillë. 12. Kush do të marrë mësim nga ajo? 13. Është këshillë në fletë të çmueshme. 14. Me vlerë të lartë e të ruajtur. 15. Në duar të udhëtuesve. 16. Të nderuar e të ruajtur.

## PËRMBAJTJA E SURES

Kjo sure flet për sahabin e verbër dhe se si njeriu i mohon fuqinë e Zotit dhe Ditën e Gjykimit.

Kuptimi i fjalëve:

U kthye - Nuk i vuri rëndësi.

I verbëri - Abdullah ibn Umi Mektum.

Nuk ke përgjegjësi - Nuk je mëkatar që ai nuk beson.

Pastrohet - Pastrohet nga kufri (mohimi).

Që nxiton - Që nxiton për te veprat e mira.

Këshilla - Këshilla për atë që do të përfitojë.

Të çmueshme - Të çmueshme për All-llahun.

Të lartë - Në një vend të lartë.

Të udhëtuesve - Engjëjve që udhëtojnë.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Kjo sure fillon me një qortim nga All-llahu i Madhërishëm për Muhammedin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Një ditë Muhammedi (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) takoi parinë e kurejshëve dhe filloi t'u fliste rreth Islamit dhe t'i ftonte ata që t'i besonin All-llahut të Madhërishëm. Kur Muhammedi (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) po fliste, erdhi tek ai një i verbër, emri i të cilit ishte Abdullah Ibn Umi Mektum, dhe i tha: *“O i Dërguari i All-llahut, më mëso mua nga ato që të mësoi Zoti yt.”* Muhammedi u kthye i vrenjtur nga ai dhe nuk u përgjigj. Për këtë All-llahu e qortoi atë në Kur'an. All-llahu ia sqaroi Muhammedit se nuk mbante

asnjë lloj përgjegjësie në qoftë se qafirët nuk besonin pas thirrjes që ai u bënte. I Dërguari nuk duhej t'u përkushtohej më shumë qafirëve sesa atyre që besuan, si në shembullin e sahabit të verbër. All-llahu i Madhërishëm i thotë Muhammedit: *“Qafirët kurejsbë nuk u vinin rëndësi fjalëve të tij, prandaj edhe ai të mos u vinte shumë rëndësi atyre, sepse rruga për në besim është e qartë për atë i cili do që të udhëzohet.”* Ajetet e Zotit janë të qarta dhe këshilluese për të gjithë njerëzit. Ajetet e All-llahut kanë qenë të shkruara lart në qiell, në Leuhi Mahfudh. All-llahu zbriti këtë Kur'an me anë të Xhibrililit te Muhammedi (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) për t'i këshilluar njerëzit.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. I Dërguari (paqja e All-llahut dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) është besnik në kumtimin e Kur'anit të Shenjtë. Muhammedi (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) nuk e fshehu qortimin që iu bë. Ai ua kumtoi atë njerëzve, ashtu siç ia zbriti All-llahu i Madhërishëm.
2. Islami i respekton të dobëtit e të vobektit. All-llahu i Madhërishëm e qortoi Muhammedin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) sepse nuk tregoi vëmendje ndaj fjalëve të të verbërit besimtar.
3. All-llahu e zbriti Kur'anin e Shenjtë nga Leuhi Mahfudh te Muhammedi.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Si quhej i verbëri, që erdhi te Muhammedi për të mësuar?
2. A ishte Muhammedi i zënë në ato çaste?
3. Cili ishte shkaku që Abdulla Ibn Umi Mektum e pyeti Muhammedin kur ai ishte i zënë me parinë e Kurejshëve?
4. Përmend dy çështje për të cilat udhëzojnë ajetet e mësipërme.
5. A u zemërua Muhammedi me të verbërin, pasi u qortua nga All-llahu?

## AJETET 17 - 23

17. Qoftë mallkuar njeriu! Ç'e bëri atë ta mohojë All-llahun? 18. Prej çfarë e krijoi Ai atë? 19. Atë e krijoi prej një pike uji dhe e formoi në raportin e duhur. 20. Pastaj atij ia lehtësoi rrugën. 21. Pastaj e bëri atë të vdesë dhe i bëri varr. 22. Pastaj, kur të dojë Ai, e ringjall atë. 23. Jo! Ai (njeriu) nuk zbatoi atë që urdhëroi All-llahu.

## KUPTIMI I FJALËVE

Ia lehtësoi rrugën - Ia qartësoi atij rrugën e drejtë dhe rrugën e shtrembër.

E ringjall - Do ta ringjallë për të dhënë llogari në Ditën e Gjykimit

Ai nuk zbatoi atë që urdhëroi - Ai nuk e kreu detyrën, që i ngarkoi All-llahu i Madhërishëm.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Njeriu është i dobët. All-llahu e krijoi njeriun nga uji, e bëri atë të rritet e i dha dëgjimin, shikimin etj. All-llahu ia bëri të qartë njeriut rrugën e mirë dhe rrugën e keqe dhe e la atë të lirë të zgjedhë mes tyre. Rruga e mirë të çon në xhenet; rruga e keqe të çon në xhehenem. Kjo zgjedhje është dhuratë nga All-llahu për njeriun, sepse nuk e bëri atë si kafsha, e cila nuk ka zgjedhje e është tërësisht e nënshtruar.

Nga të mirat e All-llahut për njeriun është edhe varri. Ai është respekt për trupin e tij. Më pas, kur të vijë çasti i caktuar për t'i kërkuar atij llogari për veprat që ka bërë në këtë botë, All-llahu e ringjall njeriun.

Këto ajete janë mëse të mjaftueshme që njeriu ta falënderojë Zotin e t'u bindet urdhrave të Tij. Por, për fat të keq, njeriu tregohet i mangët në zbatimin e detyrave që i ka caktuar All-llahu. Ai i shpërblen begatitë e Zotit... duke e mohuar Atë.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Ajetet tregojnë se ata që nuk e njohin siç duhet dhe nuk e falënderojnë All-llahun e Madhërishtëm janë njerëz të ulët.
2. All-llahu e mëshiroi njeriun, duke e krijuar në formën më të bukur dhe duke e pajisur edhe me shqisa.
3. Varrosja e të vdekurit është respekt për trupin e tij, po kështu, edhe ringjallja Ditën e Ringjalljes.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përmend tri të mira që All-llahu i ka falur njeriut, për të cilat flitet në ajetet e mësipërme.
2. Flisni për ajetin, që tregon mangësitë e njeriut kundrejt All-llahut.
3. Cili është kuptimi i ajetit: “Pastaj atij ia lehtësoi rrugën”?
4. Flisni për dy çështje, që janë cituar në ajetet e mësipër-me.

## **AJETET 24 - 32**

24. Njeriu le të shikojë ushqimin e vet. 25. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. 26. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës 27. Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra 28. Edhe rrush e perime 29. Edhe ullinj e hurma 30. Edhe kopshte të dendura 31. Edhe pemë e kullota 32. Si mjete begatimi për ju dhe për bagëtinë tuaj.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

E çamë tokën - E çamë tokën, kur del bima.

Kopshte të dendura - Kopshte të dendura nga pemët e shum-ta.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Ajetet e mësipërme flasin për disa nga begatitë e Zotit. Ato tregojnë se si u krijua njeriu nga një pikë e vogël e më pas All-llahu bëri që të rritet, duke i dhënë shqisa për të jetuar. All-llahu kërkon nga njeriu të vështrojë rreth vetes së tij, t'i shikojë këto begati të cilat e orientojnë për të besuar në fuqinë madhështore të All-llahut, Zotit të botëve.

Toka ishte e tharë e All-llahu zbriti në të shiun, që të mbijnë bimë dhe pemë të shumta. Ky ujë, që e zbriti All-llahu, bën që të mbijnë bimët, nga të cilat njeriu përfiton për nevojat e tij.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. Njeriu duhet t'i zbatojë porositë e All-llahut, i bindur se All-llahu është i vetmi Krijues.
2. Uji është një begati e madhe. Njeriu duhet ta shfrytëzojë atë në mënyrën më të mirë dhe të mos e shpërdorojë atë.
3. All-llahu është i Mëshirshëm me njerëzit. Ai krijoi në tokë shumë gjëra, që njerëzit të ushqehen me to.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Thoni llojet e pemëve, që u përmendën në ajetet e mësipërme.
2. Vendosni fjalën e përshtatshme në fjalitë që vijojnë:
  - a) E mbrojtëm Kur'anin... mirë
  - b) E goditëm ... armikun shumë

c) E falenderuam ... All-llahun shumë

3. Merr në dorë një kokërr mollë dhe vështroje mirë atë, duke menduar se si është krijuar ajo nga toka dhe si ka arritur te ti.

## **AJETET 33 - 42**

33. E kur të vijë Ushtima. 34. Atë Ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, 35. Prej nënës së vet dhe prej babait të vet, 36. Prej gruas së vet dhe prej fëmijëve të vet. 37. Atë Ditë çdo njeriu i mjafton çështja e vet. 38. Atë Ditë do të ketë fytyra të shndritura, 39. Të buzëqeshura e të gëzuara. 40. Atë Ditë do të ketë edhe fytyra të pluhurosura, 41. Që i ka mbuluar errësira. 42. Ato janë të mohuesve, mëkatarëve.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Ushtima - Britma e fortë; një nga emrat e Ditës së Kijametit.

Të pluhurosura - Fytyrat e atyre që nuk besuan do të jenë tërë pluhur, të fëlliqura.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Njeriu duhet ta kuptojë se kjo jetë është si një kopsht me bimë e pemë. Ashtu siç i vjen këtij kopshti koha kur bimët “vdesin”, ashtu do t’i vijë edhe kësaj bote koha e zhdukjes, e asgjësimit. All-llahu i Madhërishtëm thotë: *“Shembulli i kësaj bote është si uji, të cilin Ne e zbrisim nga qielli dhe nga i cili zhvillohen bimët e tokës e më pas do bëhen byk dhe shpërndahen nga erërat. All-llahu është i Fuqishëm mbi gjithçka.”*

Kur njeriu të gjendet përballë frikës së Ditës së Gjykimit, do të largohet nga e gjithë familja e tij, sepse do të mendojë vetëm për veten e tij. Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe: grupi i parë do të jetë i qeshur e i kënaqur për atë që e pret, sepse ai bëri vepra të mira dhe besoi në ajetet e All-llahut; grupi i dytë do të jetë i dëshpëruar dhe shenjat e dëshpërimit do të duken në fytyrat e tyre. Ata do të dënohen në zjarrin e xhehenemit.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. Në Ditën e Gjykimit njeriu do të jetë i zënë vetëm me çështjen e tij.
2. Në Ditën e Gjykimit njeriu do të largohet nga nëna e tij, nga babai i tij, nga vëllai i tij, nga fëmijët dhe nga gruaja e tij.

3. Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe: grupi i gëzuar, i cili do të hyjë në xhenet e grupi i trishtuar, i cili do të hyjë në xhehenem.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Nga kush do të largohet njeriu Ditën e Gjykimit?
2. Përse do të largohet njeriu nga njerëzit e tij më të dashur në Ditën e Gjykimit?
3. Në sa grupe do të ndahen njerëzit atë Ditë?
4. Kush do të jenë ata njerëz, që do të hyjnë në xhenet?

## **SUREJA “ET TEKUIR “**

(E zbritur në Mekë, ka 29 ajete)

Ajetet 1 - 14

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur Dielli të jetë mbështjellur,
2. Kur yjet të kenë rënë,
3. Kur malet të kenë lëvizur e të jenë bërë pluhur,
4. Kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë,
5. Kur egërsirat të jenë bashkuar,
6. Kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar,
7. Kur shpirtrat të jenë bashkuar,
8. Kur vajzat e varrosura për së gjalli të pyeten
9. Për çfarë mëkati janë vrarë,
10. Kur fletushkat të jenë shpalosur,
11. Kur qielli të jetë hequr,
12. Kur xhehenemi të jetë ndezur fort.
13. Kur xheneti të jetë afruar.
14. Atëherë njeriu do të dijë se çfarë ka vepruar.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për Ditën e Kijametit dhe për ç’do të ndodhë në të; ajo flet për Shpalljen dhe kundërshtimin e femohuesve (qafi-rëve).

## KUPTIMI I FJALËVE

Vajzat e varrosura për së gjalli - Para Islamit arabët i vrisnin vajzat porsa lindnin.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Këto ajete tregojnë se si në Ditën e Kijametit do të ndryshojë tërë Gjithësia. All-llahu i Madhërishtëm thotë në Kur'an: *“Atë Ditë, kur do të ndryshojë Toka dhe qielli.”* (Ibrahim:48)

Shenjat më të para të Ditës së Kijametit do të jenë: do të mbështillet Dielli dhe do t'i zhduket drita; do të errësohen yjet; do të lëvizin malet si ré e do të shkatërrohet gjithçka në Tokë. Edhe deveja e mbarsur, që është shumë e shtrenjtë për arabët, do të lihet e vetme; askush nuk do ta vrasë mendjen për të; secili do të mendojë vetëm për veten e tij; do të tubohen kafshët dhe do të ngordhin; do të shpërthejnë detet e do të ndizen zjarr; do të bashkohen shpirtat me trupat e tyre; do të pyeten vajzat e varrosura për së gjalli, se përse u varrosën.<sup>2</sup>

Kur të hapen fletët, ku janë shënuar punët e njerëzve, do të hiqet dielli, do të jetë nxehur xhehenemi dhe do të jetë afruar xheneti te banorët e vet. Kur të ndodhin të gjitha këto, atëherë ka

---

2) *Përpara Islamit, arabët, kur u lindte vajzë, e varrosnin të gjallë nga frika se mos mbetej e varfër ose nga frika se mos turpërohej (bëhej imorale, binte robinë gjatë luftërave etj.). Islami e ndaloi rreptësisht këtë veprim.*

ardhur Dita e Gjykimit, e cila është Dita kur jepet llogari përpara All-llahut. Në këtë Ditë njeriu do ta kuptojë fundin e vet.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Kur të vijë Dita e Kijametit, i gjithë universi do të ndryshojë.
2. Kjo sure e shpjegon me hollësi ç'do të ndodhë në Ditën e Gjykimit. I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) thotë: “Ai, që dëshiron t'i hedhë një vështrim Ditës së Gjykimit, le të lexojë suret “Et Tekuir”, “El Infitar” dhe “El Inshikak.”
3. All-llahu e urdhëron prindin që të kujdeset për fëmijën e vet.
4. Muslimani duhet të zgjedhë për shok një njeri të mirë. Në një hadith thuhet: *“Ditën e Gjykimit, njeriu do të jetë me atë që do.”*
5. Në Ditën e Gjykimit do t'i jepen secilit fletët me punët e bëra në këtë botë.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Ç'do t'u ndodhë maleve në Ditën e Gjykimit?

2. Çfarë dini mbi vajzat e varrosura për së gjalli?
3. Ç’do të thotë: “Dhe kur shpirtrat të bashkohen”? Përmendni hadithin me të njëjtin kuptim.
4. Përmendni dy çështje të cituara nga ajetet.

## AJETET 15 - 29

15. Beto hem në yjet që do të bien poshtë, 16. Që udhëtojnë e fshihen. 17. Për natën, kur ajo ia beh me errësirë. 18. Për agimin, kur ai zbardh! 19. S’ka dyshim se ai (Kur’ani) është fjala e të Dërguarit fisnik, 20. Që i është dhënë fuqi (nga All-llahu) dhe që ka vend të lartë te Zoti i Arshit. 21. Që është i respektuar dhe besnik. 22. Nuk është i luajtur shoku juaj. 23. Ai e pati parë atë (Xhibrilin) në horizontin e kthjellët. 24. Ai nuk dyshon tek e fshehta. 25. Ai (Kur’ani) nuk është thënie e djallit të mallkuar. 26. Ku jeni, nga shkoni? 27. Kur’ani s’është tjetër veçse këshillë për njerëzit! 28. (Prej tij mund të përfitojë) Kushdo prej jush, që dëshiron të ecë në rrugën e drejtë.<sup>3</sup> 29. Por ju nuk mund të dëshironi, vetëm në qoftë se dëshiron All-llahu, Zoti i botëve!

---

3) All-llahu është Zoti i Botëve, është Zoti i mirësisë dhe i mëshirës. Udhëheqësia e Tij është e hapur për cilindo që e dëshiron atë. Por, vullneti i njeriut është në pajtim me vullnetin e All-llahut. (shih ajetin 29). Vetë Islami është kjo pajtueshmëri midis vullnetit të All-llahut dhe vullnetit të lirë të njeriut. Ajeti 28 thekson vullnetin e lirë të njeriut dhe përgjegjësitë e tij, kurse ajeti 29 thekson kufizimet e vullnetit të lirë të njeriut. Të dyja skajshmëritë (esktremet), domethënë edhe determinizmi i prerë edhe një vullnet i lirë kaotik, janë të papranueshme.

## KUPTIMI I FJALËVE

Që udhëtojnë e fshihen - Yjet e mbuluara.

Të Dërguarit fisnik - Të Xhibrilit, i cili zbriste Kur'anin te Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)

Vend të lartë - Tek All-llahu.

Atje - Tek engjëjt.

Besnik - I besueshëm për Shpalljen.

E pati parë atë - Muhammedi e pati parë Xhibrilin.

Të mallkuar - Të dëbuar larg mëshirës së Zotit.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Këto ajete flasin për Kur'anin dhe zbritjen e tij. All-llahu betohet për këtë në yjet, që ndriçojnë natën dhe fshihen ditën, e cila largon natën kur vjen agimi; All-llahu betohet se ky Kur'an është nga All-llahu. Këtë Kur'an e zbriti Xhibrili, i cili është i pari i engjëjve. Ai e përcolli këtë Kur'an tek i Dërguari i All-llahut pa fshehur asgjë.

Kur kurejshët e dëgjuan këtë Kur'an, u habitën jashtë mase. Ata mohuan Kur'anin, ndërsa Muhammedin e quajtën gënje-shtar e të çmendur. Por, Muhammedi nuk ishte as gënjeshtar e as i çmendur. Ai ishte më i çiltri dhe më besniku i vendit. Kur'-ani është Fjala e Zotit të botëve.

All-llahu i pyet femohuesit kurejshë: “Ku do të shkoni ju që përgënjeshtruat ajetet e Mia dhe të Dërguarin T'im?” Dhe u premtonte atyre: “Ju nuk ju pret tjetër veçse një dënim i dhembshëm.”

Me Kur'anin udhëzohet ai, që dëshiron të ecë në rrugë të drejtë. Kjo rrugë e drejtë është Islami.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Kur'-ani është Fjala e All-llahut (E zbritur te Muhammedi me anë të Xhibrilit).
2. Xhibrili ka pozitë të madhe tek All-llahu dhe është besnik.
3. Muhammedi e ka parë shumë herë Xhibrilin, ndërsa All-llahun nuk e ka parë asnjëherë.
4. Kur'-ani këshillat (që jep) i ka për të gjithë njerëzit.
5. Asgjë nuk bëhet në këtë botë pa lejen e All-llahut.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Në ajetet e mësipërme All-llahu e ka cilësuar Xhibrilin me gjashtë cilësi. Përmendni tri prej tyre.
2. Si e quajtnë femohuesit kurejshë Muhammedin kur dëgjuan nga ai Kur'anin?
3. Flisni për dy çështje që citohen në ajete.

## SUREJA “EL INFITAR “

(Ka zbritur në Mekë, ka 19 ajete)

Ajetet 1 - 19

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur të çahet qielli,
2. Kur të shpërndahen yjet,
3. Kur të përzihen detet
4. Dhe kur të trazohen varret,
5. Atëherë, secili e di se çfarë ka punuar dhe çfarë ka lënë prapa.
6. O njeri! Ç'të mashtroi ty kundër Zotit tënd, Bujarit dhe të Butit?
7. Është Zoti Ai që të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi,
8. Të bëri në trajtën që Ai dëshiroi.
9. Jo (nuk është siç thoni ju). Ju përgënjeshtroi Ditën e Llogarisë.
10. Juve ju janë vënë pas engjëjt mbrojtës.
11. Ata janë shkruar të ndershëm të All-llahut.
12. Ata e dinë se çfarë bëni.
13. E s'ka dyshim se e mira shpërblehet me kënaqësitë e përjetshme.
14. Kurse mëkatarët janë në xhehenem.
15. Aty futen ata në Ditën e Gjykimit.
- 16.

Dhe nuk mund të largohen prej tij. 17. E ku ta dish ti se ç'është Dita e Gjykimit? 18. E ku ta dish ti se ç'është Dita e Gjykimit? 19. Është Dita kur askush nuk do të mund të të ndihmojë për asgjë; atë Ditë çështja i takon vetëm All-llahut!

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure tregon ndryshimet që do të pësojë gjithësia në Ditën e Kijametit. Ajo flet për të shpëtuarit dhe të humburit dhe për llogarinë që do të jepet para All-llahut të Madhërishëm.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Ç'të mashtroi ty kundër Zotit tënd? - Ç'të bëri ty të dalësh kundër Zotit tënd?

Mëkatarët - Ata që nuk iu bindën All-llahut të Madhërishëm.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Kjo sure i përngjet sures së mëparshme, “Tekuir”. Sureja flet për Ditën e Gjykimit dhe për ngjarjet përpara saj, si çarja e qiellit, rënia e yjeve, bashkimi i deteve dhe i oqeaneve, hapja e varreve dhe dalja ç’ka brenda tyre. Atë Ditë njeriu do ta kuptojë se ku ka qenë i mangët.

All-llahu e qorton njeriun: “Çfarë ndodhi me ty që e mohove Zotin tënd, i Cili të krijoi ty në mënyrën më të përsosur?”

Vërtet, njeriu e mohon Zotin tij për shkak të paditurisë së tij e për shkak se ai i bindet Shejtanit dhe cytjeve të tij.

All-llahu ka ngarkuar engjëjt që t’ia shkruajnë njeriut veprat, të mëdha apo të vogla qofshin, që t’i kërkojë llogari për to në Ditën e Gjykimit.

Pasi All-llahu t’u kërkojë llogari njerëzve për punët e tyre, ata do të ndahen në dy grupe; të shpëtuarit dhe të humburit. Të shpëtuarit do të jenë besimtarët, ata të cilët besuan dhe që do të hyjnë në xhenet. Të humburit do të jenë jobesimtarët, të cilët do të hyjnë në zjarrin e xhehenemit, ku do të digjen dhe nuk do të dalin prej tij.

All-llahu tregon se kjo Ditë është një Ditë e madhe dhe e frikshme, kur askush nuk mund të ndihmojë tjetrin, sepse e gjithë çështja i takon vetëm All-llahut.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Në Ditën e Kijametit gjithësia do të ndryshojë me urdhrin e All-llahut.
2. Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të dalin të gjallë nga varret.
3. Në Ditën e Gjykimit njeriu do të shohë veprat që pati bërë në këtë botë; ato janë regjistruar nga engjëjt.
4. Njerëzit do të ndahen në dy grupe; një grup do të hyjë në xhenet dhe një grup në xhehenem.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Sa herë është përmendur emri i Ditës së Gjykimit në sure?
2. Si do ta komentoni ajetin ku përmendet Dita e Gjy-kimit?
3. Si do ta komentoni “Dhe kur të trazohen varret”?
4. Ajeti ka përmendur një detyrë të engjëjve ndaj njeriut. Cila është ajo?
5. Bashko fjalinë e kolonës A me fjalinë përkatëse të kolonës B.

A

Në Ditën e Gjykimit do të hapen varret.

All-llahu e krijoi njeriun me trajtën më të bukur.

Njerëzit do të ringjallen për të dhënë llogari.

B

Besimtarët bëjnë vepra të mira.

Shumë prej njerëzve nuk e falenderojnë Zotin për këtë begati.

Shpërblimi i besimtarëve është xheneti.

6) Në këtë sure All-llahu flet për yjet: *“Kur të shpërndahen yjet”*. Në suren *“Tekuir”* është një ajet me të njëjtin kuptim. Thoni ajetin.

## SUREJA “EL MUTAFFIFIN”

(E zbritur në Mekë, ka 36 ajete)

Ajetet 1 – 17

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Të mjerët ata që masin e peshojnë mangët. 2. Ata, që kur marrin prej njerëzve, për vete e plotësojnë peshën. 3. E kur u peshojnë të tjerëve, ua lënë mangët. 4. A nuk e dinë ata se kanë për t'u ringjallur 5. Në një Ditë të Madhe. 6. Në Ditën, kur njerëzit ngrihen për të dalë përpara Zotit të botëve. 7. Jo, të mos rrinë në pakujdesi, se shënimet e veprave të mëkatarëve janë në Sixhin. 8. E ku e di ti se ç'është Sixhini? 9. Ai është një libër i qëndisur. 10. Ajo Ditë është shkatërrimi për gënjeshtarët, 11. Të cilët nuk e besojnë Ditën e përgjegjësisë. 12. E atë Ditë nuk e mohon askush, përveç atij që është zhytur në mosbesim e në punë të këqija 13. E ja, kur i lexohen atij argumentet tona, thotë: “Legjenda të të pareve!...”Jo, nuk është ashtu! 14. Por, zemrat e tyre janë njobosur nga të këqijat që ata bënë. 15. Vërtet, atë Ditë do të jenë të penguar prej Zotit të tyre, 16. Pastaj ata do të hyjnë në xhehem 17. Dhe do t'u thuhet: “Ky është ai, të cilin e keni përgënjeshtuar.”

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për ata që vjedhin në peshë, për të shpëtuarit dhe të humburit dhe për sjelljet e armiqve të Islamit.

## KUPTIMI I FJALËVE

Të mjerët - Janë ata të cilët do të vuajnë dënimin në Botën tjetër.

Ua lënë mangët - I vjedhin në peshë.

Sixhin - Vend i pistë.

Në mosbesim - Larg së Vërtetës.

Legjenda të të parëve - Përralla dhe fantazira.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Islami kërkon nga tregtari musliman që të jetë i çiltër dhe i pastër me njerëzit në shitblerje. Për këtë All-llahu i Madhërishtëm u tërhoqi vëmendjen njerëzve në këtë sure: ata të cilët vjedhin në peshë do të kenë dënim të madh.

Matja dhe pesha e mangët është ndër veprat më të këqija. Disa tregtarë, kur duan të blejnë ndonjë gjë nga të tjerët, e marrin të plotë, ndërsa, kur u shesin ndonjë gjë të tjerëve, ua japin të mangët. All-llahu i Madhërishtëm u ka premtuar atyre një dënim të madh në Ditën e Gjykimit, sepse me të vërtetë vepra e tyre është e keqe dhe atë e bëjnë ata që nuk e besojnë Ditën e Gjykimit. Ata që e besojnë Ditën e Gjykimit, nuk vjedhin në peshë, sepse ata e dinë se në qoftë se e bëjnë këtë, do të

dënohen para All-llahut të Madhërishëm. All-llahu i Madhërishëm e quajti këtë vepër të ndyrë. Ai thotë se kjo vepër e ndyrë do të shkruhet në një vend të ndyrë.

Ata, të cilët nuk besojnë në Ditën e Gjykimit, do të kenë dënim të madh. Ajetet e mësipërme përmendin disa nga veprat dhe cilësitë e gënjeshtarëve. E para, ata kanë shkelur mbi të drejtat e Zotit dhe mbi të drejtat e njerëzve. E dyta, ata janë mbushur me mëkate dhe nuk përfitojnë nga Kur’ani i Madh. E treta, mëkatet e tyre ua kanë mbuluar zemrat dhe nuk lënë që në to të hyjnë këshillat.

Qafirët nuk do të mund ta shohin All-llahun në Ditën e Gjykimit, siç kanë për ta parë besimtarët. Ata do të hyjnë në xhehenem, sepse e përgënjeshtroan Kur’anin, i cili është Fjala e All-llahut të Madhërishëm.

## Ç’NA MËSOJNË HADITHET

1. Mashtrimi në peshore është i ndaluar (haram). Muhammedi (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) thotë: *“Ai që mashtron, nuk është prej nesh.”*
2. Islami kujdeset që në marrëdhëniet ndërmjet muslimanëve të mos ketë mashtrime.
3. Besimi në Ditën e Kijametit e bën njeriun që të largohet nga mëkatet.
4. Punët e qafirëve shkruhen në një vend të ndyrë.

5. Mëkatet e shkatërrojnë zemrën, siç thuhet në një hadith: “Kur bën një mëkat, robit i bëhet një pikë e zezë në zemër; kur pendohet, ajo i fshihet; kur ai bën mëkate më shumë, ajo i shtohet.” (E përcjell Tirmidhiu)
6. Jobsimtarët nuk kanë për ta parë Zotin në Ditën e Gjykimit.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Çfarë dënimi i ka premtuar All-llahu i Madhërishtëm mash-truesit?
2. Ku shkruhen veprat e jobsimtarëve?
3. Është një tregim që flet për një tregtar të sinqertë e të drejtë. Cili është ai?
4. Cili është ajeti që tregon se qafirët nuk do ta shikojnë Zotin në Ditën e Gjykimit?

## **AJETET 18 - 36**

18. Jo, nuk janë të njëjtë! Se libri i të mirëve gjendet në Ilijin. 19. E ku e di ti se ç’është Ilijini? 20. Është një libër i qëndisur. 21. Të cilin e dëshmojnë engjëjt që janë më të afërmit (e All-llahut). 22. E s’ka dyshim se vepërmirët do të jenë në kënaqësi të përjetshme. 23. Të mbështetur në

kolltukë vështrojnë. 24. Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve. 25. U jepet të pinë pije në enë të mbyllura. 26. Pije që në fund u vjen era myshk. E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën. 27. Ajo pije do të jetë një përzierje Tesnimi. 28. Krua nga i cili do të pinë më të afërmit e Zotit. 29. Mëkatarët ishin ata që i përqeshnin ata që besuan 30. Dhe kur (ata që besuan) kalonin pranë tyre, ata (mëkatarët) ia bënin me sy njëri-tjetrit. 31. E kur ktheheshin te familjet e veta, ktheheshin të kënaqur. 32. Dhe kur i shihnin, ata thonin: “S’ka dyshim se ata janë të humbur!” 33. Po ne nuk i caktuam atë atyre. 34. E sot, ata që besuan do të tallen me jobesimtarët. 35. Duke qëndruar të mbështetur në kolltukë e duke vështruar. 36. A thua u shpërblyen jobesimtarët për atë që punuan?

## KUPTIMI I FJALËVE

Të mirët - Ata që e kanë frikë All-llahun e Madhërishëm

Ilijin - Vend i lartë.

E dëshmojnë më të afërmit - E shikojnë engjëjt bujarë.

Tesnim - Emër kroi në xhenet.

Ktheheshin të qeshur - Ktheheshin të qeshur dhe duke i fyer muslimanët.

Ata që lakmojnë të mirën - Ata që lakmojnë veprat e mira.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Pasi u fol për gjendjen e jobesimtarëve në Zjarr në ajetet e mëparshme, këto ajete tregojnë pozitën e muslimanëve në xhenet, të premtuar nga All-llahu i Madhërishëm.

All-llahu i Madhërishëm i pranoi veprat e besimtarëve dhe i regjistroi ato në një libër të ruajtur në një vend të lartë, të cilin e mbikëqyrin engjëjt.

Ditën e Gjykimit All-llahu i Madhërishëm do t'i fusë besimtarët në xhenet, si shpërblim për veprat e tyre të mira e të pastra. Ata do të gjejnë atje çdo gjë të dëshiruar nga zemrat e tyre. Ata do të ulen në kolltukë të lartë, të qeshur e të gëzuar nga shpërblimi që u dha All-llahu i Madhërishëm. Atyre do t'u jepen pije të shijshme, që rrjedhin nga burimet e xhenetit. Këto pije vijnë era misk dhe nuk do të jenë si pijet e kësaj bote, dehëse dhe të dëmshme për trupin.

Banorët e xhenetit e meritojnë këtë shpërblim, sepse ata u treguan durimtarë ndaj sprovave të kësaj bote dhe fyerjeve të jobesimtarëve.

Këto ajete tregojnë disa nga talljet e jobesimtarëve, kur i shikonin muslimanët. Ata talleshin me veprat e mira të muslimanëve dhe, kur i shihnin ata, u shkelnin syrin njëri-tjetrit dhe ktheheshin në shtëpitë e tyre të gëzuar për atë që u kishin punuar muslimanëve. Kur i shikonin muslimanët që faleshin, u thoshin atyre: *“Ju jeni të humbur.”* All-llahu i Madhërishëm i kundërshtoi ata: *“Ju nuk jeni përgjegjës për besimtarët dhe nuk keni të drejtë të thoni se ata janë të humbur, sepse në të vërtetë jeni ju të humburit.”*

Ditën e Gjykimit do të ndryshojnë gjërat. Besimtarët, të ulur në kolltukë, do të shikojnë jobesimtarët tek digjen në zjarr. Kjo sure tregon se jobesimtarët do të dënohen për shkak të punëve të tyre të këqija në këtë botë. Ditën e Gjykimit këto punë do të kthehen mbi ta. Ata u tallën me muslimanët në këtë botë dhe “muslimanët do të tallen me ta në Ditën e Gjykimit.”

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm i ruan veprat e besimtarëve duke i regjistruar ato në një vend të lartë, që më pas ata të shpër-blehen.
2. All-llahu i Madhërishtëm u ka premtuar besimtarëve mirësi të cilat nuk i ka parë syri, nuk i ka dëgjuar veshi dhe as janë menduar ndonjëherë.
3. All-llahu i këshillon njerëzit që të nxitojnë të bëjnë vepra të mira e të dobishme.
4. T'i fyesh të tjerët, të qeshësh me ta e t'i vështrosh me përçmim janë vese të këqija; ai që vepron kështu, do të dënohet në Ditën e Gjykimit.
5. Ditën e Gjykimit besimtarët do të jenë të gëzuar, kurse qafirët do të jenë të trishtuar.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përmendni tri nga veset e jobesimtarëve, të cituara nga ajetet e mësipërme.
2. Vendosni shenjë të saktë (✓) ose të pasaktë (✗) për fjalitë të mëposhtme:
  - a) Muslimanit i lejohet ta fyejë vëllanë musliman (\_\_\_)
  - b) Veprat e jobesimtarëve do të kthehen mbi ta në Ditën e Kijametit dhe ata do të dënohen prej tyre (\_\_\_)
  - c) Besimtarët do t'i shikojnë jobesimtarët duke u djegur në zjarr (\_\_\_)
3. Tregoni tri çështje që janë cituar nga ajetet.
4. Kur do të qeshin besimtarët me jobesimtarët?

## SUREJA “EL INSHIKAK “

(E zbritur në Mekë, ka 25 ajete)

Ajetet 1 - 15

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur të pëlçasë qielli 2. E t'i bindet urdhrit të Zotit të vet, ashtu siç i takon. 3. Kur Toka të shtrihet në tërë gjerësinë e saj 4. E kur të nxjerrë ç'ka brenda e të çlirohet. 5. E kur t'i bindet Zotit të vet, ashtu siç i takon. 6. O njeri! Vërtet, ti përpiqesh me një përpjekje të madhe që të çon te Zoti yt e do ta gjesh (Zotin tënd). 7. E përsa i përket atij, të cilit libri i vet i jepet nga e djathta. 8. Atij do t'i kërkohet llogari e lehtë 9. Dhe do të kthehet te familja e vet i gëzuar. 10. E përsa i përket atij, të cilit libri i jepet pas shpinës, 11. Ai do t'i ndjellë vetes shkatërrim, 12. Do të hyjë në Zjarr të ndezur fort. 13. Ai ka qenë i gëzuar në familjen e vet. 14. Dhe ka menduar se nuk ka për t'u kthyer, 15. Po, vërtet, Zoti i tij gjithnjë e ka parë atë.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure flet për ndryshimet që do të ndodhin në Ditën e Gjykimit dhe për gjendjen e njeriut në këtë botë dhe në Botën e Përtejme.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Të shtrihet - Malet do të sheshohen e toka do të shtrihet.

Të nxjerrë ç'ka brenda - Të nxjerrë të vdekurit.

Çlirohet - Çlirohet nga të vdekurit.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Fillimi i kësaj sureje flet për Ditën e Kijametit. All-llahu i Madhërishëm thotë se “kur të çahet qielli dhe të hapet dyer-dyer, do të shtrihet toka e të sheshohen malet, do të dalin të vdekurit nga varret e tyre, që të japin llogari për fjalët e veprat e kryera në këtë botë.” All-llahu i drejtohet njeriut me këto fjalë: *“Ti o njeri, je krijuar mbi këtë tokë që të punosh dhe të lodhesh në të, e pas vdekjes do të dalësh nga varri e do të kthehesh te Zoti yt për të dhënë llogari.”*

Pas llogarisë, njerëzit do të ndahen në dy grupe:

Grupi i parë: do të jenë të shpëtuarit, ata që janë pyetur me butësi. Pjesëtarë të këtij grupi janë besimtarët, të cilët punuan vepra të mira dhe u penduan për mëkatet e pakta që kishin bërë. Të gjithë këta do ta marrin librin me dorën e djathtë, e kjo do të thotë se janë të shpëtuar nga Zjarri.

Grupi i dytë: Pjesëtarë të këtij grupi do të jenë ata të cilët All-llahu do t’i dënojë, sepse e mohuan Atë. Të gjithë ata do ta marrin librin të hidhëruar. Ata do ta kuptojnë se cili do të jetë fundi i tyre, prandaj do ta fshehin librin e tyre. Jobsimtari do të parapëlqente që të mos ishte krijuar fare. Ata që do të futen në xhehenem, do të vuajnë dënimin e dhembshëm, sepse patën bërë vetëm vepra të këqija dhe patën harruar se do të ktheheshin tek All-llahu i Madhërishëm e do të jepnin llogari para Tij.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Në Ditën e Kijametit do të ndryshojnë qielli dhe Toka.
2. Njerëzit do të dalin nga varret për të dhënë llogari.
3. Kjo botë është vendi i lodhjes dhe i sprovimeve.
4. Besimtari duhet ta lusë Zotin, që t'i kërkohet llogari me të butë. Vetë Profeti ynë Muhammed i lutej All-llahut në namaz, që t'i kërkohet llogari me të butë. T'u kërkohet llogari me të butë do të thotë që t'u falen mëkatet, sepse llogaria është dënim, siç thuhet në një hadith: *“Nuk ka njeri që t'i kërkohet llogari e të mos mundohet.”* (Buhariu)<sup>4</sup>
5. Ditën e Gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe: njëri do të futet në xhenet, i kënaqur, kurse tjetri do të hyjë në Zjarr, i trishtuar.
6. Ai, i cili do ta ketë kaluar jetën e vet në dëfrim, në Ditën e Gjykimit do të hyjë në Zjarr.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Si do ta marrë besimtari librin në Ditën e Gjykimit?

---

4) Qëllimi i këtij hadithi është të bëjë të qartë se edhe të dalësh para All-llahut, për të dhënë llogari, është e mundimshme.

2. Ajetet përmendin dy gjëra që do t'i ndodhin muslimanit kur ta marrë librin nga e djathta. Cilat janë ato?

3. Plotësojini fjalitë e kolonës A me fjalitë e përshtatshme të kolonës B:

A

Toka do t'i nxjerrë njerëzit që ka brenda.

Jobsimtari vetëm tallet dhe dëfrehet në këtë botë.

Besimtari do ta marrë librin nga e djathta.

B

Njerëzit do të kthehen tek All-llahu për të dhënë llogari.

Besimtari do të gëzohet në Ditën e Gjykimit.

Jobsimtari do të pendohet në Ditën e Gjykimit.

4. Kjo botë është vendi i lodhjes dhe i sprovimeve. Tregoni ajetin me të njëjtin kuptim.

## AJETET 16 - 25

16. Betohe në kuqëlimin e horizontit pas perëndimit! 17. Në natën e në çfarë ajo tubon. 18. Në hënën, kur ajo është e plotë. 19. Ju, patjetër, do të përjetoni gjendje pas gjendjeje. 20. E ç'kanë ata që nuk besojnë? 21. E, kur u lexohet atyre Kur'ani, nuk përulen. 22. Ata që nuk besuan edhe

përgënjeshtrian. 23. E All-llahu e di më mirë se ç'fshehin ata! 24. Lajmëroji, për një dënim të dhembshëm. 25. Me përjashtim të atyre që besuan e bënë vepra të mira, të cilët kanë shpërblim të vazhdueshëm.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

All-llahu betohet në disa nga krijesat e Tij të mahnitshme, siç janë horizonti i kuq pas perëndimit të Diellit. All-llahu betohet në natën, që vjen pas perëndimit. All-llahu betohet në hënën, kur ajo është e plotë. Të gjitha këto tregojnë fuqinë e All-llahut. All-llahu betohet se njerëzit do të kenë ditë të lodhshme dhe të vështira në këtë botë. Kurse në Botën e Përtejme lodhja dhe vështirësia vijnë nga dënimet e rënda që do të kenë në atë Ditë ata që e mohuan All-llahun. Atëherë, përse njerëzit nuk e besojnë All-llahun që u ka zbritur Kur'anin, i cili përmbledh ligje dhe këshilla, që të orientojnë për tek All-llahu?! Përse nuk u binden njerëzit urdhrave të Tij?!

Qafirët e përgënjeshtrojnë Kur'anin dhe Ditën e Gjykimit. All-llahu i di veprat e tyre, për të cilat ata do të dënohen. All-llahu i Madhërishtëm i thotë Muhammedit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të): “Lajmëroji jobesimtarët për një dënim të dhimbshëm në Ditën e Gjykimit. “Kurse atyre, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u ka premtuar xhenete dhe begati të përhershme, si shpërblim për punët e tyre të mira.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu betohet në disa nga krijesat e Tij. Njeriut nuk i lejohet të betohet në ndonjë krijesë. Ai duhet të betohet vetëm në All-llahun.
2. Ditën e Gjykimit njeriu do të ketë mundim dhe vuajtje.
3. All-llahu i këshillon njerëzit që të besojnë dhe të bëjnë vepra të mira, sepse janë punët e mira ato që të shpëtojnë nga zjarri i xhehenemit.
4. All-llahu u ka premtuar jobesimtarëve dënim të dhimbshëm në Zjarr, kurse besimtarëve shpërblim të madh në xhenet.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Vështrojeni diellin në perëndim. Përshkruajeni perëndimin e diellit me disa rreshta.
2. Në ajetet e mësipërme është një ajet që, po ta lexosh, duhet të bësh sexhde. Si quhet kjo sexhde?

## SUREJA “EL BURUXH “

(E zbritur në Mekë, ka 22 ajete)

Ajetet 1 - 11

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për qiellin me plot yje! 2. Për Ditën e Premtuar! 3. Për atë që dëshmon dhe atë që dëshmohet!  
4. Mallkuar qofshin ata, që hapën hendeqet 5. Me zjarr e me plot lëndë djegëse, 6. Kur ata rrinin  
ulur rreth tij (zjarrit). 7. Shikonin atë që u bënë besimtarëve 8. Nuk kishin pse t’i urrenin, përveç  
sepse ata (besimtarët) e besuan (All-llahun), Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin, 9. Të Cilit i takon  
sundimi i qiejve dhe i Tokës. All-llahu është dëshmitar i gjithçkaje. 10. Është e sigurt se ata që i  
sprovuan besimtarët dhe besimtarët e nuk u penduan, kanë dënimin e xhehenemit dhe dënimin e  
djegies. 11. Vërtet, ata që bënë vepra të mira, do të jenë në xhenete (kopshte), nën të cilët  
rrjedhin lumenj e ky është shpëtimi i madh.

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për të zotët e hendekut, për fuqinë e All-llahut dhe për shkatërrimin e femohuesve.

## KUPTIMI I FJALËVE

Ditën e premtuar - Ditën e Gjykimit.

Atë që dëshmon - Atë që dëshmon kundër njeriut në Ditën e Gjykimit.

Atë që dëshmohet - Atë gjë, e cila dëshmohet nga njerëzit, si, psh.: dita e Arafatit, dita e xhumasë etj.

I sprovuan besimtarët - I dogjën në zjarr.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

All-llahu betohet në disa nga krijesat e Tij, se ata që hapën hendekun dhe dogjën besimtarët janë të mallkuar dhe do të digjen në zjarrin e xhehenemit.

Ngjarja, për të cilën flitet në sure, ka ndodhur shumë kohë më parë. Një mbret kishte një magjistar, i cili e ndihmonte atë me magjitë e tij. Një ditë magjistari i thotë mbretit: *“O mbret, unë tashmë jam plakur, prandaj më sill mua një djalë që t’i mësoj magjinë e ti të mbështetesh tek ai.”* Mbreti i solli atij një djalë të mençur, i cili shkonte çdo ditë te magjistari dhe mësonte nga ai.

Përgjatë rrugës për te magjistari ishte edhe një burrë i mirë, i cili i bindej All-llahut. Një ditë djali hyri tek ai burrë dhe dëgjoi prej tij fjalë të bukura e të urta. Burri thoshte se All-llahu është Një e i

Vetëm. Kjo gjë i bëri përshtypje djaloshit, ndaj filloi të vinte çdo ditë te ky njeri i mirë. Një ditë, djaloshi pa një kafshë të egër, e cila kishte frikësuar njerëzit. Mori një gurë dhe tha: *“O Zoti im, në qoftë se burri i mirë e i urtë është më i dashur tek Ti se magjistari, atëherë vrite këtë kafshë, e cila u ka zënë rrugën njerëzve.”* Pastaj e goditi me gurë e kafsha ngordhi.

Më pas djaloshi shkoi te njeriu i mirë dhe i tregoi atij se ç’kishte ndodhur. *“O djalosh, - i tha burri, - je bërë më i dashur se unë tek All-llahu.”* Që atëherë djaloshi filloi të shëronte njerëzit me lejen e All-llahut e kështu u bë i njohur tek ata. Një i verbër kishte dëgjuar për djaloshin. I verbëri ishte një nga shokët e mbretit. Ai shkoi te djaloshi dhe i tha: *“Ma kthe shikimin.”* Djaloshi iu përgjigj: *“Unë nuk shëroj askënd. Ai, që shëron është All-llahu. Në qoftë se ti beson, atëherë unë do t’i lutem Atij që të të shërojë.”* I verbëri besoi dhe djaloshi u lut për të e All-llahu iu përgjigj lutjes së tij. Burri që u shërua shkoi te mbreti.

Kur mbreti e pa që shikonte i tha: *“Kush ta solli shikimin?”* Ai iu përgjigj: *“Zoti im!”* Mbreti iu hakërru: *“Mos vallë, ke zot tjetër veç meje?”* Ai iu përgjigj: *“Ai është Zoti im dhe Zoti yt.”* Atëherë mbreti urdhëroi që ta torturonin, derisa ai i tregoi për njeriun e mirë që kishte njohur. Mbreti urdhëroi ta gjenin e ta sillnin atë. E sollën edhe njeriun e mirë. Mbreti e urdhëroi edhe atë që të kthehej nga feja e tij, por njeriu i mirë nuk pranoi ta linte fenë. Atëherë mbreti urdhëroi që të vrisnin edhe njeriun e mirë edhe shokun e mbretit. Pasi i vranë ata, u përpoqën ta vrisnin edhe djaloshin, por nuk ia arritën dot qëllimit. U përpoqën në shumë mënyra, por nuk mundën. Donin ta mbysnin, u përpoqën ta hidhnin nga mali, por më kot. All-llahu e shpëtonte atë. Atëherë djaloshi tha: *“O Mbret, ti kurrë nuk do të mundesh të më vrasësh mua, vetëm nëse do të veprosch si të them unë.”* *“E ç’dubet të bëj?”*, - tha mbreti. *“Mblidhi të gjithë njerëzit, - i tha djaloshi, - merr një shigjetë e thuaj me zë të lartë: “Bismi-lab rabil gulam” (Me emrin e All-llahut, Zotit të djaloshit) e më qëllo me shigjetë. Atëherë ke për të më*

*vrarë.*” Mbreti veproi si i tha djaloshi dhe e vrau atë. Kur e panë njerëzit, besuan në All-llahun, Zotin e djaloshit. Mbreti u inatos me këtë gjë dhe urdhëroi ushtarët që të hapnin një hendek, të ndiznin në të një zjarr të madh e të hidhnin aty të gjithë ata që besuan në All-llahun. Mes njerëzve ishte edhe një besimtare. Ajo kishte me vete fëmijën e saj të vogël. Kur e sollën ushtarët, ajo u zmbrops pak, por foshnja që kishte në duar u foli: *“Duro nëna ime, se ti je me të drejtën.”* Dhe ajo u hodh në zjarr.

All-llahu e ka zbritur këtë sure kur, në kohën e Muhammedit, besimtarët vuanin nga qafirët, për t’u treguar atyre, se duhej të duronin siç duruan besimtarët e Uhdudit.

Në këtë sure ka gjithashtu edhe paralajmërim për qafirët kurejshë, në qoftë se do të vazhdonin t’u bënë keq besimtarëve. Padronët e hendekut, të cilët janë mbreti, ushtarët dhe njerëzit e mbretit, do të futen në zjarr të xhehenemit, ku do të vuajnë dënimin. Duart dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë kundër tyre në Ditën e Gjykimit, sepse ata i kanë dënuar dhe torturuar besimtarët. All-llahu do të jetë Dëshmitar për këtë gjë.

Ata besimtarë nuk i bënë keq mbretit dhe as nuk gabuan; ata vetëm besuan në All-llahun e Madhërishtëm e për këtë u dogjën të gjallë. All-llahu do t’i djegë jobesimtarët në të njëjtën mënyrë. Por zjarri i xhehenemit nuk është si ai i kësaj bote. Ai është shumë më i madh e i përfllakur. Në qoftë se jobesimtarët kthehen e besojnë, atëherë All-llahu ua fal mëkatet dhe kjo tregon se All-llahu është i Mëshirshëm.

All-llahu do t’i fusë në xhenet të gjithë besimtarët, të cilët janë kapur fort pas fesë së tyre dhe kanë bërë punë të mira.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu e ka krijuar xhehenemin për të dënuar femohuesit, të cilët i kanë munduar besimtarët në këtë botë.
2. Në tregimet e popujve të kaluar ka udhëzime e mësimë për muslimanët.
3. Besimi në All-llahun është krenari për muslimanët dhe jo mundim për ta, siç mendojnë disa jobesimtarë.
4. Shpëtimi më i madh për besimtarin është të largohet nga zjarri i xhehenemit dhe të futet në xhenet.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përse djaloshi shkante te magjistari?
2. Si arriti djaloshi ta kuptonte se burri ishte më i mirë se magjistari?
3. Si arriti mbreti ta vriste djaloshin?
4. Çfarë bëne njerëzit kur mbreti vrau djaloshin?

5. Dita e Premtuar është Dita e Gjykimit. Përmend edhe tre emra të tjerë të kësaj dite, duke u mbështetur në suret e më-parshme.
6. Bëni pyetje për përgjigjet e mëposhtme:
- a) Magjistari kërkoi nga mbreti që t'i sillte një djalë.
  - b) Mbreti i vrau njerëzit sepse ata besuan në një Zot të Vetëm.
  - c) Në rrugën që përshkonte djaloshi, banonte një njeri i mirë, që adhuronte All-llahun e Madhërishëm.
7. Përmendni tri dobi, që përfituat nga tregimi.
8. Përshkruajeni tregimin e As'habul Uhdudit me jo më pak se gjashtë rreshta.

## **AJETET 12 - 22**

12. Është e vërtetë se goditja e Zotit tënd është e fortë. 13. Në të vërtetë, Ai është që e fillon dhe e rikthen (jetën). 14. Ai është që fal mëkatet, Ai është i Dashur. 15. Është Zoti i Arshit të Madhërishëm. 16. Që bën atë që dëshiron. 17. A të ka ardhur ty lajmi i ushtrive. 18. Të Faraonit dhe të Themudit? 19. Por mohuesit, vazhdojnë me gënjeshtër. 20. E, All-llahu i ka rrethuar ata. 21. Përkundrazi, Ai është Kur'an i lavdishëm. 22. Në një pllakë të ruajtur mirë.

## KUPTIMI I FJALËVE

Goditja - Dënimi.

Fillon dhe e rikthen - Krijon e më pas e ringjall në Ditën e Ringjalljes.

Zoti i Arshit - Sunduesi i Arshit.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Pas atyre që hapën hendekun, All-llahu i drejtohet Muhammedit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të): “Zoti yt është i Gjithëfuqishëm për t’i dënuar jobesimtarët dhe për t’i shkatërruar ata, sa të mos mbesë asnjë prej tyre, sepse Ai i krijoi ata për të parën herë dhe do t’i ngjallë ata për së dyti e do t’u kërkojë llogari për çfarë punuan.” Ajetet përmendin disa nga cilësitë e All-llahut: “Ai është që krijon për herë të parë dhe e ringjall krijesën e Tij. Ai është i Dashur, Ai është Zoti i Arshit. All-llahu bën ç’të dojë e asgjë nuk qëndron mes Tij e asaj që Ai dëshiron.”

Në fund të kësaj sureje, All-llahu i thotë Muhammedit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të): “Me të vërtetë, Ne të treguam ty për disa nga ata që e mohuan All-llahun, si Faraoni, të cilin Ne e mbytëm dhe shpëtuam Musanë (paqja e All-llahut qoftë mbi të), si dhe për gjendjen e Themudit, i cili përgënjeshtroi të dërguarin Salih, e Ne e shkatërruam me një bubullimë të fortë.”

Kjo fjalë ishte për qafirët kurejshë, në qoftë se ata do të vazhdonin t'u bënin keq besimtarëve e të qëndronin në mohim. All-llahu i shkatërroi popujt para tyre, për arsye se mohuan All-llahun e ata qenë më të fortë se kurejshët. Në qoftë se All-llahu dëshiron të shkatërrojë një popull, atëherë e shkatërroi atë dhe askush nuk i bën dot ballë. Kurejshët mohuan Kur'anin e Shenj-të, i cili është shkruar në Leuhi Mahfudh.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

- 1.All-llahu u jep dënim të rreptë femohuesve.
- 2.All-llahu ua fal mëkatet atyre që pendohen dhe ia lehtëson besimtarit të devotshëm mundin për të bërë veprën e mirë.
- 3.All-llahu u tregon njerëzve se edhe popujt e mëparshëm janë udhëzuar.
4. Arshi dhe Leuhi Mahfudhi janë krijesa të All-llahut, të cilat ne nuk i kemi parë.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Si quhej i Dërguari te Faraoni? Po i Dërguari te Themudi?

2. Ajetet përmendën dy krijesa të mëdha, të cilat ne nuk i kemi parë. Cilat janë ato?
3. “All-llahu thotë e bën atë që dëshiron”. Si do ta komentoni këtë?
4. Thoni suren në të cilën flitet për Faraonin.

## SUREJA “ET TARIK “

(E zbritur në Mekë, ka 17 ajete)

Ajetet 1 - 10

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për qiellin dhe yllin ndriçues! 2. E ku e di ti se ç’është tariku? 3. Ai është shpuesi (i errësirës me dritën e tij). 4. Nuk ka njeri që të mos ketë Mbrojtës.<sup>5</sup> 5. Le të shikojë njeriu se prej çfarë është krijuar. 6. Është krijuar prej një pike uji që hidhet fuqishëm, 7. Që del nga shtylla kurizore e nga dërrasa e gjoksit. 8. E s’ka dyshim se Ai ka fuqi ta rikthejë në jetë atë. 9. Ditën, kur do t’i kontrollohen të fshehtat. 10. E ai (njeriu) nuk ka as forcë e as ndihmëtarë.

---

5) Ai mbrohet nga All-llahu në shumë mënyra, madje, nga mënyra të cilat ai nuk i di.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për krijimin e njeriut dhe për ringjalljen e tij pas vdekjes; ajo flet për Kur'anin dhe paralajmëron femohuesit.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Në fillimin e kësaj sureje All-llahu i Madhërishtëm betohet për qiellin. Betohet edhe për yjet, që me dritën e tyre shpojnë errësirën e natës. Betohet në yjet e në meteorët. All-llahu betohet në këto krijesa të mëdha, se njeriu nuk është lënë i vetëm. Ai ka me vete engjëjt që e ruajnë dhe që i regjistrojnë veprat që bën.

All-llahu i Madhërishtëm e fton njeriun të mendojë për krijesat e All-llahut e të pyesë veten si janë krijuar ato. Fillimi i krijimit të njeriut është një pikëz fare e vogël, nga fara (sperma) e mashkullit dhe veza e femrës, që piqen bashkë e formojnë një pikë, e cila më pas kthehet në një foshnje të vogël në barkun e nënës së vet. Më pas del në këtë botë e fillon e rritet, derisa bëhet i moshuar, pastaj vdes.

All-llahu i Madhërishtëm është i Plotfuqishëm për ta ringjallur atë. Kjo do të ndodhë në Ditën e Ringjalljes. Atë Ditë, All-llahu do t'i nxjerrë përpara njeriut fjalët që ka thënë e veprat që ka bërë dhe që ai mendonte se ishin të fshehta.

Në Ditën e Gjykimit njeriu nuk do të gjejë forcë që ta mbrojë e ta ndihmojë. Njeriu do të gjejë vetëm punën e tij. Janë veprat e tij ato që do t'i bëjnë mirë ose keq.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. Çdo njeri ka me vete engjëj, që e ruajnë dhe që regjistrojnë ç'bën e ç'thotë ai.
2. Krijimi i njeriut në barkun e nënës fillon nga një pikëz fare e vogël.
3. All-llahu i Madhërisëm është i Plotfuqishëm që ta ringja-llë njeriun pas vdekjes për t'i kërkuar llogari.
4. Në Ditën e Gjykimit, All-llahu i Madhërisëm do ta bëjë të dukshme çfarë fshihte njeriu.
5. Në Ditën e Gjykimit njeriu nuk do të gjejë forcë ku të mbështetet e asnjë që ta ndihmojë.

## **PYETJE E USHTRIME**

1. Përmendni tri çështje që na i mësojnë ajetet.
2. Ç'do të thotë ajeti: “Nuk ka njeri që të mos ketë Mbroj-tës.”?

## AJETET 11 - 17

11. Për qiellin që na e kthen shiun.<sup>6</sup> 12. E tokën, që çahet (për të dalë bimët). 13. Vërtet, ai (Kur'ani) është Fjalë që dallon (të mirën nga e keqja). 14. Ai nuk është për lojë. 15. Ata, vërtet ngrënë kurthe. 16. Por dhe Unë përgatis dësh-timin e kurtheve të tyre. 17. E ti jepu jobesimtarëve afat, jepu atyre edhe pak kohë!

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

All-llahu i Madhërishtëm betohet në qiellin, i cili sjell shiun mbi tokë dhe për tokën. Kur bie shiu, toka çahet për të nxjerrë bimët. All-llahu betohet për qiellin e për tokën se Kur'ani është i vërtetë, larg kotësive dhe lojrave të fjalëve, prej të cilave nuk fitohet asgjë. Por, megjithëse Kur'ani është i vërtetë dhe i Dërguari i çiltër, femohuesit ngulnin këmbë në përgënjeshtimin e tyre dhe ngrinin kurthe kundër Islamit e muslimanëve. All-llahu u thotë muslimanëve të rrinë të qetë, sepse Ai është me ta, kujdeset për ta, i ruan ata dhe bën të dështojnë planet e armiqve të Islamit. All-llahu i Madhërishtëm është i Plotfuqishmi, Ai mund t'i shkatërrojë e t'i dënojë ata, por All-llahu i Madhërishtëm i thotë të Dërguarit të Vet: *“Mos u nxito! Duroji pak femohuesit! Duroni ti dhe muslimanët, sepse fundi i femohuesve dibet; ata janë të humbur në këtë botë e në Botën tjetër do të kenë një dënim të dhimbshëm, në xhehenem.”*

---

6) Është betim i All-llahut.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Fjala e All-llahut është e vërtetë dhe e çiltër.
2. Femohuesit gjithmonë u ngrenë kurthe muslimanëve.
3. All-llahu i Madhërishëm i mbron muslimanët dhe i asgjëson planet e armiqve të Islamit.
4. All-llahu i Madhërishëm u kërkon muslimanëve që të mos ua ngutin dënimin jobesimtarëve.
5. Është Urtësi e All-llahut vonimi i dënimit për femohuesit.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përgjigjuni me “saktë” ose “gabim” fjalive të mëposhtme.
  - a) Kur femohuesi bën një mëkat, All-llahu e dënon atë menjëherë.
  - b) Kur’ani e ndan të mirën nga e keqja.
2. Përmendni tri nga çështjet për të cilat flasin ajetet.
3. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalë nga sureja
  - a) Muslimani i largohet ..... në fjalët që thotë.

b) Femohuesit ..... për muslimanët.

## **SUREJA “E’LA “**

(E zbritur në Mekë, ka 19 ajete)

Ajetet 1 - 13

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Madhëroje Zotin tënd, më të Lartësuarin, 2. I Cili krijoi dhe përsosi, 3. I Cili paracaktoi dhe orientoi, 4. I Cili bëri të mundur që të mbijë kullota 5. E pastaj e bëri atë mbeturinë të zezë. 6. Ne do të të mësojmë ty ta lexosh<sup>7</sup> (Kur’anin) e ti nuk do ta harrosh, 7. Përveç asaj që All-llahu dëshiron. Ai e di të dukshmen dhe të fshehtë. 8. Ne do të të drejtojmë ty në të lehtë. 9. Ti këshillo aty, ku këshilla bën dobi. 10. Do të këshillohet ai që ka frikë 11. E do t’i shmanget asaj ai që është njeri i keq. 12. Ai do të hyjë në zjarrin e madh. 13. Aty as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë.

---

7) Shih shënimin numër 26.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për fuqinë e All-llahut të Madhërishtëm mbi krijesat, për Kur'anin e Shenjtë dhe për rëndësinë e këshillimit.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Kjo sure fillon me një kërkesë, që All-llahu i Madhërishtëm ua drejton të Dërguarit të Tij dhe të gjithë muslimanëve: ta përmendin All-llahun e Madhërishtëm dhe ta lartësojnë Atë; të mos i bëjnë shok All-llahut dhe të mos thonë se Ai ka fëmijë. All-llahu i Madhërishtëm është Një, nuk ka shok dhe as nuk ka të ngja-shëm. Është All-llahu më i Madhi, Ai që ka krijuar gjithçka, që ka paracaktuar gjithçka. All-llahu i Madhërishtëm i ka dhënë njeriut cilësi që ia lehtësojnë bashkëpunimin me të tjerët. All-llahu i Madhërishtëm u ka dhënë kafshëve cilësi që i bëjnë ato të dobi-shme për njeriun. Edhe Diellin, Hënë, ujin dhe ajrin All-llahu i Madhërishtëm i bëri të dobishëm për njeriun. Kështu, gjithësia ecën në rregullsi të madhe. All-llahu i Madhërishtëm krijoi gjith-ashtu bimët në lloje të shumta, në mënyrë që krijesat e Tij të përfitojnë nga ato, që njeriu e kafsha të hanë bimë të gjelbërta e të freskëta. Njerëzit dhe kafshët përfitojnë prej tyre edhe kur bimët thahen. E gjithë kjo është nga mëshira e All-llahut mbi krijesat e Tij. E gjithë kjo është Paracaktimi dhe Urtësia e All-llahut. Bimët, mbarja dhe tharja e tyre të kujtojnë jetën e kësaj bote. Ajo është si bimët; fillon dhe... mbaron. All-llahu i Madhë-rishëm i tregon Profetit të Tij se Ai do t'ia kumtojë atij Kur'anin nëpërmjet Xhebrailit të çiltër e Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut

qofshin mbi të) nuk do të harrojë gjë nga Kur'ani, me lejen e All-llahut. Por ka disa ajete që All-llahu i ka anuluar e që nuk konsiderohen pjesë të Kur'anit dhe Profeti (paqja dhe beki-mi i All-llahut qofshin mbi të) mund të mos i mbante mend.

All-llahu i Madhërishëm thotë se Ai di gjithçka. Ai di atë që njerëzit e fshehin dhe atë që njerëzit e nxjerrin në pah. Madje, All-llahu i Madhërishëm di edhe atë që u shkon nëpër mend njerëzve, di ngacmimet që vetja ia bën gjithkujt. Kështu, All-llahu i Madhërishëm i paralajmëron njerëzit.

All-llahu i Madhërishëm i drejtohet të Dërguarit të Tij: “Vërtet, All-llahu ka zgjedhur për ty një fe të lehtë, pa vështi-rësi.”

All-llahu i Madhërishëm është i kënaqur nga Profeti i Tij dhe nga Bashkësia (ummeti) Islame. Kjo fe është e lehtë për t'u ndjekur, prandaj All-llahu e urdhëroi Profetin e Tij që t'ua përcillte atë njerëzve, që t'ua kujtonte atyre madhështinë e kësaj feje dhe t'i nxiste ata të besonin All-llahun.

Ai njeri që e ka frikë All-llahun e Madhërishëm do të përfitojë nga Kur'ani. Tek ai do të duken frytet e kësaj frike me adhurim dhe bindje e ai do të ndihet i lumtur. Në të kundërt, njeriu, që e dëgjon Kur'anin por e lë atë pas dore dhe nuk përfiton prej tij, nuk do ta gjejë lumturinë as në këtë botë e as në Botën Tjetër. Në Botën tjetër All-llahu do ta fusë në zjarrin e xhehenemit. Aty nuk do të ketë më një jetë të këndshme; aty do të jetë mes jetës dhe vdekjes, e ky është dënimi më i madh.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm i ka urdhëruar muslimanët që ta madhërojnë e ta kujtojnë vazhdimisht Atë. Është kumtuar që, kur Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) i zbriti ajeti, *“Madhbëroje Zotin tënd, më të Lartësuarin,” ai tha: “Thua-jeni këtë ajet kur të bini në sexhde.”* (E kumton Ahmed i Daudi dhe Ebu Daudi)
2. All-llahu i Madhërishtëm e ka krijuar gjithësinë me tërë rregullsinë.
3. All-llahut të Madhërishtëm nuk mund t'i fshihet asgjë, asnjëherë.
4. Islami është fe e lehtësisë.
5. Ai që e dëgjon këshillën dhe përfiton prej saj, ka arritur lumturinë; kurse ai që nuk e pranon këshillën, ka humbur.
6. Ata që do të hyjnë në Zjarr do të jenë midis vdekjes dhe jetës.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Çfarë duhet të thotë muslimani kur bie në sexhde?
2. Ç'ajete të kujtohen kur shikon një elefant a deve?

3. Si do të jetë gjendja e atyre që do të jenë në zjarr?

## **AJETET 14 - 19**

14. Ka shpëtuar ai, që është pastruar, 15. Që e kujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet. 16. Por, ju po i jepni përparësi jetës së kësaj bote. 17. E dihet se jeta e Botës Tjetër është më e dobishme dhe e përjetshme. 18. Vërtet, kjo (këshillë) gjendej edhe në Fletët e para, 19. Në Fletët e Ibrahimit dhe të Musait.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Në këto ajete All-llahu i Madhërishëm tregon se i lumturi dhe i shpëtuari është ai që nuk bën mëkate, që e pastron veten e tij nga ato, që nuk është si disa të tjerë, të cilët e duan këtë botë më shumë se Botën Tjetër e punojnë për këtë botë më shumë se për Botën Tjetër. Muslimani i çiltër punon edhe për këtë botë edhe për Botën Tjetër, por ai i kushton më shumë vëmendje Botës Tjetër, sepse jeta në atë Botë është më e mirë se jeta në këtë botë. Në Botën e Përtejme jeta është e përhershme, ajo nuk ka fund, kurse jeta e kësaj bote nuk është gjithmonë e bukur dhe një ditë do të mbarojë. Vërtet, këto janë këshilla dhe porosi për të gjithë njerëzit. All-llahu i Madhërishëm

i ka përmendur këto këshilla në Kur'an, që i zbriti Muhammedit dhe në Fletët, që ua zbriti Ibrahimit dhe Musait.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Muslimani që i kushton vëmendje lumturisë në Botën Tjetër largohet nga mëkatet.
2. Janë vepra e veprime të muslimanëve të çiltër pastrimi i pasurisë, përmendja shpesh e All-llahut dhe falja e namazit rregullisht.
3. All-llahu i Madhërisëm i qorton ata, që e duan këtë botë më shumë se Botën Tjetër.
4. Mesazhet e Profetëve ftojnë njësoj në moralin e mirë.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Ajetet përmendin tri vepra të muslimanëve të çiltër. Cilat janë ato?
2. Sureja flet për tre Profetë. Thoni cilët janë ata, sipas kohës kur kanë jetuar?
3. Lidhni çdo fjalë të kolonës A me fjalën që i përshtatet në kolonën B.

B  
Profetët  
Kjo botë  
Musai

A  
Teurati  
Ibrahimi  
Bota tjetër

## SUREJA “EL GASHIJE”

(E zbritur në Mekë, ka 26 ajete)

Ajetet 1 - 16

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. A të erdhi ty lajmi për shkatërrimin (Gjithëpërfshirës)<sup>8)</sup> 2. Atë Ditë sheh fytyra të përlulura, 3. Të lodhura e të rraskapitura (nga mundimi). 4. Ata hyjnë në Zjarrin e ndezur fort. 5. U jepet të pijnë prej një burimi të valë. 6. Ata nuk kanë ushqim tjetër, përveç një barishteje me gjemba e me helm, 7. Që as nuk të jep fuqi dhe as nuk ta shuan urinë. 8. Atë Ditë sheh fytyra të ndritshme.

---

8) Shkatërrimi (Gjithëpërfshirës) - El Gashije.

9. Të kënaqura për veprat e veta. 10. Në xhenet të shkallës së lartë. 11. Aty nuk dëgjojnë fjalë të pakëndshme. 12. Aty ka burime që rrjedhin. 13. Aty ka shtretër të lartë, 14. Gota të vëna pranë, 15. Jastëkë të renduar për mbështetje 16. Dhe qilima të shtruar.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për fundin e keq të femohuesve, për fundin e lumtur të muslimanëve dhe për disa krijesa të All-llahut.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Kjo sure flet për Ditën e Gjykimit, e cila kaplon të gjithë njerëzit. All-llahu i Madhërishëm ia kujton të Dërguarit të Tij këtë lajm të madh, të cilin duhet ta dinë të gjithë njerëzit. Ai i tregon Profetit cilësitë e atyre që do të hyjnë në xhehenem dhe dënimin që u është përgatitur atyre. All-llahu tregon, gjithashtu, edhe për ata që do të futen në xhenet dhe për të mirat, që u janë përgatitur atyre. Pas Ditës së Ringjalljes dhe pas Gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe. Grupi i parë, janë ata që do të futen në Zjarr. Ata do të jenë kokulur. Në fytyrat e tyre do të duket pendimi, sepse ata punuan dhe u lodhën në këtë botë, por veprat e tyre shkuan kot e nuk u pranuan nga All-llahu i Madhërishëm. Ndoshta veprat e tyre qenë adhurim; ndoshta qenë vep-ra

të këqija dhe të shthurura. Omeri (All-llahu qoftë i kënaqur me të) pa një ditë një prift të krishterë, të lodhur aq shumë nga adhurimi, sa mezi mbahej. Omeri (All-llahu qoftë i kënaqur me të) qau dhe këndoi ajetin: *“Atë Ditë, sheh fytyra të përulura. Të lodhura e të rraskapitura (nga mundimi). Ata hyjnë në Zjarrin e ndezur fort.”* Në të vërtetë, prifti u lodh në një adhurim të cilin nuk e pranon All-llahu i Madhërishëm në Botën e Përtejme, sepse ai nuk e njohu All-llahun si Zotin e Vetëm. Ai nuk e adhu-roi All-llahun ashtu siç duhet dhe rezultati ishte lodhja në këtë botë dhe dënimi në Botën Tjetër.

Ata që do të hyjnë në xhehenem do të digjen në Zjarrin e tij shumë të fortë. Burimi, ku do të pinë ata, do të nxjerrë ujë të valuar. Ata do të hanë ushqim të keq; ai do të jetë një lloj dënimi për ta. Ai do t’ua çjerrë barqet.

Grupi i dytë janë ata që do të hyjnë në xhenet. Fytyrat e tyre do të jenë të çelura e të bukura. Në to do të shihen shenjat e gëzimit e të shpëtimit. Ata do të jenë të kënaqur dhe të gëzuar për veprat që kanë bërë në këtë botë, sepse falë atyre veprave ata u futën në xhenet. Xheneti, që All-llahu ka përgatitur për besimtarët, është i lartë, i bukur; në të nuk fliten fjalë të këqija. Atje do të dëgjohen vetëm fjalë të mira nga engjëjt që do t’i vizitojnë besimtarët.

Në xhenet ka burime me ujë të kulluar; ka shumë pije të shijshme, si vera<sup>9)</sup>, qumështi e të tjera që All-llahu i ka përgatitur për të devotshmit. Ata që do të hyjnë në xhenet do të mbështeten mbi jastëkë, mbi ndenjese të larta e të rehatshme. Atyre do t’u shtrohen qilima të bukur gjithandej. Ata do të kenë përpara vetes gota të mbushura me pije të shijshme. Të mirat e xhenetit janë të shumta

---

9) Vera e Xhenetit nuk është dehëse, si vera e kësaj bote.

dhe të mëdha. Mendja e njeriut nuk mund t'i përfytyrojë të mirat e xhenetit ashtu siç janë në të vërtetë. Kur Kur'ani flet për xhenetin, duke na thënë se aty do të ketë pije, ushqime e vende të rehatshme për t'u ulur, ai vetëm se dëshiron të na e përfaqësojë kuptimin, sepse, në të vërtetë, ato të mira që gjenden në xhenet nuk u ngjajnë të mirave që gjenden në këtë botë. Ngjashmëri e vetme janë vetëm emrat, që njerëzit ta kuptojnë Fjalën e All-llahut të Madhërishtëm.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Ajetet na tregojnë humbjen e madhe të femohuesve. Ata lodhen në këtë botë dhe dënohen në Botën Tjetër.
2. Ajetet flasin për çfarë ka përgatitur All-llahu për femohuesit në xhehenem.
3. Ajetet flasin për atë që ka përgatitur All-llahu për besimtarët në xhenet.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. All-llahu i Madhërishtëm ka përmendur dy cilësi të ushqimit që do të hanë femohuesit në Botën Tjetër. Cilat janë këto cilësi?
2. Ajetet flasin për disa të mira të xhenetit. Përmendni tri prej tyre.

3. “El Gashije” është një nga emrat e Ditës së Gjykimit. Thoni tre emra të tjerë të Ditës së Gjykimit, të cilat janë për-mendur në suren e mëparshme.

## **AJETET 17 - 26**

17. A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar, 18. Edhe qiellin se si është ngritur lart, 19. Edhe kodrat se si janë vendosur! 20. Edhe tokën se si është shtruar? 21. Ti këshillo; ti je vetëm një këshillues. 22. Ti nuk je zotërues i tyre, 23. Përveç atij që sprapsët e nuk beson. 24. All-llahu e dënon atë me vuajtje të mëdha. 25. Ata (njerëzit) vetëm të Ne kthimin e kanë. 26. Dhe detyra Jonë është gjykimi i tyre.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

All-llahu i Madhërishëm u thotë njerëzve që të shikojnë disa nga krijesat e Tij të mrekullueshme, të cilat tregojnë fuqinë e Tij. All-llahu i Madhërishëm u kërkon njerëzve të shikojnë deve-të dhe të meditojnë për krijimin e kësaj kafshe. Arabët, të cilë-ve u zbriti së pari Kur’ani, i përdornin shumë devetë. Vërtet, deveja është një kafshë e mrekullueshme, që e meriton të mendohet për krijimin e saj dhe për cilësitë e saj. Deveja është një nga kafshët që e duron shumë etjen. Në qoftë se deveja pi ujë të kripur, trupi i saj e kthen në ujë të ëmbël. Deveja është në gjendje të gjejë rrugët me anë

të yjeve. Deveja ka edhe shumë cilësi të tjera që e dallojnë nga kafshët e tjera. All-llahu i Madhërishtëm i fton njerëzit të shikojnë gjithashtu qiellin se si All-llahu e bëri atë të lartë, si e bëri atë të fortë e të qëndrueshëm dhe si e ka zbukuruar atë me yje. All-llahu i Madhërishtëm u kërkon njerëzve që të shikojnë malet e larta. All-llahu i Madhërishtëm i ka krijuar malet që të përforcojnë Tokën. Në male ka edhe plot dobi të tjera. All-llahu i Madhërishtëm u thotë njerëzve që të shikojnë tokën, ku ata jetojnë. All-llahu i Madhërishtëm e ka bërë të lehtë jetesën. Megjithatë ajo rrotullohet, njerëzit lëvizin të qetë e të sigurt, pa e ndjerë lëvizjen.

Shikimi i krijesave të All-llahut, të cilat njerëzit i kanë para syve çdo ditë, dhe mendimi për krijimin e tyre i shtyn ata ta besojnë All-llahun, Librin e Tij dhe të Dërguarin e Tij (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).

All-llahu i Madhërishtëm kërkoi nga i Dërguari i Tij (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që të ftonte të gjithë njerëzit në Islam, që t'u kujtonte atyre Gjykimin përpara All-llahut dhe përfundimin në xhenet ose në Zjarr. Ai që do ta ndjekë të Dërguarin dhe do të bëhet musliman, ai ka zjedhur rrugën e shpëtimit. Nuk detyrohet nga i Dërguari të bëhet musliman ai që ngul këmbë në mendimin e vet, sepse nuk ka dhunë në fe. I takon All-llahut t'i gjykojë ata.

All-llahu i Madhërishtëm i paralajmëron ata që nuk e pranojnë Islamin duke i thënë se do të kthehen tek All-llahu i Madhërishtëm, se All-llahu do t'u kërkojë llogari për mohimin e tyre dhe do t'i dënojë rëndë në zjarrin e xhehenemit.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Të mendosh për krijesat e All-llahut është adhurim. All-llahu i Madhërishtëm ka urdhëruar të mendojmë për krijesat e Tij dhe Ai do ta shpërblejë atë që e bën këtë.
2. All-llahu i Madhërishtëm e urdhëron Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që t'u kujtojë njerëzve frikën e All-llahut dhe Ditën e Gjykimit.
3. Islami nuk e detyron njeriun të bëhet musliman, por në të njëjtën kohë ai nuk e lejon njeriun që ta pengojë thirrjen në Islam a ta luftojë atë.
4. Njerëzit do të kthehen tek All-llahu i Madhërishtëm dhe në Ditën e Gjykimit All-llahu do t'u kërkojë atyre llogari për veprat e bëra.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Thoni disa cilësi që e dallojnë devenë nga kafshët e tjera.
2. Përse quhet deveja “anija e shkretëtirës”?
3. Çfarë ju tërheq vëmendjen kur shikoni qiellin sipër jush?

## SUREJA “EL FEXHR”

(E zbritur në Mekë, ka 30 ajete)

Ajetet 1 - 14

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për agimin! 2. Për dhjetë netët! 3. Për çiftin dhe për tekun! 4. Për natën që shkon! 5. A janë këto betime për të mençurin? 6. A nuk e di ti se ç'bëri Zoti yt me Ad-in? 7. Me banorët e Iremi me ndërtesa të larta, 8. Që si ata (populli Ad) nuk është krijuar askush në Tokë! 9. Dhe me Themudin, të cilët shpuan shkëmbinj në luginë. 10. Dhe me Faraonin e fortifikuar me tenda (ushtarake), 11. Të cilët e tepruan me krime në tokë 12. Dhe në të shtuan shkatërrimin. 13. E All-llahu kundër tyre lëshoi lloj-lloj dënimesh. 14. Se Zoti yt është që përcjell (u rri në pritë).

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për disa popuj femohues dhe për dënimin që iu dha atyre. Sureja flet edhe për natyrën e njeriut, për Botën Tjetër dhe për çfarë do të ndodhë në të.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Fillimi i sures tregon për disa popuj që kanë jetuar përpara Islamit. All-llahu i Madhërishëm, me fuqinë e Tij, betohet në agimin, për ato orë të qeta e të bukura që janë fillimi i ditës.

All-llahu i Madhërishëm betohet në dhjetë ditë të bekuara, që mund të jenë dhjetë ditët e muajit Dhul Hixhxe, kur kryhet shtylla e pestë e Islamit, haxhi. Të tilla janë edhe dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit, ndër të cilat është një natë më e mirë se një mijë muaj. Nata e Kadrit. All-llahu betohet, gjitha-shtu në ditën e kurbaneve, që është dita e dhjetë e muajit Dhul Hixhxe. All-llahu betohet për ditën teke, që është dita e nëntë e muajit Dhul Hixhxe, Dita e Arafatit. All-llahu i Madhërishëm betohet për natën kur ajo shkon. Në këtë betim gjejmë një shenjë të mrekullueshme; Lindjen dhe Perëndimin. Betimi i All-llahut në Lindjen dhe Perëndimin, në këtë mrekulli, është i mjaftueshëm për të bindur një njeri me mendje të shëndoshë se All-llahu i Madhërishëm mund t'i asgjësojë kufrin dhe të këqinj të kur të dojë, sado të fortë të jenë ata.

All-llahu i Madhërishëm na tregon se si ka asgjësuar popullin e Adit. Ai qe popull i fortë e i qytetëruar. Jetonte në qytete të mëdha, me ndërtesa të larta, që nuk gjendeshin në vende të tjera. Por, kur populli i Ad-it e përgënjeshtroi të Dërguarin e All-llahut, Hudin, All-llahu i Madhërishëm e shkatërroi atë. Atyr nuk u bëri dobi forca dhe qytetërimi.

All-llahu i Madhërishëm shkatërroi edhe popullin e Themudit. Edhe ai ishte i fortë. Ata kishin bërë shtëpi në shkëmbinj. Megjithatë All-llahu i shkatërroi ata, kur përgënjeshtroan Profetin e All-llahut, Salihun. All-llahu i Madhërishëm e mbyti Faraonin dhe ushtrinë e tij, i mbyti ata që kishin

piramidat, që ngjanin si shtylla të stërmëdha në tokë, sikur të ishin male. All-llahu i asgjësoi ata, sepse përgënjeshtroan Profetin e All-llahut, Musa-në.

Të gjithë popujt që përmendëm i kishin kaluar caqet dhe u kishte pëlqyer së tepërmi fuqia e vet. Kështu ata filluan të përhapnin të keqen mbi tokë, luftuan të Dërguarit e All-llahut e bënë vepra të liga. All-llahu i Madhërishtëm zbriti dënimin mbi ata popuj, sepse Ai mbikëqyr me kujdes veprat e njerëzve dhe i regjistron ato. Ai dënon ata që kanë bërë vepra të liga, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër.

Në këto ajete shohim se All-llahu i paralajmëron femohuesit kurejshë që të kenë frikë se Ai do t'i asgjësonte ata, në qoftë se ata do të vazhdonin me mohimin e tyre, sepse All-llahu i Madhërishtëm kishte asgjësuar edhe më parë popuj më të fortë se ata.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. All-llahu i Madhërishtëm i ka pëlqyer disa ditë e net më shumë se disa të tjera.
2. All-llahu i Madhërishtëm ka asgjësuar shumë njerëz, sepse ata përgënjeshtroan të Dërguarit dhe përhapnin të keqen mbi tokë.
3. All-llahu i Madhërishtëm i mbikëqyr femohuesit dhe i shënon veprat e tyre, që më pas t'i dënojë ata rëndë.
4. Fuqia e njerëzve nuk është asgjë në krahasim me fuqinë e All-llahut të Madhërishtëm.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Plotësoni vendet bosh.

a) All-llahu i Madhërisëm dërgoi Profetin \_\_\_\_\_ te populli i Ad-it , dërgoi Salihun te \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ te Faraoni.

2. Përmend një muaj që pëlqehet më shumë se të tjerët dhe një natë që pëlqehet më shumë se të tjerat.

3. Përpiquni të gjeni se ku jetonin tre popujt që përmenden në ajete.

## AJETET 15 - 30

15. E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, kur e nderon dhe e begaton, thotë: “Zoti im më ka nderuar.”

16. Por, kur, për ta sprovuar, ia pakëson riskun, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar!” 17. Jo, nuk

është ashtu! Por ju nuk pëfillnit bonjakun, 18. Nuk e nxisni njëri-tjetrin për ta ushqyer të varfrin.

19. Dhe ju e hani trashëgimin (me të padrejtë) 20. Dhe pasurinë e doni së tepërmi. 21. Jo, mos

ashtu! Kur të dridhet toka me dridhje të njëpasnjëshme 22. Dhe kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt

qëndrojnë radhë-radhë 23. Dhe atë ditë sillet xhehenemi e atëherë njeriut i bie ndërmend, por sa

do t'i hyjë në punë kjo atij? 24. E thotë: “Ah, i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën

time!” 25. Atë Ditë, askush nuk mund të dënojë si Ai. 26. Dhe lidhjet (vargojt) e Tij janë të tilla

si të askujt tjetër. 27. (Shpirtit të mirë do t'i thuhet:) O (ti) shpirt në qetësi e në kënaqësi të plotë!  
28. Kthehu te Zoti yt, i kënaqur për vete, i kënaqur edhe Zoti me ty!  
29. Hyr në mes të robve të Mi.  
30. Hyr në xhenetin Tim.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Në qoftë se njeriu nuk e beson All-llahun e nuk kënaqet me gjykimin dhe përcaktimin e Tij, atëherë prej tij vijnë sjellje të këqija. Këto sjellje tregojnë paditurinë e tij dhe besimin e kotë të tij. Ky njeri i paditur, kur All-llahu i Madhërishëm i fal pasuri dhe ia bën jetën të lumtur, thotë: *“All-llahu më do dhe më nde-ron mua, e unë e meritoj këtë.”* Por, kur All-llahu do ta vërë në provë besimin e këtij njeriu e të shohë durimin e tij, duke mos i dhënë gjithçka që dëshiron, ai zemërohet me Zotin e tij dhe thotë: *“All-llahu më urren dhe më ul mua, e nuk më jep atë që meritoj.”* All-llahu e qorton njeriun për mendimin e keq e për keqkuptimin e tij. All-llahu u thotë këtyre njerëzve: *Nuk është ashtu siç mendoni dhe besoni ju. Jeni ju ata që nuk e shpenzoni si duhet pasurinë dhe nuk jepni prej saj për të bërë punë të mira. Ju nuk i jepni jetimit dhe nuk e ndihmoni atë, e ky është veprim i keq. Ju nuk e ndihmoni dhe nuk e nxisni njëri-tjetrin për të ushqyer nevojtarin e varfër. Megjithëkëtë, ju o njerëz shkëlmi të drejtat e të tjerëve, u merrni pasuritë të pafuqishmëve e lakmia për pasurinë ju bën ta siguronin atë në rrugë të papërligjura. Njeriu i bën veprat e këqija dhe e harron përfundimin, e harron vendin që e pret në Ditën e Gjykimit.*

Kur të vijë ora e Kijametit, All-llahu i Madhërishtëm do të bëjë të lëkundet Toka e ç'ka në të. Gjithçka mbi Tokë do të ndryshojë. Do të vijë All-llahu, ashtu siç i shkon Madhështisë së Tij, që të gjykojë robërit e Tij. Vijnë edhe engjëjt të rreshtuar dhe afrohet xhehenemi për ta parë ata që do të hyjnë në të. Kur të ndodhin të gjitha këto, njeriu do të bindet se ka qënë i gabuar në këtë botë që nuk e ka besuar Ditën e Gjykimit dhe nuk ka bërë vepra të mira. Por pranimiti i mëkateve nuk do t'u bëjë dobi të tillë njerëzve, ashtu siç nuk do t'u bëjë dobi edhe pendimi për ato që kanë bërë, sepse Dita e Gjykimit është vetëm për t'i dënuar ose për t'i shpërblyer, jo për të punuar.

Ditën e Gjykimit, All-llahu i Madhërishtëm i dënon ata që do të hyjnë në Zjarr - femohuesit dhe mëkatarët - me një dënim të pashembullt. Askush nuk mund t'i shpëtojë dënimit të All-llahut.

Pasi ka folur për shpirtin e keq, All-llahu i Madhërishtëm flet edhe për shpirtin e besimtarit. Shpirti i besimtarit do të kthehet te Zoti i vet, i sigurt dhe i qetë, sepse ai e besoi All-llahun e Madhërishtëm dhe iu bind Atij. All-llahu i Madhërishtëm është i kënaqur prej këtij shpirti, e Ai do ta bëjë edhe këtë shpirt të jetë i kënaqur nga të mirat që All-llahu ka përgatitur për të në Botën Tjetër. All-llahu do ta fusë atë me robtë e Tij të mirë në kop-shte të paparë.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Është cilësi e jobesimtarëve të mos e falënderojnë All-llahun.
2. Të jemi të butë me jetimin, ta ushqejmë dhe ta ndihmojmë të varfrin.

3. Ditën e Gjykimit mëkatari do të pendohet që nuk e ka adhuruar siç duhet All-llahun, por pendimi nuk do t'i bëjë dobi.
4. Ditën e Gjykimit do të afrohet xhehenemi, për të qenë më pranë atyre që do të hyjnë në të.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Thoni tri cilësi të këqija të jobesimtarëve, të cilat përmenden në sure.
2. Ç'thotë jobesimtari kur i pakësohet pasuria?
3. Si do të qëndrojnë engjëjt në Ditën e Gjykimit?
4. Ç'do të thotë: “Nuk e nxisni njëri-tjetrin për të ushqyer të varfrin.”?
5. Si do të kthehet shpirti besimtar te Zoti i vet?
6. Ç'thotë Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) për afrimin e Zjarrit në Ditën e Gjykimit?

## SUREJA “EL BELED “

(E zbritur në Mekë, ka 10 ajete)

Ajetet 1 - 10

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Beto hem për këtë qytet! 2. E ti gjendesh në këtë qytet. 3. Beto hem në prindin dhe në atë që lind prej tij. 4. Vërtet, Ne e krijuam njeriun në vështirësi të njëpasnjëshme.<sup>10</sup> 5. A mendon ai (njeriu) se atë nuk do ta mposhtë askush, 6. Kur thotë: “Unë kam shpenzuar shumë pasuri”? 7. A mendon ai se nuk e ka parë askush? 8. A nuk i dhamë Ne atij dy sy, 9. Edhe gjuhë e dy buzë, 10. Dhe ia kemi treguar atij të dyja rrugët?<sup>11</sup>

---

10) Njeriu ka lindur për t'u përpjekur dhe për t'u munduar, dhe nëse has vështirësi, ai duhet të tregohet durimtar, sepse All-llahu do t'ia bëjë rrugën të butë.

11) Dy rrugët e jetës janë: rruga e thikët dhe e vështirë e së vërtetës dhe rruga e lehtë e vesit dhe e mohimit të All-llahut. All-llahu na ka dhënë jo vetëm shqisat, por edhe gjykimin për ta zgjedhur rrugën tonë; Ai na ka dërguar Mësues me Shpallje, për të na e treguar rrugën e drejtë dhe të vështirë.

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për rëndësinë e betimit për besimtarët, për jobesimtarët dhe për fundin e secilit prej tyre. Ajo flet për Ditën e Kijametit dhe për çfarë do të ndodhë atë Ditë.

## KUPTIMI I FJALËVE

Në këtë qytet - Në Mekën e Nderuar.

Ti gjendesh në këtë qytet - Ti je banor i lirë e me të drejta të plota i Mekës.

Të dyja rrugët - Rruga e vështirë të besimit dhe të durimit, për të cilën flitet më poshtë, dhe rruga e lehtë të mëkatit e të përgënjeshtimit, për të cilën është folur në ajetet e mësipër-me.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Njeriu i kupton gabim shumë gjëra, prandaj më të shumtën e rasteve nuk i vlerëson ato siç duhet. All-llahu i Madhërisëm i thotë këtij njeriu: *“Jo! Çështja nuk është ashtu si e mendon ti, por siç e thotë All-llahu i Madhërisëm.”* All-llahu i Madhërisëm betohet për Mekën e Nderuar. Meka është vendi më i shenjtë mbi Tokë. Mirësia dhe pozita e saj u shtua nga prania e të Dërguarit të All-llahut.

All-llahu i Madhërishtëm betohet në prindin dhe në atë që lind prej tij. Ky është vlerësim nga All-llahu për procesin e riprodhimit, të shumimit të njerëzve.

All-llahu i Madhërishtëm betohet për çfarë sheh vetë njeriu. Betohet për lodhjen dhe për vështirësitë me të cilat njeriu përballlet çdo ditë, se njeriu nuk i vlerëson siç duhet gjërat.

Jobsimtari jeton në këtë botë sikur të ishte ai zot i vetvetes; ai kujton se askush nuk mund t'i dalë përsipër; kujton se është i lirë të bëjë gjithçka do, kujton se All-llahu nuk e mbikëqyr atë. All-llahu i Madhërishtëm i tregon njeriut se veprimet që bën janë të papranueshme. All-llahu i Madhërishtëm e ka krijuar njeriun. Ai i falë atij dy sytë, që të shohë; i falë gjuhën e buzët, që të shprehë i sigurtë atë që ka në veten e vet. All-llahu i Madhërishtëm i ka treguar njeriut rrugën e drejtë dhe e ka urdhëruar që të ecë në këtë rrugë; All-llahu i ka treguar njeriut edhe rrugën e shtrembër dhe e ka urdhëruar t'i largohet asaj, në mënyrë që morali i tij dhe gjendja e tij (materiale dhe shpirtë-rore) të jenë ashtu siç e kërkon Islami.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Jeta e kësaj bote është e mbushur me mundim e vështi-rësi.
2. I padituri beson se është i lirë të bëjë ç'të dojë.
3. All-llahu i Madhërishtëm i ka dhënë njeriut shumë mirësi, e prej më të mirave janë shqisat.

4. All-llahu i Madhërishtëm ua ka bërë të qartë njerëzve rrugën e drejtë dhe rrugën e shtrembër, që ata të zgjedhin nga do të ecin.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Ç’kuptim kanë fjalët e mëposhtme:

Në këtë qytet;

Ti gjendesh në këtë qytet.

2. Plotësojini fjalitë e mëposhtme me fjalë nga sureja:

All-llahu i Madhërishtëm i ka dhënë njeriut ....., që të shikojë dhe i dha gjuhën, që të .....

3. Ç’do të thotë: “Dhe ia sqaruam atij të dyja rrugët.”?

## **AJETET 11 - 20**

11. E ai që iu ngjit së përpjetës së thikët (Akabesë) 12. E ç’të mësoi ty se ç’është e përpjeta e thikët? 13. Është lirimi i një skllavi 14. Ose dhënia e ushqimit kur sundon uria 15. (Kur i jep)

Ndonjë jetimi të afërm, 16. Ose ndonjë të varfri që e ka molisur varfëria, 17. Që pastaj të bëhet prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe për mëshirë, 18. Të tillë janë Shokët e Anës së Djathtë. 19. Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona, janë të Anës së Majtë. 20. Mbi ta do të jetë Zjarri si një rreth i mbyllur.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

E përpjeta e thikët - Rruga e drejtë e shpëtimit, që është gjithmonë e vështirë.

Shokët e anës së djathtë - Ata që do të hyjnë në xhenet.

Ata të anës së majtë - Ata që do të hyjnë në xhehenem.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE**

Pasi ka sqaruar në ajetet e mëparshme disa sjellje e veprime të këqija të njeriut, All-llahu i Madhërishëm flet tani për vepra të mira që e shpëtojnë njeriun nga Zjarri dhe e bëjnë të fitojë xhenetin. Veprat e mira e ndihmojnë besimtarin. Ato janë faktorë që ai ta marrë librin e veprave të veta me të djathtën dhe që të jetë prej atyre që futen në xhenet. Kurse, ai që e mohon All-llahun e që nuk bën vepra të mira, do të marrë librin e veprave të veta me dorën e majtë dhe do të

jetë prej atyre që do të futen në Zjarr. All-llahu do t'ua mbyllë atyre dyert e xhehenemit e ata nuk do të mund të dalin më kurrë prej tij. Vepra të mira janë:

1. Të japësh lëmoshë; të paguash për të liruuar robërit.
2. Të ushqesh e të ndihmosh nevojtarin, sidomos në rastet më të ngutshme, si p.sh., në kohë urie, në kohë lufte, në kohë tërmeti e përmytjesh etj.

Të ndihmosh të dobët është një vepër shumë e mirë, sidomos kur bëhet fjalë për jetimin, që është edhe nevojtar dhe i afërm. Në këtë rast ndihma konsiderohet edhe lëmoshë edhe shikim i të afërmeve.

3. Veprat e mira janë të vështira për t'i kryer; ato kërkojnë durim dhe bashkëpunim. Prandaj ta nxisim njëri-tjetrin për të duruar. Muslimanët duhet ta këshillojnë njëri-tjetrin që të jenë të mëshirshëm me nevojtarët dhe t'i ndihmojnë ata.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Muslimanin e shpëtojnë nga Zjarri besimi dhe veprat e mira.
2. All-llahu i Madhërisëm urdhëron të ndihmohet nevojtari.
3. Islami poroset që të ndihmohet jetimi e të tregohet dashuri e dhembshuri ndaj tij. Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) thotë: *“Unë dhe kujdestari i jetimit jemi në xhenet si këta të dy*

*(dhe tregoi të bashkuar dy gishta: gishtin tregues dhe atë të mesit).” Pra, ai që kujdeset për jetimin, do të jetë bashkë me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) në xhenet.*

4. Besimtari do ta marrë librin e veprave të veta me dorën e djathtë.

5. Jobesimtari do ta marrë librin e vet me dorën e majtë dhe do të hyjë në xhehenem, të cilit më pas do t’i mbyllen dyert.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Thoni nga ajetet dy nga cilësitë e atyre që do të hyjnë në xhenet.

2. Zëvendësoni tri nga fjalët e fjalisë së mëposhtme me fja-lët në kllapa, pa e prishur rendin e fjalisë:

Muslimani beson se, kur ushqen të varfrin, e kënaq All-llahun.

(Besimtari)                      (është i sigurtë)                      (jetimin)

3. Në Ditën e Gjykimit All-llahu i Madhërishëm i ndan njerëzit në dy grupe. Cilët janë këto grupe?

4. Tregoni një ngjarje, që e keni dëgjuar ose që ju ka ndodhur, ku të flitet për ndihmën që u është dhënë nevojtarëve.

5. Thoni dy çështje që i përfitojmë nga ajetet.

## SUREJA “ESH SHEMS”

(E zbritur në Mekë, ka 15 ajete)

Ajetet 1 - 10

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për Diellin<sup>12</sup> dhe dritën e tij! 2. Për Hënë, që vjen pas tij (Diellit)! 3. Për ditën, që e zbulon atë (Diellin)! 4. Për natën, që e mbulon atë (Diellin)! 5. Për qiellin dhe ndërtimin e tij (të mrekullueshëm)<sup>13</sup>! 6. Për Tokën dhe shtrirjen e saj të gjerë! 7. Për Shpirtin dhe përmasat e rregullsinë që i dha atij<sup>14</sup> 8. Dhe ia mësoi ç’është e mira dhe ç’është e keqja, 9. Ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten 10. Dhe ka dështuar ai, që e poshtëroi atë (Shpirtin)<sup>15</sup>.

---

12) All-llahu i Madhëruar betohet në Diellin.

13) Kuptimi i ajetit mund të jetë edhe: "Për qiellin dhe Atë që e ndërtoi."

14) All-llahu e bën Shpirtin dhe i jep atij përmasat, rregullsinë dhe përsosurinë relative, në mënyrë që t'u përshtatet rrethanave të veçanta të kësaj jete.

15) Ky është thelbi i sures. Shihni tregimin për Themudët në ajetet që pasojnë.

## KUPTIMI I FJALËVE

Ia mësoi se ç'është e mira dhe ç'është e keqja - Ia mësoi njeriut se cila ishte rruga e drejtë dhe cila ishte rruga e shtrem-bër.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Në këtë sure All-llahu i Madhërishtëm betohet në disa nga krijesat e tij të mrekullueshme. Ai betohet në Diellin dhe në dritën e tij, betohet në ditën kur toka bëhet e dukshme nën dritën e Diellit. All-llahu betohet në Hënën, që duket kur perëndon dielli, betohet në natën, e cila mbulon tokën e ç'ka mbi tokë. All-llahu i Madhërishtëm betohet në qiellin dhe Atë që e ka krijuar qiellin. All-llahu betohet në Vetën e Vet. All-llahu betohet në Tokën, të cilën e bëri me shtrirje të gjerë për të lehtësuar jete-sën në të. All-llahu betohet gjithashtu në njeriun, të cilin Ai e krijoi aq bukur dhe ia bëri të qartë rrugën e mirë dhe rrugën e keqe.

All-llahu i Madhërishtëm është betuar në tërë këto mrekulli, që tregojnë fuqinë e Tij të madhe, për një çështje shumë të rëndësishme: t'i tregojë njeriut se ai, i cili e pastron veten nga shirku dhe nga mëkatet do të shpëtojë dhe do të hyjë në xhenet, kurse ai, i cili e humb veten e tij me kufër dhe e prish veten me mëkate, do të futet në xhehenem. E, ai që do të futet në xhehenem, le të qortojë vetëm veten e vet, sepse All-llahu i Madhërishtëm ia bëri të qartë rrugën e drejtë dhe e porositi që të ecë sipas saj. All-llahu i Madhërishtëm ia bëri të qartë njeriut edhe rrugën e shtrembër dhe e

porositi që t'i qëndrojë larg asaj. All-llahu i Madhërishtëm thotë: *“Dhe ia mësoi se ç’është e mira dhe ç’është e keqja.”*

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. Gjithësia dhe krijesat e mrekullueshme që janë në të tregojnë fuqinë e All-llahut të Madhërishtëm.
2. All-llahu i Madhërishtëm e ka krijuar njeriun në trajtën më të bukur dhe i ka treguar atij rrugën e drejtë dhe rrugën e shtre-mbër.
3. Njeriu që e ruan veten dhe u largohet mëkateve, do të shpëtojë duke u futur në xhenet.
4. Kur Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) këndonte ajetin “Për shpirtin dhe përmasat e rregullsinë që i dha atij”, thoshte: “O All-llahu im! Jepu shpirttrave tanë për-kushtim e pastroji ata! Ti je Ai që i pastron shpirttrat më mirë se kushdo.” (Muslimi)

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Tregoni një ajet nga sureja, në të cilin All-llahu tregon se ia ka bërë njeriut të qartë rrugën e drejtë dhe rrugën e shtrem-bër.

2. Përmendni tri krijesa në të cilat All-llahu i Madhërishtëm betohet në këtë sure.
3. Çdo fjalie të kolonës A i vini përballë fjalinë që i për-shtatet në kolonën B.

A

Kur perëndon Dielli

Kur vjen drita

Në qoftë se njeriu u largohet mëkateve

B

Toka dhe ç'ka në të bëhet e dukshme

Hyn në xhenet

Del Hëna

## AJETET 11 - 15

11. Themudët përgënjeshtuan për shkak të arrogancës së vet, 12. Kur më i keqi i tyre u ngrit me të shpejtë.<sup>16</sup> 13 E, i Dërguari i tyre u pati thënë: “Kijeni kujdes devenë e All-llahut dhe mos e pengoni atë të pijë ujë.” 14. Ata nuk i besuan atij dhe e therën atë (devenë) e Zoti i tyre ua rreshtoi ndëshkimet dhe i rrafshoi. 15. E Ai (All-llahu) nuk u trembet pasojave të atij (ndëshkimi).

---

16) Për të vrrarë devenë.

## KUPTIMI I FJALËVE

Themudët - Një fis, që sipas historianëve thuhet se e kishte prejardhjen nga bregu lindor i lumit Euftrat.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Kur All-llahu i Madhërishtëm tregon në fillimin e kësaj sureje se ai që bën mëkat shkatërron vetveten, flet për Themudët, të cilët e shkatërruan veten e tyre duke mohuar All-llahun dhe duke bërë mëkate. All-llahu i Madhërishtëm dërgoi Profetin Salih (paqja qoftë mbi të) te Themudët, që t'i ftonte të besonin në All-llahun, por ata e përgënjeshtroan Profetin e dërguar nga All-llahu. Atëherë, All-llahu i Madhërishtëm, me fuqinë e Tij, nxori nga një gur një deve, e cila pinte sasi shumë të mëdha uji. Deveja ishte argument që tregonte se Salihu ishte i Dërguar nga All-llahu. Salihu i kishte paralajmëruar Themudët, që të mos e ngacmonin devenë dhe të mos e pengonin të pinte ujë; por ata kishin rënë në një mendje që ta përgënjeshtrojnë Salihun dhe ta vrisnin devenë. Kështu njëri prej tyre, më i keqi, u çua dhe e theri devenë. Atëherë, All-llahu i Madhërishtëm bëri që t'i zërë toka nën vete, duke i shkatërruar ata të gjithë. All-llahu i Madhërishtëm bën gjithçka që do. Askush nuk mund t'i kërkojë llogari All-llahut për asgjë.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu nuk e dënon një popull pa i dërguar më parë të Dërguar që t'i ftojë ata në rrugë të drejtë dhe t'i paralajmërojë ata për dënimin që i pret, nëse nuk kthehen nga rruga e shtrem-bër.
2. Ajetet tregojnë gjithëfuqishmërinë e All-llahut. Ai nxori nga guri një deve të gjallë.
3. All-llahu i Madhërishëm e ndihmon të Dërguarin e Vet dhe i shkatërron ata që e mohojnë dhe që e përgënjeshtrojnë.
4. All-llahu i Madhërishëm bën çfarë të dojë dhe askush nga krijesat e tij nuk mund ta pyesë për ato që bën.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Si quhet Profeti që dërgoi All-llahu te Themudët?
2. Flisni me fjalët tuaja për devenë e Salihut dhe për çfarë i ndodhi asaj.
3. Përse bëri All-llahu që prej guri të dilte një deve?
4. Flisni për dy çështje që i mësojmë nga ajetet.

## **SUREJA “EL LEJL”**

(E zbritur në Mekë, ka 21 ajete)

Ajetet 1 - 11

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për natën, që me errësi të mbulon Gjithësinë! 2. Për ditën, kur ajo ndrin! 3. Për Atë që krijoi mashkullin dhe femrën! 4. Vërtet, (qëllimet) për të cilat ju përpiqeni janë të shumëllojshme. 5. E, përsa i përket atij që jep (lëmshë) dhe që ruhet (nga mëkati) 6. Dhe me tërë çiltërinë dëshmon

më të mirën. 7. Ne do ta përgatisim atë për më të lehtë. 8. Përsa i përket atij që bën koprraci dhe e ndien veten të pavarur (nga Zoti), 9. Dhe që përgënjeshton atë më të mirën, 10. Ne do ta përgatisim atë për më të vështirën. 11. E pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të bjerë (në Gropë).

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për jetën e njeriut në këtë botë dhe për fundin e saj. Njeriu do të shkojë ose në xhenet ose në Zjarr.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Për më të lehtë - Për rrugën e drejtë dhe për të marrë sevape.

Për më të vështirën - Për ta mundur e për ta vënë në vështirësi.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

All-llahu i Madhërishtëm është i Plotfuqishëm për të krijuar gjithçka që do Ai. All-llahu i Madhërishtëm tregon disa nga krijesat e tij të mrekullueshme dhe betohet në to. All-llahu i Madhërishtëm betohet për natën, kur ajo mbulon Tokën me errësirën e saj. All-llahu i Madhërishtëm betohet edhe në ditën, që vjen pas natës, e bën të duket Toka dhe ç'ka në të. All-llahu betohet, gjithashtu në mashkullin dhe në femrën e çdo krijese. Krijesat ndryshojnë nga njëra-tjetra, si nga cilësitë ashtu edhe nga roli që kanë.

All-llahu e krijoi ditën që njerëzit të punojnë dhe krijoi natën, që njerëzit të flenë. All-llahu i Madhërishtëm krijoi mashkullin, që të bëjë punë që i përshtaten atij, krijoi edhe femrën dhe i dha detyrat dhe punët që i përshtaten asaj. Këtë shpërndarje detyrash e punësh mund ta vemë re si te njerëzit, ashtu edhe te krijesat të tjera. Kështu jeta ecën me rregullsi, ashtu siç do All-llahu i Madhërishtëm. All-llahu i Madhërishtëm betohet se ashtu siç janë veprat e njerëzve të ndryshme, ashtu edhe kërkesa e llogarisë do të jetë e ndryshme. All-llahu do ta ndihmojë në këtë botë, do t'ia lehtësojë rrugën e drejtë e do ta fusë në xhenet atë, që beson dhe bën vepra të mira, që e jep pasurinë për hir të All-llahut. Kurse ai që e mohon All-llahun, që nuk bën vepra të mira, që nuk i ndihmon të tjerët me pasurinë e vet dhe që tregohet mendjemadh mbi të tjerët, do të ketë një jetë të vështirë dhe pasuria e mbledhur nuk do t'i bëjë dobi kur të flaket në Zjarrin e xhehenemit.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Ajetet tregojnë fuqinë e All-llahut të Madhërishtëm. Ai ka krijuar krijesa nga më të ndryshmet.
2. All-llahu i Madhërishtëm i ka mëshiruar robërit e tij, duke e bërë natën kohë qetësie dhe ditën kohë pune dhe lëvizjeje.
3. Veprat e njerëzve janë të ndryshme; dikush bën vepra të mira e dikush bën vepra të këqija.
4. Të gjithë ata që e besojnë All-llahun dhe bëjnë vepra të mira do të hyjnë në xhenet.
5. Të gjithë ata që e mohojnë All-llahun dhe bëjnë vepra të këqija do të hyjnë në xhehenem.
6. Në Ditën e Gjykimit femohuesit nuk do t'i bëjë dobi pasuria që ka grumbulluar.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Gjej të kundërtën për secilën nga fjalët e mëposhtme:
  - a) Jep lëmoshë - .....
  - b) Femër - .....
2. I vini fjalët e mëposhtme në vendet e duhura: gënje-shtra, bujaria, nata.
  - a) Koprancia është e kundërta e .....

b) Çiltëria është e kundërta e.....

c) Dita është e kundërta e .....

3. Bëni një pasqyrë me dy kolona. Në të parën shkruani tri cilësitë e atyre që do të hyjnë në xhenet dhe përbri secilës, tri cilësi të atyre që do të hyjnë në xhehenem.

4. All-llahu i Madhërishtëm e ka bërë të qartë se pasuria nuk do t'u bëjë dobi atyre që do të hyjnë në xhehenem. Thoni ajetin që flet për këtë.

## AJETET 12- 21

12. Detyra jonë është vetëm të udhëzojmë. 13. Vetëm Tonat janë Bota tjetër dhe kjo botë. 14. Unë ju kam paralaj-mëruar për Zjarrin e ndezur fort, 15. Në të cilin nuk hyn tjetër veçse ai më i shtururi, 16. Që përgënjeshtrohet të Vërtetën dhe i kthen shpinën asaj, 17. Ndërsa më i devotshmi (ndaj All-llahut) do të jetë larg tij. 18. Ai që jep pasurinë e vet për të pastruar veten,<sup>17</sup> 19. Jo për t'u shpërblyer nga dikush që i ka bërë mirë më parë, 20. Por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të Lartit. 21. Dhe së shpejti ai do ta mbërrijë atë kënaqësi (të plotë).

---

17) Një ndër rrugët për të pastruar veten është të japësh Zeqatin.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Si mirësi mbi robërit e Tij, All-llahu i Madhërishëm u tregoi atyre rrugën e drejtë. All-llahu i Madhërishëm dërgoi Muhammedin si Profet për të gjithë njerëzimin. All-llahu i zbriti atij Kur'anin, që njerëzit të udhëzohen për në rrugën e drejtë dhe t'i largohen errësirës e t'i afrohen dritës.

All-llahu i Madhërishëm do t'u kërkojë llogari njerëzve në Ditën e Gjykimit dhe kjo është e lehtë për All-llahun, sepse është Ai që gjykon, sepse në dorën e Tij është kjo botë dhe Bota Tjetër.

All-llahu i Madhërishëm i ka paralajmëruar femohuesit për zjarrin e fortë të xhehenemit e, megjithatë, ata e mohojnë All-llahun. Të devotshmit, ata që e japin pasurinë e tyre për hir të All-llahut dhe nuk e presin shpërblimin nga askush tjetër përveç Tij, do të jenë larg Zjarrit dhe do t'i shpëtojnë nxehtësisë së tij.

Këto ajete zbritën për të lavdëruar Ebu Bekr Es Siddikun, sepse ai jepte shumë nga pasuria e tij për hir të All-llahut. Ebu Bekr Es Siddiku e bleu Bilal ibn Rebahun, kur ai ishte skllav, dhe më pas e la atë të lirë. Ebu Bekr Es Siddiku bëri tërë ato vepra për hir të All-llahut. E, All-llahu i Madhërishëm do t'i kënaqë Ebu Bekr Es Siddikun e të gjithë ata si ai duke i bërë të lumtur në xhenet, ashtu siç u kishte premtuar.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm ua ka bërë të qartë njerëzve rrugën e drejtë.
2. All-llahu i Madhërishtëm ka në dorë këtë botë e Botën Tjetër, si dhe ç'ka në to.
3. Besimtari është i çiltër jo vetëm në fjalët e tij, por edhe në veprat e tij dhe e pret shpërblimin vetëm nga All-llahu.
4. All-llahu i Madhërishtëm i bën robërit e Tij të mirë të kënaqen me të mirat e mëdha që Ai u ka përgatitur në xhenet.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Vendosni shenjën (✓) për mendimin e drejtë dhe (✗) për mendimin e gabuar në fjalitë e mëposhtme.
  - a) All-llahu i Madhërishtëm do ta bëjë dorështrenguarin të kënaqet në Botën Tjetër.
  - b) Besimtari i çiltër i bën veprat e veta vetëm për hir të All-llahut të Madhërishtëm.
  - c) All-llahu i Madhërishtëm e ka lavdëruar Ebu Bekrin.

## SUREJA “ED DUHA”

(E zbritur në Mekë, ka 11 ajete)

Ajetet 1 - 11

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për paraditën! 2. Për natën, kur shtrin errësirën!<sup>18</sup> 3. Zoti yt as nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur. 4. Bota e ardhshme do të jetë më e mirë për ty sesa e para (e tanishmja). 5. Zoti yt do të të japë ty atë me të cilën do të jesh i kënaqur. 6. A nuk të gjeti jetim e të përkrahu? 7. Të gjeti ty të paudhëzuar e Ai të udhëzoi, 8. Të gjeti të varfër e të begatoi. 9. Pra, mos e përul jetimin! 10. As lypsin mos e përzë! 11. E, mirësinë që të dha Zoti yt, shpalle!

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për kujdesin e All-llahut të Madhërishtëm për të Dërguarin e Tij dhe për nderet që i ka bërë në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Sureja përmend gjithashtu edhe udhëzime për sjelljen me jetimët.

---

18) All-llahu betohet.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) filloi t'i zbresë Shpallja në shpellën Hira, kur atij i zbriti Xhibrili me Fjalën e All-llahut të Madhërishëm: *“Lexo! Me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi.”*<sup>19</sup> Që nga ajo orë e bekuar, drita e së cilës ndriçoi tërë njerëzimin, Xhibrili u urdhërua që të rrinte gjithmonë i lidhur me Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).

Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ishte i gëzuar për Shpalljen që i vinte nga Zoti. Ai lumturohej, kur zbriste Xhebraili dhe e priste me padurim ardhjen e tij.

Njëherë ndodhi që Shpallja iu vonua. Kaloj njëfarë kohe dhe Xhebraili nuk po vinte tek i Dërguari All-llahut. I Dërguari i All-llahut u hidhërua nga kjo mungesë. Femohuesit kurejshë e morën vesh vonimin e Shpalljes dhe u gëzuan shumë. Ata thoshin: “All-llahu e braktisi Muhammedin” Atëherë, All-llahu i Madhërishëm i zbriti Profetit këtë sure të madhe, e cila e bën të qartë pozitën e lartë të Profetit për All-llahun dhe ua ktheu mbrapsht fjalët kurejshëve.

All-llahu i Madhërishëm betohet në paraditen, betohet në ato orë të bukura të fillimit të ditës, betohet në natën kur ajo hap errësirën e saj mbi tokë. All-llahu i Madhërishëm betohet në to se Ai nuk e ka braktisur të Dërguarin e Tij. Muhammedi është i Dërguari për të gjithë njerëzit dhe All-llahu i Madhërishëm e do atë.

All-llahu i Madhërishëm i jep sihariq Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) se Ai nuk e ka braktisur dhe se i ka përgatitur të mira të shumta në këtë botë dhe në Botën Tjetër. All-

---

19) *El Al'lak: 1.*

llahu i Madhërishëm e nderoi Muhammedin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) në këtë botë, duke e bërë të Dërguar për të gjithë njerëzit. Bota Tjetër do të jetë për të më e mirë se kjo botë, sepse All-llahu i Madhërishëm do t'i japë të Dërguarit të Vet dhe Bashkësisë (Umetit) së tij gjithçka që dëshirojnë.

All-llahu i Madhërishëm e ka ruajtur dhe e ka mbrojtur të Dërguarin e Vet, qëkur ai ishte ende fëmijë. All-llahu u kujdes për të dhe e përgatiti për të qenë Profet. I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) u lind jetim, por All-llahu bëri që për të të kujdesej gjyshi i tij, Abdul Muttalibi. Kur vdiq Abdul Muttalibi, për të u kujdes xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Edhe gjyshi i tij edhe xhaxhai ishin nga paria e Kurejshëve, kështu që, me dëshirën e All-llahut, Profeti u rrit i nderuar dhe krenar.

Kur u rrit Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) filloi ta kërkonte vetë të Vërtetën; ai nuk i adhuroi kurrë idhujt dhe nuk u besoi kurrë atyre. Atëherë, All-llahu e udhëzoi në rrugën e drejtë, të cilën ai e kërkonte, e dëshironte dhe e bëri të Dërguar.

Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ishte i varfër, por All-llahu i Madhërishëm e pasuroi, duke e bërë që të kishte “Bejtul Mal-in”<sup>20</sup> (Shtëpinë e Pasurisë). Por, Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) e shpërndante pasurinë e vet ndër muslimanë.

Pasi All-llahu i numëroi të Dërguarit të Tij këto të mira, i vuri atij përballë tri porosi të rëndësishme.

---

20) Kështu quhej vendi ku grumbullohej pasuria e muslimanëve, lëmoshat, plaçka e luftës, zekati etj.

1. Mëshiroje jetimin; jepi atij! Këshilloji edhe muslimanët të jenë të butë me të.
2. Ji i butë me atë që kërkon lëmoshë. Mos e përzë, mos e përul; këshilloje! Mësoji edhe muslimanët të veprojnë kështu.
3. Kujtoji të mirat që t'i ka dhënë All-llahu dhe falënderoje All-llahun për to! Mësoji edhe muslimanët të falënderojnë për të mirat që u janë dhënë.

Jetëshkrimi i Profetit tregon se ai e ka kryer detyrën që i ngarkoi All-llahu i Madhërishtëm. Ai kujdesej për jetimin dhe tregohej i butë me të. Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) thotë: *“Unë dhe kujdestari i jetimit jemi në xhenet si këta të dy”*<sup>21</sup>, dhe tregoi gishtin tregues dhe gishtin e mesit. Ky është një shpërblim i madh për ata që kujdesen për jetimin. Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) tregohej i butë edhe me ata që kërkonin lëmoshë. Ai nuk e kthente duarzbrazët asnjërin prej tyre. Profeti e falënderonte All-llahun shumë, me fjalë e me adhurim. Megjithëse All-llahu ia kishte falur mëkatet, ai thoshte: *“A të mos jem rob që falënderon?”*<sup>22</sup>

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. I Dërguari kishte një pozitë të lartë tek All-llahu i Madhë-rishëm.

---

21) E përcjell Buhariu.

22 E përcjell Muslimi.

2. I Dërguari e dëshironte shumë takimin me Xhebrailin për të marrë Shpalljeën.
3. All-llahu i Madhërishëm e ka nderuar Profetin e Vet në këtë botë dhe në Botën Tjetër.
4. Duhet të sillemi butë me jetimët dhe me ata që kërkojnë lëmshë.
5. Besimtari i çiltër e falënderon shumë Zotin dhe i përmend të mirat që Ai i ka dhënë.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Plotësojini fjalitë e mëposhtme me fjalë nga sureja:
  - a) Atij, që i vdes babai, quhet .....
  - b) Fala dy rekate sunet të .....
  - c) Nuk lejohet të japësh .....
2. Përse ka zbritur kjo sure?
3. Kërkoni në jetëshkrimin e Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) një ngjarje që tregon se ai sillej butë me ata që kërkonin lëmshë.
4. Tregoni dy çështje që i mësojmë nga ajetet.

## SUREJA “ESH SHERH”

(E zbritur në Mekë, ka 8 ajete)

Ajetet 1 - 8

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd? 2. Dhe hoqëm prej teje barrën tënde, 3. E cila rëndonte shpinën tënde. 4. Ne e ngritëm lart famën tënde. 5. Vërtet pas vështirësisë vjen lehtësimi. 6. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. 7. E pasi të lirohesh (nga detyrimi më i ngutshëm), atëherë mundo-hu edhe më shumë në adhurimin e All-llahut.<sup>23</sup> 8. Dhe vetëm te Zoti yt përqendro synimin!

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për të mirat që All-llahu i Madhërisëm i ka falur të Dërguarit të Tij.

---

*23) Fjalët mund të kenë këtë kuptim: kur të lirohesh nga detyra jote e ngutshme e këshillimit të të tjerëve, e luftimit të mëkatit dhe e nxitjes së devotshmërisë. Fjalët mund të kenë edhe kuptimin: kur të lirohesh nga vështirësitë që ke përpara. Në të dy rastet, nuk do të thotë se mbarojnë veprat e njeriut që është në rrugën e All-llahut. Ky është vetëm një hap drejt tyre veprave. Ai duhet pandërprerje dhe me këmbëngulje të vijojë më tej.*

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Kjo sure flet për kujdesin e All-llahut të Madhërishëm për Profetin e Tij, në mënyrë që ta kumtonte thirrjen e All-llahut te njerëzit. Kjo sure i ngjan sures “Ed Duha”, që është para saj.

Sureja tregon se si All-llahu i Madhërishëm ia ndriçoi zemrën të Dërguarit të Vet me besim (iman), si e bëri atë ta dojë thirrjen për në Islam e si e bëri atë të gatshëm që të mbajë mbi supe Mesazhin Islam. All-llahu i Madhërishëm ia largoi atij mërzinë që i kishte sjellë mosbesimi dhe shtrëngimi i kurejshë-ve, sepse Profeti donte që të gjithë të udhëzoheshin për në rrugën e drejtë. All-llahu i Madhërishëm ia lehtësoi Profetit të Tij mundimet që i shkaktonte populli i tij dhe e bëri të durue-shëm dhe të sigurtë në rrugën që ndiqte.

All-llahu i Madhërishëm e lartësoi kujtimin e të Dërguarit të Tij dhe e bëri atë të përjetshëm. Nuk kalon një orë në botë, pa u përmendur emri i të Dërguarit të All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) bashkë me emrin e All-llahut, në çdo ezan e në çdo namaz. All-llahu i Madhërishëm i porositi njerëzit që të çojnë Salavatë<sup>24</sup> mbi Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), t’i binden atij dhe ta duan atë. Ky shembull e të tjerë si ky janë nderim për Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), e lartësojnë kujtimin e tij.

Në këtë sure All-llahu i Madhërishëm i premton të Dërguarit të Tij se Ai do ta largojë varfërinë nga ai dhe nga muslimanët që janë rreth tij. All-llahu i Madhërishëm u premtoi atyre se do t’u jepte pasuri dhe siguri, se do t’ua bënte të lehtë të jetonin mirë e të sigurtë. All-llahu e mbajti

---

24) Të çojnë Salavatë - Të thonë: "Sal-IAll-llahu alejhi ue sel-lem"d.m.th. paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të.

premtimin e Vet, kur muslimanët emigruan nga Meka në Medine dhe kur Islami u përhap në shumë vende të tjera. Pas kësaj, All-llahu kërkoi nga i Dërguari i Tij që ta falënderonte All-llahun për ato të mira dhe të ishte i zellshëm në adhurim. All-llahu i Madhërishtëm i thotë të Dërguarit të Tij: *“Kur ta mbarosh thirrjen për në Islam ditën, falu natën dhe kalaje kohën e mbetur duke adhuruar All-llahun, që Ai të kënaqet prej teje.”* I Dërguari All-llahut i zbatoi me përpikëri të gjitha urdhrat e All-llahut të Madhërishtëm.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm e ndihmoi Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) të përcillte Mesazhin, duke e bërë atë ta donte thirrjen për në Islam.
2. All-llahu i Madhërishtëm e ngriti lart kujtimin e të Dërguarit të Tij dhe e përjetësoi emrin e tij.
3. All-llahu i Madhërishtëm i premtoi të Dërguarit të Vet se do ta shpëtonte pas vështirësisë dhe do ta pasuronte pas varfë-risë.
4. All-llahu i Madhërishtëm e udhëzonte të Dërguarin e Tij ta adhuronte All-llahun rregullisht për të fituar kënaqësinë e Tij.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Nuk kalon as edhe një orë në këtë botë pa u përmendur emri i të Dërguarit të All-llahut. Mendohuni dhe tregoni si arrihet kjo.
2. Përmendni dy çështje që na i mësojnë ajetet.
3. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjali të përshtatshme nga sureja:
  - a) Pastroje ..... tënde nga smira për vëllezërit e tu muslimanë.
  - b) Drejtoje ..... , kur je në ruku.
4. Thoni një ngjarje nga jetëshkrimi i Profetit, ku bëhet i qartë durimi i tij ndaj mundimeve të femohuesve.

## **SUREJA “ET TIN”**

(E zbritur në Mekë, ka 8 ajete)

Ajetet 1 - 8

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për fikun dhe ullirin! 2. Dhe Turi Sinanë! 3. Dhe për këtë qytet të sigurisë! 4. Vërtet, ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. 5. Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve, 6. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, ata kanë shpërblim të pandërprerë. 7. E, pas gjithë kësaj, ç'të shtyri të përgënjeshtrosh Ditën e Shpërblimit? 8. A nuk është All-llahu më i Urti i gjykuesve?

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për të mirat që i ka dhënë All-llahu njeriut, për shpërblimin e atij që beson dhe për dënimin e atij që mohon.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Turi Sina - Mali, ku All-llahu i Madhërishëm i foli Musait.

Qytet të sigurisë - Meka e Nderuar.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM SURES

Në këtë sure, All-llahu i Madhërishëm betohet për tri vende, ku ka dërguar tre Profetë të nderuar. All-llahu i Madhërishëm betohet në Bejtul Mukades-in, ku dërgoi Isanë (paqja qoftë mbi të). Ai vend njihet për pemët e fikut dhe të ullirit. All-llahu i Madhërishëm betohet edhe në Turi Sina-në, në Malin e Bekuar, ku All-llahu i foli Musait dhe prej ku e nisi Musanë për te Faraoni. All-llahu i Madhërishëm betohet në Mekën, vendin, ku All-llahu i Madhërishëm dërgoi Profetin Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).

All-llahu i Madhërishëm betohet në këto vende të bekuara se e krijoi njeriun në formën më të mirë dhe i dha atij ndjeshmërinë, mendjen, dëgjimin dhe shikimin, që të jetë me moral të lartë, që ta shohë të mirën dhe ta ndjekë atë dhe ta shohë të keqen e t'i largohet asaj. Por, shumë njerëzve nuk u bëjnë dobi mendja dhe shqisat dhe ata zgjedhin mohimin dhe humbjen. All-llahu i Madhërishëm i fut ata në xhehenem në një formë të shëmtuar. Ndërsa për ata që besuan e bënë vepra të mira, All-llahu i Madhërishëm ka përgatitur në xhenet të mira që nuk mbarojnë kurrë.

Pas kësaj All-llahu i Madhërishëm qorton femohuesit: *“Përse e përgënjeshtrojnë ata Ditën e Kijametit?”* All-llahu do t'i gjykojë ata me dënim, ashtu siç e meritojnë, sepse ata kanë mohuar. Nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut. All-llahu është më i Urti, më i Drejti.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm betohet në tri vende, ku ka dërguar Profetët e Tij, se Ai e ka krijuar njeriun në formën më të bukur.
2. Besimi dhe veprat e mira i bëjnë dobi njeriut si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër.
3. Mohimi (kufri) e ul njeriun në shkallën më të ulët si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër.
4. All-llahu i Madhërishtëm është i Drejtë në gjykimin e Tij.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Çdo fjalie të kolonës A i vini përballë fjalinë, që i përshtatet nga kolona B:
2. Ç’do të thotë: “Në formën më të bukur”?

A

All-llahu i Madhëruar i foli Musait

Shumë Profetë janë dërguar

All-llahu i Madhëruar e dërgoi  
Muhammedin

B

Në Mekë, në vendin e sigurtë.

Në Malin Tur.

Në Palestinë, në vendin e fiqve dhe të  
ullinjve

## SUREJA “EL ALAK”

(E zbritur në Mekë, ka 18 ajete)

Ajetet 1 - 8

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Lexo<sup>25</sup> me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka). 2. Krijoi njeriun prej një pikëze gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). 3. Lexo! Se Zoti yt është më Bujari. 4. Ai i mësoi (njeriut) të përdorë Penën. 5. I mësoi njeriut atë që njeriu nuk e dinte, 6. Por, njeriu i kalon (të gjitha) caqet, 7. Sepse kujton se është i pavarur.<sup>26</sup> 8. Por, për te Zoti yt është kthimi.

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për fillimin e zbritjes së Kur’anit, për mohimin që i bën njeriu Zotit dhe për Ebu Xhehlin.

---

25) Në arabisht “Ikra” mund të ketë kuptimin lexo ose recito, përsërit (fjalët që të thotë dikush tjetër), ose shpall, deklaro me zë të lartë.

26) Njeriu nuk është i pavarur, as si individ, as si shoqëri. Le të kujtojë ai prej-ardhjen e tij fizike dhe përgjegjësinë e kthimin te Zoti.

## KUPTIMI I FJALËVE

I kalon caqet-E tepron me mëkatet e veta,bën shumë mëka-te.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Pesë ajetet e para të kësaj sureje janë edhe pesë ajetet e para që i kanë zbritur Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ishte në shpellën Hira, kur i erdhi engjëlli Xhebrail e i tha: *“Lexo!”* *“Unë nuk di të lexoj,”* - iu përgjigj Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). *“Lexo!”*- përsëriti Xhebraili. *“Unë nuk di të lexoj,”* - iu përgjigj përsëri Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Atëherë, Xhebraili vazhdoi: *“1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka). 2. Krijoi njeriun prej një pikëze gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). 3. Lexo! Se Zoti yt është më Bujari. 4. Ai i mësoi (njeriut) të përdorë Penën. 5. I mësoi njeriut atë që njeriu nuk e dinte.”* Me këto ajete All-llahu i Madhërishtëm i drejtohet Profetit të Vet dhe të gjithë besimtarëve që punët e tyre e fjalët e tyre t’i fillojnë me *“Bismilah”* (Me emrin e All-llahut), sepse çdo punë që fillon me emrin e All-llahut dhe me mbështetjen tek All-llahu, ka mirësi. Këto ajete tregojnë që është detyrë që të jemi të çiltër me All-llahun e Madhërishtëm në veprat që bëjmë e në fjalët që themi. Muslimani punon dhe flet për të fituar kënaqësinë e All-llahut të Madhërishtëm.

Këto ajete tregojnë rëndësinë e madhe që Islami i kushton dijes. Fjala e parë që ka zbritur nga All-llahu i Madhërishëm për te Profeti i Tij (pagja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që “Ikra” (Lexo!)

All-llahu i Madhërishëm tregon se e ka krijuar njeriun nga “alaku”- një pikëz gjaku e ngjizur që zhvillohet dhe sjell njeriun. Pasi fëmija del nga barku i së ëmës dhe rritet, ai fillon të mësojë. E All-llahu i Madhërishëm i mësoi njeriut si të përdorë penën; të mësojë gjithnjë e më shumë. Kjo është bujari dhe nderim nga All-llahu i Madhërishëm për njeriun, duke i dhuruar atij dijen. Por, ky njeri, kur rritet, fillon t’i pëlqejë vetja dhe fuqia që ka, fillon t’i pëlqejë pasuria që ka mbledhur, harron mirësitë e All-llahut i Madhërishëm dhe gabimet e veta të shumta. Dhe All-llahu i kujton njeriut se ai do të kthehet te Zoti i tij, do të japë llogari për veprat e tij të këqija dhe do të dënohet për to.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. Islami i ka kushtuar kujdes dijes e studimit. Edhe fjala e parë që erdhi nga Zoti që: “Lexo!”.
2. Muslimani i fillon fjalët dhe veprat e veta me “Bismilah” (Me emrin e All-llahut).
3. All-llahu i Madhërishëm e mësoi njeriun dhe ia lehtësoi atij përdorimin e mjeteve të mësimi, më e rëndësishmja e të cilave është Pena.

4. All-llahu i Madhërisëm i thotë njeriut të ruhet nga mendjemadhësia dhe të mos largohet nga adhurimi i Zotit të tij.
5. Të gjithë njerëzit do të kthehen tek All-llahu i Madhërisëm për të dhënë llogari për veprat që kanë bërë.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Flisni për takimin e parë të Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) me Xhebrailin (paqja qoftë mbi të).
2. Cili është ajeti i parë që i ka zbritur Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të)?
3. Ç’do të thotë: “Te Zoti yt është kthimi”?

## **AJETET 9 - 19**

9. A e keni parë atë që ndalon? 10. Një rob që kërkon të falet? 11. Ç’mendon, kur ai (robi) është në Rrugë e Drejtë? 12. Ose kur ai (robi) urdhëron për devotshmëri (tekua)? 13. A më tregon

nëse ai<sup>27</sup> e mohon të Vërtetën dhe i kthen shpinën asaj? 14 A nuk e di ai se All-llahu e sheh? 15. Jo, jo! Nëse nuk tërhiqet, vërtet Ne do ta tërheqim zvarrë për ballukesh.<sup>28</sup> 16. Për ballukesh gënjeshtarë, mëkatarë. 17. E ai le t'i thërrasë për ndihmë ata të vetët. 18. Ne do t'i thërrasim engjëjt e ndëshkimit të merren me të. 19. Jo, jo! Ti mos iu bind atij, vazhdo me sexhde dhe afroju Zotit sa më afër.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Ajetet flasin për njerin prej atyre njerëzve të cilit i pëlqeu fuqia dhe pasuria e vet e i kaluan caqet dhe e mohuan Zotin: për Ebu Xhehlin, armikun numër një të Islamit. Ajetet flasin edhe për cilindo, që ka bërë a bën vepra të këqija si të Ebu Xhehlit. Një herë, Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) po falej në Mekë. Kur ra në sexhde, Ebu Xhehli deshi t'i vinte Profetit këmbën mbi qafë. Por, Ebu Xhehli nuk arriti dot te Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Ai u kthye i frikësuar te ndihmësit e vet. Ata e pyetën: *“Përse u ktheve kështu, kaq shpejt?”* Ebu Xhehli u përgjigj: *“Pashë një hendek zjarri e gjëra të tjera të frikshme midis meje dhe Muhammedit, prandaj u largova.”* Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) e komenton ngjarjen kështu: *“Sikur të afrohej edhe pak, do ta kapnin engjëjt e dënimit dhe do ta bënin copë-copë.”*

---

27) Ai : *Është fjala për atë që ndalon një rob që kërkon të falet etj.*

28) *Balluket janë mbi ballë; ato simbolizojnë kulmin e forcës dhe të dinjitetit të njeriut. Ta tërheqësh për ballukesh do të thotë të vuajë poshtërimin më të ulët.*

All-llahu i Madhërishtëm na flet për atë që i ndalon njerëzit të falin namazin e ta adhurojnë All-llahun. Vepra e tij është e shëmtuar, e shëmtia e saj është edhe më e madhe kur përpiket të ndalohet një i Dërguar, i cili urdhëron për të bërë vepra të mira e për të mos bërë vepra të këqija; shëmtia është edhe më e madhe kur përpiket të ndalohet Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Ky femohues nuk u mjaftua vetëm duke e ndaluar Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) të falej. Ai përgënjeshtroi Ditën e Gjykimit, mohoi All-llahun, e kundërshtoi Islamin, i ktheu shpinën të vërtetës. Por ai nuk kupton se All-llahu i shikon veprat e tij dhe i shënon ato të gjitha, që t'i kërkojë llogari të rreptë për to në Ditën e Gjykimit. All-llahu i Madhërishtëm e paralajmëron Ebu Xhehlin se, në qoftë se nuk pendohej e nuk e linte armiqësinë ndaj Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), All-llahu do ta bënte të vuante dënim të fortë në këtë botë nga besimtarët dhe në botën tjetër nga engjëjt e dënimit.

All-llahu i Madhërishtëm do t'i urdhërojë engjëjt ta kapin Ebu Xhehlin prej ballukesh e ta tërheqin zvarrë deri në Zjarr. Në këtë botë, Ebu Xhehli ka thirrur shokët e tij që ta ndihmonin në luftë kundër Islamit, por në Botën Tjetër nuk do të ketë mundësi të thërrasë për ndihmë ndonjë prej tyre, sepse engjëjt e dënimt do t'i çojnë të gjithë ata në zjarrin e xhehenemit.

Më pas All-llahu i Madhërishtëm i drejtohet Profetit të Tij: Qëndro i palëkundur në të vërtetën; lëri Ebu Xhehlin dhe ata që janë si ai dhe vazhdo namazin tënd për Zotin; vazhdoje sexhden, që të jesh pranë Zotit tënd, sepse njeriu, kur është në sexhde, është pranë All-llahut të Madhërishtëm më shumë se kurrë. Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) e përforcon edhe më shumë këtë kuptim, kur thotë: *“Njeriu është më pranë Zotit të tij kur bie në sexhde, prandaj shtojmi lutjet në sexh-de.”*

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Në ajete tregohet armiqësia e madhe e Ebu Xhehlit për Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe Isla-min.
2. Në ajete tregohet se si All-llahu i Madhërishëm e ruante Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) nga çdo e keqe.
3. Punët më të shëmtuara janë t'i ndalosh njerëzit të adhurojnë All-llahun dhe të bëjnë vepra të mira.
4. Në ajete tregohet dënimi i rëndë që All-llahu i Madhërishëm ka përgatitur për Ebu Xhehlin dhe ata që veprojnë si ai.
5. All-llahu i Madhërishëm e porosit Profetin e Tij që të qëndrojë i palëkundur në adhurim dhe të vazhdojë të bjerë në sexh-de për All-llahun e Madhërishëm.
6. Kjo sure përmban një sexhde këndim<sup>29</sup>, prandaj kur muslimani këndon ose dëgjon ajetin duhet të bjerë në sexhde në drejtim të Kiblës.

---

29) Sexhde, që bëhet pas dëgjimit të ajeteve të caktuara.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Ç'kishte ndërmend t'i bënte Ebu Xhehli Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), kur Profeti po falej?
2. Përse u kthye Ebu Xhehli i trembur, pa i bërë ende keq të Dërguarit të All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të)?
3. Çfarë tha Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) për këtë ngjarje?
4. Ajetet flasin për tri cilësi të Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Cilat janë ato?
5. Ajetet flasin për tri cilësi të këqija të Ebu Xhehilit. Cilat janë ato?
6. Çfarë duhet të bëjnë muslimanët kur këndojnë ose dëgjojnë ajetin: “Jo, jo! Ti mos iu bind atij, vazhdo me sexhde dhe afroju Zotit tënd sa më afër!”?

## SUREJA “EL KADËR”

(E zbritur në Mekë, ka 5 ajete)

Ajetet 1 - 5

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Vërtet, Ne e kemi zbritur këtë (Kur'anin) në Natën e Kadrit. 2. E ku e di ti se ç'është Nata e Kadrit! 3. Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë Muaj.<sup>30</sup> 4. Me lejen e Zotit të tyre zbresin engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili) për çdo çështje. 5. Paqe! ... Kjo (paqja) deri sa të zbardhë agimi.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja trajton Natën e Kadrit, të mirat e saj e çfarë mund të fitohet në këtë Natë.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Nata e Kadrit - Nata që bie me 23, 25 ose 27 të muajit Ramazan. Është quajtur Nata e Fuqisë ose e Nderit, natë, në të cilën Shpallja i zbriti për herë të parë Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) nëpërmjet engjëllit Xhibril.

---

*30) Një mijë është në kuptimin e një kohe pa kufi: mijëra muaj ose vite.*

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Ajetet e kësaj sureje flasin për Natën e madhe e të bekuar, për Natën e Kadrit, një prej netëve të muajit Ramazan.

Natën e Kadrit, All-llahu i Madhërishtëm e zbriti Kur'anin e Shenjtë nga “Leuhul Mahfudh”, që është në qiellin e shtatë, në qiellin e Tokës. Më pas, Xhebraili ia zbriti Kur'anin Profetit (paq-ja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) pjesë-pjesë, për njëzet e tre vjet me radhë.

Nata e Kadrit ka një vlerë të madhe dhe mirësitë e saj janë të shumta, sepse atë Natë është zbritur Kur'ani, si një diell për botën. Prandaj, kjo Natë është më e rëndësishme se një mijë muaj. Në qoftë se në këtë Natë muslimani e adhuron All-llahun me çiltëri e me zell, All-llahu i Madhërishtëm mund t'i japë shpërblimin e adhurimit për një mijë muaj. Në këtë Natë zbresin edhe engjëjt, me në krye Xhebrailin. Ata sjellin me vete mirësi e paqe, ata luten për besimtarët deri në agim.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Nata e Kadrit është një natë e madhe; atë Natë All-llahu i Madhërishtëm zbriti Kur'anin.
2. Për mirësitë dhe sevapet, Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.
3. Në këtë Natë zbresin në Tokë engjëjt, bashkë me ta dhe Xhebraili.

4. All-llahu i Madhërishtëm ka caktuar mirësi dhe paqe në këtë Natë për besimtarët.
5. Nata e Kadrit është nata teke në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit (23, 25 ose 27).

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Në vend të shprehjeve në kllapa vini fjalën e barasvlershme kuptimisht.
  - a) All-llahu i Madhërishtëm e zbriti Kur'anin e Shenjtë në (një natë më të mirë se një mijë muaj).
  - b) Natën e Kadrit zbresin engjëjt (me të parin e tyre, Shpir-tin Besnik).
  - c) Engjëjt do të luten për mirësi për besimtarët (derisa të mbarojë nata e të fillojë mëngjesi).
2. Cilat janë netët ku mund të bjerë Nata e Kadrit?
3. Në ç'muaj është Nata e Kadrit?
4. Më e mirë se sa muaj është Nata e Kadrit?

## **SUREJA “EL BEJJINE”**

(E zbritur në Mekë, ka 8 ajete)

## Ajetet 1 - 8

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Ata që nuk besuan nga ithtarët e Librit dhe nga idhujtarët nuk kishin ndërmend të ndaheshin nga besimi i tyre, derisa t'u vinte argumenti i Qartë.<sup>31</sup> 2. I Dërguari i All-llahut, që lexon Fletë të pastra, 3. Në të cilat ka vetëm dispozita të drejta. 4. Ata, të cilëve u është dhënë Libri, u ndanë vetëm pasi u kishte ardhur argumenti. 5. E ata nuk qenë udhëzuar për tjetër, vetëm që të adhuronin All-llahun çiltërisht; që të largohen nga çdo besim i kotë, që ta falin namazin, që të japin zekatin; kjo është Feja e Drejtë. 6. Vërtet, ata nga ithtarët e Librit dhe idhujtarët që mohuan të Vërtetën, do të jenë në Zjarrin e xhehenemit; aty do të mbesin përgjithmonë. Ata janë më të këqijat e krijesave,<sup>32</sup> 7. Kurse ata që besuan dhe bënë vepra të mira, janë më të mirat e krijesave. 8. Shpërblimi i tyre te Zoti janë xhenete të larta, nëpër të cilët rrjedhin lumej. Ata do të jenë aty përgjithmonë. All-llahu është i kënaqur prej tyre e ata janë të kënaqur prej Tij. Ky (shpërblim) është për atë, që e ka pasur frikë Zotin e vet.

---

31) Argumenti i Qartë që vetë Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), jeta e tij, personaliteti i tij dhe mësimet e tij.

32) All-llahu ia ka dhënë njeriut aftësinë për të dalluar të mirën dhe të keqen. Atëherë, të mohosh të Vërtetën është vepra më e keqe që mund të bëjë një krijesë me mendje dhe me vullnet.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për ndarjen në grupe të ithtarëve të Librit për besimin në të Dërguarin e All-llahut. Sureja flet për futjen në Zjarr të jobesimtarëve dhe për futjen në xhenet të besimtarëve.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Fletë të pastra - Fletë pa gabime e pa të meta.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

Kjo sure flet për ithtarët e Librit -çifutët dhe të krishterët- dhe për idhujtarët. Megjithëse një pjesë e tyre thoshin se do ta pranonin “fenë e Muhammedit” (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), sureja tregon se ata mbetën në fetë e tyre të pasakta.

All-llahu i Madhërishtëm dërgoi Muhammedin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) me mesazhin Islam. All-llahu i zbriti atij Kur’anin e Shenjtë, i cili është një libër i pastër nga gënjeshttrat. Në Kur’an ka ligje e udhëzime nga Zoti për të gjithë njerëzimin e për të gjitha kohët.

Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ua përcolli këto udhëzime të gjithë njerëzve.

Kur Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) shpalli Islamin, ithtarët e Librit u ndanë në dy pjesë. Një pjesë e pranoi Islamin, kurse pjesa tjetër mbetën mohues, duke mëtuar se Isai na qenka biri i All-llahut, se Uzejri na qenka, gjithashtu, biri All-llahut. Kështu ndodhi edhe me idhujtarët e tjerë arabë.

All-llahu i Madhërishëm i pati udhëzuar çifutët dhe të krishterët të adhuronin vetëm Atë e t'i largoheshin shirkut, të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo ishte feja e mirësive për ta. Ky ishte Islami, me të cilin erdhi Muhammedi. Çdo fe tjetër është e pavlerë, e pa asnjë të mirë në të.

Pasi All-llahu ua bëri të qartë njerëzve vendin e atij që e mohon Islamin dhe vendin e atij që e beson Islamin, tha: “Çifutët, të krishterët dhe idhujtarët do të hyjnë në xhehenem e aty do të mbesin përgjithmonë. Ata janë më të këqinjët e krijesave, sepse mohuan.” All-llahu i Madhërishëm thotë: *“Vër-tet, krijesat më të dëmshme tek All-llahu janë ata që mohuan, që nuk besuan.”*

Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira janë krijesat më të mira. All-llahu i Madhërishëm ka përgatitur për ta xhenete, në të cilat do të jenë përgjithmonë, sepse All-llahu i do ata dhe i ka pranuar veprat e tyre të mira. Ata që besuan, do të gëzohen që hyjnë në xhenet. Ata do të kënaqen me shpërblimin e All-llahut. Ata e arritën këtë vend, sepse e patën frikë All-llahun e Madhërishëm kur ishin në këtë botë.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm ka dërguar Muhammedin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) Profet për gjithë njerë-zimin.
2. All-llahu i Madhërishtëm i ka urdhëruar të gjithë njerëzit që të adhurojnë vetëm Atë dhe të jenë të çiltër në adhurimin e tyre.
3. Islami është feja e vërtetë, është feja botërore. Ai i ka anuluar fetë e tjera.
4. Jobsimtarët janë më të këqinjët e krijesave. Ata do të mbesin përgjithmonë në xhehenem.
5. Besimtarët janë më të mirët e krijesave. Ata do të jenë përgjithmonë në xhenet.
6. All-llahu i Madhërishtëm është i kënaqur prej atyre, që futen në xhenet dhe i bënë edhe ata të kënaqen me të mirat e mëdha që ka përgatitur për ta.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Thoni të kundërtat e fjalëve të mëposhtme:
  - a) Mohim
  - b) E mirë

c) I kënaqur

2. Plotësoni përgjigjet e mëposhtme.

a) Cilët janë ithtarët e Librit? Ithtarët e Librit janë çifutët dhe të.....

b) Kur u ndanë në mes tyre ithtarët e Librit? Ithtarët e Librit u ndanë në mes tyre kur All-llahu i Madhërishëm dërgoi midis tyre të.....

c) Për çfarë e ka urdhëruar All-llahu i Madhërishëm njeriun? All-llahu i Madhërishëm e ka urdhëruar njeriun të jetë i çiltër në adhurim, të falë ..... dhe .....

3. Tregoni dy çështje për të cilat flet sureja.

## **SUREJA “EZ ZELZELE “**

(E zbritur në Mekë, ka 8 ajete)

Ajetet 1 - 8

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur të dridhet Toka me dridhjen e saj të fuqishme 2. Dhe (Toka) të nxjerrë atë që ka brenda saj, 3. Dhe njeriu të thotë: “Ç’është kështu?” 4. Atë Ditë, ajo (Toka) i rrëfen tregimet e veta, 5. Sepse Zoti yt e ka urdhëruar atë (Tokën). 6. Atë Ditë njerëzit do të ndahen në grupe, që të shpërblehen për veprat e tyre. 7. Kush bën një të mirë, qoftë edhe sa një grimcë, do ta gjejë (në Botën Tjetër). 8. E, kush bën një të keqe, qoftë edhe sa një grimcë, do ta gjejë (në Botën Tjetër).

## KUPTIMI I FJALËVE

Të nxjerrë atë që ka brenda saj - Të nxjerrë të vdekurit, e varrosur në të.

Ç’është kështu - Përse dridhet Toka, vallë?

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Kjo sure flet për çfarë do të ndodhë në Ditën e Gjykimit. All-llahu i Madhërishtëm thotë se: “Toka do të dridhet fuqishëm dhe njerëzit do të dalin prej saj, d.m.th., prej varreve pas fryrjes së dytë të Brrit (Surit). Jobsimtari do të habitet: “Ç’po ndodh me Tokën?” Do të pyesë veten përse ka dalë nga varri, sepse ai nuk e besonte Ringjalljen.

Do të jetë All-llahu i Madhërishtëm Ai që do ta urdhërojë Tokën të nxerrë të vdekurit në atë Ditë. All-llahu i Madhërishtëm do t'i kërkojë Tokës të rrëfejë çfarë kanë bërë njerëzit kur jetonin mbi të.

Ebu Hurejra (All-llahu qoftë i kënaqur me të) tregon: “Profeti (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) u këndoi ajetin: “Atë Ditë, ajo i rrëfen tregimet e veta” dhe tha: “A e dini se ç’janë “tregimet e veta?”” “All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë,”- u përgjigjën shokët. “Tregimet e veta,”- vazhdoi ai, - “janë: (Toka) do të dëshmojë për çdo rob, për çdo vepër që ka bërë robi. Ajo do të thotë: Ka vepruar kështu në këtë ditë e në këtë kohë.”

Në Ditën e Gjykimit, All-llahu i Madhërishtëm do t’u kërkojë llogari njerëzve me drejtësi të plotë. Ai do t’u peshojë njerëzve veprat e tyre, derisa njerëzit t’i shikojnë vetë ato. All-llahu do t’i shpërblejë njerëzit për veprat e mira, sado të vogla qofshin ato. All-llahu i Madhërishtëm do t’u kërkojë llogari njerëzve edhe për veprat e këqija, sado të vogla qofshin ato dhe do t’i dënojë ata që kanë bërë të tilla vepra.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. Toka do të ndryshojë në Ditën e Kijametit.
2. Pas fryrjes së dytë të Surit, njerëzit do të dalin nga varret e tyre në Ditën e Tubimit.
3. Në Ditën e Gjykimit, Toka do të tregojë veprat e njerëzve.
4. All-llahu i Madhërishtëm është i Drejtë në Gjykimin e Tij.

5. Bota Tjetër është krejt e ndryshme nga bota jonë.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Futeni në rreth përgjigjen e saktë:

a) Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të dalin nga:

Shtëpitë e tyre

Varret e tyre

Vendet e tyre

b) Në Ditën e Gjykimit gjithkush do të nxitojë të shohë:

Të afërmit e vet

Veprat e veta

Shokët e miqtë e vet

2. Plotësojini vendet bosh me fjalë.

a) Kush bën vepra të \_\_\_\_\_ , do të hyjë në xhenet.

b) Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të jenë të ndarë e të \_\_\_\_\_ .

c) \_\_\_\_\_ do t'u kërkojë llogari njerëzve për veprat e bëra.

3. Flisni për tri çështje që trajtohen në ajetet e mësipërme.

## SUREJA “EL ADIJATË “

(E zbritur në Mekë, ka 11 ajete)

Ajetet 1 - 11

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për vrapuesit e shpejtë (kuajt) që hingëllijnë,<sup>33</sup> 2. Që me thundrat e tyre nxjerrin xixa nga gurët, 3. Kur vërsulen herët në agim 4. E, me këtë (vërsulje) ngrenë pluhur. 5. Dhe hidhen në mesin e grumbullit (të armikut). 6. Vërtet, njeriu është përbuzës ndaj Zotit të vet. 7. Edhe vetë njeriu e dëshmon atë (përbuzjen). 8. Ai e do shumë pasurinë. 9 A nuk e di se atë Ditë, kur të nxirret çfarë ka në varreza 10. Dhe të tubohet ajo që është në zemra 11. Atë Ditë, pa dyshim, Zoti i tyre i njeh veprat e tyre.

---

33) Është betim i All-llahut.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për të mirat e kuajve të muxhahidinëve (atyre që luftojnë në rrugën e All-llahut) dhe disa cilësi të këqija të njeriut.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Të tubohet ajo që është në zemra - Në Ditën e Gjykimit do të dalë në shesh ajo që fshihej në zemrat e njerëzve.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

All-llahu i Madhërishtëm betohet në fillimin e kësaj sureje për kuajt e luftëtarëve në rrugën e All-llahut (muxhahidëve). All-llahu i Madhërishtëm betohet për kuajt që vraponin me aq shpejtësi, sa dilnin xixa nga thundrat e tyre. Ata ngrinin pluhur herët në mëngjes, kur muxhahidinët sulmonin armiqt.

All-llahu i Madhërishtëm betohet në këta kuaj, se njeriu ka shumë cilësi të këqija e prej tyre janë:

1. Njeriu nuk i njeh mirësitë që i ka dhënë All-llahu. Ai harron të mirat që i ka dhënë All-llahu dhe kujton vetëm fatkeqësitë që e kanë goditur atë. Janë veprat e njeriut dhe vetë njeriu që dëshmojnë për këtë.

2. Njeriu e do shumë pasurinë; aq shumë sa shpeshherë ai përpiqet ta sigurojë atë me rrugë të ndaluara (haram); aq shumë sa pasuria e bën atë të jetë i mangët në adhurimin e All-llahut.

All-llahu i Madhërishtëm e paralajmëron njeriun dhe kërkon prej tij që ta kujtojë mirë Ditën e Ringjalljes, ditën kur njerëzit do të dalin prej varreve për të dhënë llogari.

All-llahu i Madhërishtëm do t'i mbledhë njerëzit, do t'u paraqesë atyre gjithçka kanë bërë e thënë në këtë botë, gjithçka që kanë besuar dhe do t'u kërkojë llogari për to. Kjo është fare e lehtë për All-llahun, sepse All-llahu i mbikëqyr të gjitha veprat e njerëzve.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Ajetet tregojnë mirësinë e Xhihadit (të luftës në rrugën e All-llahut).

2. Njeriu tregohet i padrejtë ndaj vetes së tij, kur i mohon mirësitë e All-llahut.

3. Njeriu i do shumë të mirat e kësaj bote.

4. Në Ditën e Ringjalljes, All-llahu i Madhërishtëm do t'i nxjerrë njerëzit nga varret, do t'i mbledhë veprat e tyre e do t'u kërkojë llogari për to.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Thoni dy gjëra që ndodhin kur sulmojnë Muxhahidinët.
2. Sureja flet për disa cilësi të këqija të njeriut. Përmendni dy prej tyre.
3. Ç’do të thotë ajeti: “Dhe të tubohet ajo që është në zemra.”?
4. Plotësoni me fjalët më të përshtatshme fjalitë që vijoj-në:
  - Dashuria e njeriut për pasurinë e bën atë .....
  - të japë lëmoshë
  - ta kërkojë atë në çdo mënyrë
  - Në Ditën e Gjykimit, All-llahu i Madhërishëm do t’i mbledhë veprat e njerëzve.....
  - Për t’u kërkuar llogari për to
  - Për t’ua falur ato

## SUREJA “EL KARIA”

(E zbritur në Mekë, ka 11 ajete)

Ajetet 1 - 11

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Krisma e Kijametit. 2. Çfarë është krisma e Kijametit? 3. Dhe ç'të mësoi ty se çfarë është krisma e Kijametit? 4. Ajo është Dita kur njerëzit bëhen si kandrra të shpërndara 5. Dhe kodrat bëhen si leshi i prishur. 6. E sa i përket atij, që i rëndohet peshorja e veprave të tij, 7. Ai është në një jetë të këndshme, 8. Ndërsa vendi i atij, që e ka të lehtë peshojën e veprave të tij, 9. Vendi i tij do të jetë në Havije. 10. E ç'është ajo që të mësoi se ç'është Havija? 11. Është zjarri me nxehtësi shumë të madhe.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure flet për çfarë do të ndodhë në Ditën e Kijametit si dhe për mënyrën se si All-llahu i Madhërishtëm do t'u kërkojë llogari njerëzve.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

El Karia - Krisma, zëri i frikshëm; emër i Ditës së Kijametit.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Këto ajete flasin për disa çështje, që do të ndodhin Ditën e Kijametit. All-llahu i Madhërishtëm tregon se në Ditën e Kijametit gjithësia do të shohë pasojat e një ngjarjeje të madhe e të frikshme, që do të shoqërohet me një zë të tmerrshëm e bubu-llues. All-llahu i Madhërishtëm do t'i tubojë njerëzit për t'i gjykuar. Atë ditë, njerëzit do të jenë si kandrra të shpërndara në çdo vend. Çdonjëri prej tyre do të vërtitet andej-këtej, i frikësuar për fundin e tij. Malet, që janë aq të forta dhe të qënd-rueshme, do të bëhen si lesh i hedhur në ajër sikur të ishin një pjesëz prej reve. Atë Ditë, All-llahu i Madhërishtëm do t'i gjykojë të gjithë njerëzit dhe do t'u peshojë atyre veprat, që i bënë në këtë botë. Ai njeri, i cili ka bërë vepra të mira më shumë sesa të këqija, do të shijojë jetën e xhenetit. Kurse për atë njeri, që ka bërë më shumë vepra të këqija se të mira, është përgatitur një vend në Zjarr.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm e ka quajtur Ditën e Kijametit “Krishtë”, sepse ajo vjen me një zë të frikshëm.
2. Ditën e Kijametit do të ndryshojë gjendja e Gjithësisë.
3. Ditën e Kijametit, nga frika e madhe, njerëzit do të jenë si kandrra të shpërndara.

4. All-llahu i Madhërishëm do t'i peshojë veprat e njerëzve dhe njerëzit do t'i shohin vetë ato.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Kujtoni tri emërtime të Ditës së Kijametit.
2. Gjikoni si janë malet sot dhe si do të jenë në Ditën e Kijametit.
3. Plotësoni pikat me njëren prej dy fjalëve që janë mes kllapave:
  - a) Ditën e Kijametit njerëzit do të jenë ..... si kandrra (të vogla, të shpërndara)
  - b) Ditën e Kijametit malet do të jenë ..... si re (të rënda, të lehta).
  - c) Njeriu, i cili shton ..... do të hyjë në xhenet (të këqijat e tij, të mirat e tij)
4. Ç'farë do të bëjë All-llahu i Madhërishëm me veprat e njerëzve në Ditën e Gjykimit?
5. Vendosni secilën prej fjalëve të mëposhtme në fjalinë e duhur: kandrrat, malet, retë.

## SUREJA “ET TEKATHUR”

(E zbritur në Mekë, ka 8 ajete)

Ajetet 1 - 8

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Rivaliteti i ndërsjellë për të shumuar (gjërat e mira të kësaj bote) ju ka larguar (nga gjërat më serioze të saj), 2. Derisa t’i vizitoni varrezat.<sup>34</sup> 3. Por jo. Ju shpejt do ta dini (të vërtetën). 4. Po, po, ju shpejt do ta dini (të vërtetën). 5. Jo, sikur ta dinit me një dije të sigurt (ju do të ishit ruajtur), 6. Ju vërtet, do ta shihni xhehenemin. 7. Po, po. Ju do ta shihni atë (xhehenemin) vetë, me sytë tuaj. 8. Pastaj, në atë Ditë do të pyeteni për të mirat (që i keni lakmuar në këtë botë).

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja tregon që njerëzit nuk i kushtojnë vëmendje Jetës Tjetër, sepse ata janë të zënë me jetën e kësaj bote dhe me bukuritë e saj. Ajo flet, gjithashtu, se si All-llahu i Madhërishëm i qorton njerëzit për këtë.

---

*34) Ju do të vazhdoni të përpiqeni t’i shumoni fitimet tuaja, derisa të hyni në varre e të lini pas shkëlqimin e tepruar të një jete të zbrazët.*

## KUPTIMI I FJALËVE

Të bindur plotësisht - Të bindur që një ditë do ta lënë këtë botë dhe do të shkojnë në Botën Tjetër.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Njerëzit, duke lakmuar të mirat e kësaj bote - pasurinë, fëmijët, bukuritë, dëfrimet e saj etj.- e harrojnë Botën Tjetër. Ata vazhdojnë kështu, derisa vdesin dhe bëhen banorë të varre-zave. All-llahu i Madhërishtëm i qorton njerëzit për këtë rrugë të gabuar. All-llahu i Madhërishtëm do t'u thotë atyre: *“Do t’u bëbet e qartë pas vdekjes suaj se me të vërtetë, keni qënë në rrugë të gabuar dhe kur të shihni dënimin e All-llahut të Madhërishtëm në varr dhe në Ditën e Kijametit, do të pendobe-ni.”* All-llahu i Madhërishtëm i qorton, gjithashtu këta njerëz: *“Në qoftë se ju do ta dinit dhe do ta përfytyronit dënimin e Botës tjetër, do t’i linët kufirin (mosbesimin) dhe dëfrimet. Vërtet, dënimi do t’ju vijë. Ai është një dënim i tmerrshëm, që të ngjall njëkohësisht respekt dhe frikë, njësoj sikur ju ta shihnit xhehenemin”.* Është e vërtetë se këta njerëz janë të pavëmendshëm e të paditur. Ata do ta shohin zjarrin e xhehe-nemit kur të hyjnë në të dhe do të binden për këtë në Ditën e Gjykimit.

Zjarri i xhehenemit ekziston dhe fjala e All-llahut është e drejtë dhe e vërtetë. All-llahu i Madhërishtëm do t'u thotë këtyre njerëzve: *“Me të vërtetë, begatia e kësaj bote ishte ajo, e cila ju largoi nga*

*besimi dhe nga arsyetimi i drejtë.*” Për këtë All-llahu i Madhërishëm do t’ju kërkojë llogari, si e shfrytëzuat këtë pasuri, a i ndihmuat të varfrit e të tjera.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishëm i qorton të gjithë ata njerëz, të cilët e kalojnë jetën e kësaj bote me lojë e argëtim.
2. Besimtarin nuk e pengon jeta e kësaj bote për të punuar për Botën Tjetër.
3. Kur’ani flet për Zjarrin aq qartë, sikur njeriu ta shihte atë.
4. Në Zjarr do të hyjnë jobesimtarët dhe të tjerë që kanë qenë të pakujdesshëm ndaj fesë islame.
5. All-llahu i Madhërishëm do t’i gjykojë njerëzit për qëndrimin që mbajtën ndaj begatave të kësaj bote, të cilat ua bënë atyre të këndshme këtë jetë dhe do t’u kërkojë llogari për detyrën që ata kishin: A e falenderuan All-llahun për këtë begati apo jo?

Kuptimin e kësaj që thamë e përforcon një ngjarje, e cila ka ndodhur me Profetin Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe me dy nga shokët e tij fisnikë: Një natë, i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) doli nga shtëpia dhe takoi Ebu Bekër Es Sidikun (All-llahu qoftë i kënaqur me të!).

“Ç’gjë të nxorri ty nga shtëpia, o Ebu Bekër?”

“Ajo gjë, e cila të nxori edhe ty, pra uria.”

Më pas doli nga shtëpia edhe Omeri (All-llahu qoftë i kënaqur me të!), të cilit i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) i bëri të njëjtën pyetje:

“E ç’gjë të nxori nga shtëpia në këtë orë, o Omer? “

Omeri iu përgjigj:

“Më nxori e njëjta gjë që ju nxori edhe ju të dy.”

I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe dy shokët e tij fisnikë u nisën për te shtëpia e njërit prej ensarëve, Ebu El Huthejme ibn Et Tejhan, i cili ndërkohë nuk ishte në shtëpi. Kur i pa, e shoqja i priti me: *“Mirë se vini!”*

I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) e pyeti gruan se ku ndodhej burri i saj. Ajo tha se kishte shkuar të mbushte ujë për të pirë. Më pas erdhi i zoti i shtëpisë.

“Falenderimi i takon All-llahut! S’kam pasur asnjëherë miq më të nderuar sa sot!”, - foli ai.

Burri doli e u kthye shumë shpejt, duke mbajtur hurma Qabeje ndër duar dhe një enë me ujë dhe iu drejtua atyre: *“Hani!”* Më pas mori thikën dhe u bë gati përsëri të dilte. *“Mos ther lopë me qumësht!”*, - i tha i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).

Burri theri për ta një dele e ata hëngrën e pinë sa deshën.

Kur u ngopën, panë njëri-tjetrin në sy dhe i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) u tha Ebu Bekrit dhe Omerit:

“Për All-llahun e Madhërishëm, në dorën e të Cilit është vetja ime, ju do të pyeteni për mirësinë e begatinë e sotme në Ditën e Gjykimit. Ai ju nxori nga shtëpia të uritur dhe nuk u kthyet derisa e arritët këtë mirësi, e larguat urinë dhe e shuaj-tët etjen.”

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. A duhet të vazhdojë njeriu të shkojë pas dëfrimeve në këtë botë?
2. A gëzohet All-llahu i Madhërishëm me njerëzit të cilët nuk i japin përparësi kësaj bote përpara Botës tjetër?
3. Çfarë kuptoni me thënien e All-llahut të Madhërishëm: “Pastaj, atë Ditë do të pyeteni për të mirat (që i keni lakmuar në këtë botë)?”
4. Përshkruajeni me fjalët tuaja historinë e të Dërguarit të All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe të dy shokëve të tij. Tregoni ç’mësojmë nga kjo histori.

## **SUREJA “EL ASR “**

(E zbritur në Mekë, ka 3 ajete)

Ajetet 1-3

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për kohën! 2. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurtë, 3. Përveç atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen së Vërtetës dhe që e këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për cilësitë e atyre që do të shpëtojnë në Ditën e Kijametit.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

Në këtë sure All-llahu i Madhërishtëm betohet për kohën, dhe veçanërisht për kohët e bekuara me vlerë të madhe, siç janë, për shembull, ditët kur ka jetuar Pejgamberi (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), falja e namazeve dhe adhurimet e tjera, si ramazani, ditët e Haxhit etj. All-llahu i Madhërishtëm na thotë se ka njerëz që janë të humbur në këtë botë dhe të poshtëruar në Botën Tjetër për shkak të punëve të tyre të këqija dhe largimit nga rruga e All-llahut të Madhërishtëm.

Por Ai na thotë, gjithashtu, se ka edhe njerëz që nuk janë të humbur dhe të poshtëruar. Këta janë njerëzit me veti e vepra të mira, janë ata që:

1. Besojnë All-llahun e Madhërishëm dhe të Dërguarin e Tij (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).
2. Bëjnë punë të mira dhe iu larguan punëve të këqija.
3. Udhëzojnë edhe të tjerët në rrugën e drejtë, i këshillojnë ata që të kapen tek e drejta, i pranojnë edhe vetë këshillat me drejtësi.
4. Bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në punë të mira.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. Nuk ka mirësi për njeriun që nuk beson dhe që nuk bën vepra të mira.
2. Muslimanët e vërtetë bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në të mira.
3. Muslimanët e vërtetë janë durimtarë gjatë adhurimit dhe thirrjes në Islam.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Vendosni në fjalitë e mëposhtme njëzën prej tri fjalëve të dhëna, që përshtaten: e drejtë, i poshtëruar, durimi.
  - a) Njeriu që nuk beson, (është në shkatërrim dhe në humb-je).
  - b) Është detyrë për muslimanin (të përballojë problemet dhe vështirësitë).
  - c) Muslimanët bashkëpunojnë (në punë të mira dhe në adhurim).
2. Sureja përmend katër gjëra që e bëjnë njeriun besimtar të vërtetë dhe të fituar. Përmendni tri prej tyre.
3. Tregoni cila prej fjalive të mëposhtme është e saktë dhe cila është e gabuar:
  - a) Të gjithë njerëzit janë të fituar dhe të gëzuar .....
  - b) Bashkëpunimi në të mira është punë e pëlqyer .....
  - c) Durimi nuk është i dobishëm .....

## **SUREJA “EL HUMEZE “**

(E zbritur në Mekë, ka 9 ajete)

Ajetet 1 - 9

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Mjerë për atë që fyen e përqesh (njerëzit), 2. Që tubon pasuri dhe e ruan të mos i pakësohet 3. E, mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm! 4. Jo, të mos mendojë ashtu! Ai patjetër do të hidhet në Hutame. 5. A e dini se ç'është Hutameja? 6. Është zjarri i All-llahut që është ndezur fort, 7. Që depërton deri në thelb të zemrës. 8. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. 9. Ata janë të lidhur në pranga të njëpas-njëshme...

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për disa veti të këqija dhe për ardhmërinë e atij që i ka këto veti.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Hutame - Zjarri i xhehenemit.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Islami na mëson që të ndjekim moralin dhe edukatën e mirë. Ai e ndalon bisedën me fjalë të këqija për të tjerët, që shkaktojnë zemërimin e njerëzve kur i dëgjojnë, madje edhe kur ato fjalë janë të vërteta e të sakta.

Nuk i lejohet kurrsesi muslimanit që të përmendë të metat trupore të të tjerëve. Me të vërtetë, kështu zemërohet All-llahu, sepse të gjitha krijesat janë të All-llahut të Madhërishëm.

All-llahu i Madhërishëm na ka sqaruar në këtë sure se Ai ka përgatitur një dënim të rreptë për cilindo që tregon të metat e njerëzve me gjuhën, me dorën a me syrin e tij, siç bënin jobesimtarët me muslimanët.

All-llahu ka përgatitur, gjithashtu, dënim të rreptë për cilin-do që iu vë njerëzve nofka e tallet me ta. Këto krijesa, që tallen me të tjerët dhe përpiqen që të mbledhin pasuri duke u krenuar me të, mendojnë se pasuria e tyre e madhe i lejon që të tallen me të tjerët. Ideja se pasuria e tyre do t'i mbrojë ata nga dënimi, është një ide shumë e keqe. Por, All-llahu i Madhërishëm ua kthen atyre: *“Jo, nuk është ashtu siç mendojnë! Ata do të hyjnë në zjarrin e xhebenemit, që ua shkatërron trupat. Dënimi i zjarrit do të jetë i ashpër; ai do t’ua djegë trupat nga jashtë e nga brenda. Jobesimtarët nuk do të dalin kurrë prej Zjarrit, sepse ata do të lidhen me pranga dhe dyert e xhebenemit do të mbyllen përgjithnjë për ta.”*

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Islami e ndalon talljen e njerëzve dhe përmendjen e të metave të tyre.
2. Shumimi i pasurisë nuk e ruan pronarin e saj nga vdekja dhe nga dënimi.
3. Jobsimtarët do të futen në Zjarr dhe trupat e tyre do të digjen.
4. Dyert e Zjarrit do të mbyllen për banorët e tij.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Ç'kuptim ka fjala Hutame?
2. Vlerësoni nëse janë të sakta ose të gabuara fjalët e më-poshtme:
  - a) Nuk lejohet për muslimanin të tallet me vëllanë e tij musliman.
  - b) Jobsimtari do të mbrohet me pasurinë e tij në Ditën e Kijametit.
  - c) Jobsimtarët do të dalin nga Zjarri.
3. Vendosni fjalët e grupit të parë A që t'i përshtaten grupit të dytë B, kur lidhen me njëra-tjetrën.

## **SUREJA “EL FIL”**

(E zbritur në Mekë, ka 5 ajete)

Ajetet 1 - 5

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me zotëruesit e elefantit? 2. A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar? 3. Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë. 4. Dhe i gjuanin ata me baltë të gurëzuar. 5. Dhe i bëri ata si gjethi i grimcuar.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure flet për pronarët e elefantit dhe për dënimin që All-llahu u dha atyre.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Pronarët e elefantit - Ebreheja dhe ushtarët e tij.

Kurthi i tyre - Mashtrimi i tyre.

Humbje - Shkatërrim, poshtërim.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

Ibrahimi (paqja e All-llahut qoftë mbi të) ndërtoi Qaben e nderuar sipas urdhrit të marrë nga All-llahu i Madhërishëm. Populli arab e respektonte Qaben, bënte Haxh në të, por në të njëjtën kohë i bënte shok All-llahut të Madhërishëm.

Ka qenë në Jemen një mbret që quhej Ebrehe El Eshrem. Mbreti ndërtoi një kishë të madhe, që njerëzit ta bënin një vend adhurimi. Për t'ia arritur këtij qëllimi, Ebreheja urdhëroi që të prishej Qabja e Nderuar, kështu që arabët ta linin atë dhe të ktheheshin nga kisha që ai ndërtoi.

Pasi përgatiti një ushtri të madhe, Ebreheja iu afrua Mekës nga anët e saj. Në ushtrinë e tij ishte edhe një elefant shumë i madh. Kur ushtarët iu afruan Mekës, elefanti ndaloi dhe nuk eci më drejt Qabes, sepse All-llahu i Madhërishëm e ndaloi atë. Në çastin kur ushtria e Ebrehesë u bë gati për të sulmuar drejt Mekës, All-llahu i Madhërishëm dërgoi mbi ta shpendë që i godisnin me baltë të gurëzuar nga xhehenemi, derisa i shndërruan trupat e tyre në gjethe të grimcuara. Kafshët i shkelën me këmbë dhe hëngrën prej tyre sa deshën. All-llahu i Madhërishëm i ndaloi hapat dhe ua vrau shpresat atyre. Pra, All-llahu i Madhëri-shëm e shkatërroi në një mënyrë të tmerrshme ushtrinë e Ebrehesë, duke siguruar kështu Qaben e nderuar prej këtyre të këqijave.

All-llahu i Lartësuar ua përmend arabëve këtë ndodhi, që t'i sqarojë ata se është Ai që mbrojt Qaben dhe që e shkatërroi ushtrinë e Ebrehesë dhe jo idhujt, të cilët ata i adhuronin, që janë gurë. All-llahu kujton kështu mirësinë e Tij ndaj tyre dhe ndaj etërve të tyre.

All-llahu iu kujton banorëve të Mekës, se vërtet, Ai është gati të shkatërrojë jobesimtarët, që luftojnë Islamin, ashtu siç veproi me zotëruesit e elefantit.

## **Ç'NA MËSOJNË AJETET**

1. All-llahu i Madhërishëm e mbron Qaben e Nderuar prej çdo të keqeje.
2. All-llahu i Madhërishëm e shkatërroi ushtrinë e Ebrehesë në një mënyrë sa të habitshme aq edhe të frikshme dhe të tmerrshme.
3. Sureja u kujton banorëve të Mekës të mirat e All-llahut ndaj tyre, kur i shkatërroi armiqtë e tyre.
4. Kjo sure i nxit muslimanët dhe i ndërgjegjëson ata se All-llahu i Madhërishëm do t'i mbrojë gjithmonë ata në fenë e Tij.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Ku gjendet Qabja e Nderuar?
2. Kush e ndërtoi Qaben e Nderuar?
3. Në ç'vit lindi i Dërguari i All-llahut të Madhërishëm?
4. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalët e dhëna: shpendët, shokët, me gurë.
  - a) Ne jemi muslimanë që pasojmë ..... e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).
  - b) Pashë mbi pemë ..... të bukur
  - c) Muslimanët ndërtuan një xhami të madhe .....

## **SUREJA “KUREJSH “**

(E zbritur në Mekë, me 4 ajete)

Ajetet 1 - 4

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për hir të garancisë që gëzojnë kurejshët!<sup>35</sup> 2. Garancinë e udhëtimit të tyre të lirë të dimrit dhe të verës. 3. Le ta adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie, 4. I cili i ushqen pas urisë dhe i siguron prej çdo frike!

## PËRMBAJTJA E SURES

Sureja flet për lëvizjet e kurejshëve tregtarë dhe për begatitë që Zoti u kishte dhënë atyre.

## KUPTIMI I FJALËVE

I siguron - I ruan.

Kurejshët - Banorët e Mekës.

---

*35) Kurejshët ishin fisi më fisnik i Arabisë, fisi të cilit i përkiste edhe vetë Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Ata kujdeseshin për Qaben, kryevendin e shenjtë të Arabisë dhe duke zotëruar Mekën, ata kishin tri përparësi: 1) Kishin një ndikim udhëheqës mbi fiset e tjera; 2) Pozicioni qendror ua lehtësonte tregtinë dhe marrëdhëniet me fiset a me vendet e tjera, gjë që u jepte nder e respekt, ashtu edhe përfitime materiale; 3) Duke qenë se, sipas traditës arabe territori i Mekës ishte i pacenueshëm nga shkatërrimet e luftës dhe gjakmarrjet, pozicioni i tyre ishte i sigurtë, larg frikës e rrezikut. Të gjitha këto ua kishte bërë risk All-llahu, ua kishte garantuar Ai. Është pikërisht kjo garancia për të cilën betohet All-llahu në fillimin e kësaj sureje.*

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Kjo sure flet për begatitë që All-llahu i Madhërishtëm ua dhuroi banorëve të Mekës. All-llahu i Madhërishtëm e dëshiroi udhëtimin e banorëve të Mekës dhe ua lehtësoi atë atyre. Ata udhëtonin dimrit për në vendet e Jemenit dhe verës për në vendet e Shamit (Siri, Palestinë, Liban etj.). Këto lëvizje ishin shumë të dobishme për idhujtarët kurejshë, sepse bënë tregti në to. All-llahu i Madhërishtëm i furnizoi banorët e Mekës, kur i udhëzoi ata në këto lëvizje, ua lehtësonte atyre rrugën dhe ua largonte urinë. Ai e bëri vendin e tyre (Mekën) të siguar; rrugën e tyre për të qarkulluar, të sigurtë. Njerëzit i respektonin kurejshët, sepse ata banonin në Qaben e Nderuar, i shërbenin asaj dhe e ruanin atë. All-llahu i Madhërishtëm largoi urinë dhe frikën nga kurejshët dhe i begatoi ata me siguri, shpresë dhe risk. Të gjithë njerëzit kishin respekt për kurejshët.

Banorëve të Mekës iu dhuruan shumë mirësi nga All-llahu, prandaj ata duhej ta adhuronin All-llahun e Madhërishtëm dhe të mos i bënin shok Atij. Ata nuk duhej të adhuronin idhujt, të cilët nuk i sillnin atyre as dëm e as dobi.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishtëm i nderoi kurejshët me risk, sepse ata janë banorët e Mekës. (Shtëpisë së Tij të Shenjtë).

2. Për kurejshët kishte dy udhëtime, njëra në dimër, për në Jemen dhe tjetra në verë, për në vendet e Shamit.
3. Është detyrë për të gjithë njerëzit që të falënderojnë All-llahun e Madhërishëm për begatitë e Tij të shumta dhe t'ia drejtojnë adhurimin e tyre vetëm Atij.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Për ku udhëtonin tregtarët kurejshë në verë?
2. Edhe i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ka udhëtuar me tregtarët kurejshë në udhëtimet e tyre. A e dini për ku?
3. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalët e përshtatshme që janë në sure:
  - a) Profeti Muhammed është prej .....
  - b) Në ..... bën më ftohtë se në stinët e tjera të vitit.
  - c) Frutat shtohen në .....
4. All-llahu i Madhërishëm i begatoi banorët e Mekës me dy mirësi. Cilat janë ato?
5. Çfarë kërkoi All-llahu i Madhërishëm prej banorëve të Mekës?

## **SUREJA “EL MAUN “**

(E zbritur në Mekë, ka 7 ajete)

Ajetet 1 - 7

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. A e ke parë atë, që përgënjeshton përgjegjësinë dhe llogarinë në Botën Tjetër? 2. Po atë që e përze në mënyrë të vrazhdë jetimin 3. Dhe nuk nxit për të ushqyer të varfrin? 4. Të shkatërruar janë ata që falen, 5. Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm. 6. Ata që vetëm shtiren 7. Dhe nuk japin as gjënë më të vogël (as hua).

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për disa cilësi të njerëzve të poshtëruar.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Të pakujdesshëm - Që nuk falen në kohën e duhur; që e lënë namazin pas dore.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Kjo sure sqaron se ai që nuk beson në Ditën e Gjykimit dhe të Shpërblimit bën veprime të shëmtuara; ai nuk mendon asnjëherë për të bërë veprime të mira, por bën vetëm të këqija.

Prej punëve të këqija të këtij njeriu është: sjellja shumë e keqe me jetimët; atij nuk i vjen keq për ta dhe nuk i ndihmon asnjëherë ata. Një njeri i tillë nuk u jep ushqim dhe ndihmë të mjerëve dhe atyre që kanë nevojë dhe nuk i nxit njerëzit e tjerë që të ndihmojnë të dobëtit.

Për fat të keq, këto vese janë edhe në mesin e muslimanëve. All-llahu i Madhërishëm përmend në këtë sure se Ai ka përgatitur një dënim shumë të rreptë për ata që nuk i japin rëndësi namazit dhe që nuk falen në kohën e duhur.

Në të vërtetë, ata që nuk i kryejnë namazet në kohën e duhur dhe nuk janë të kujdesshëm dhe të përlulur gjatë faljes, janë hipokritë. Të tillë njerëz i japin rëndësi vetëm dukjes, shfaqjes para njerëzve dhe nuk i kushtojnë fare rëndësi faktit që të kënaqet All-llahu me ta. Ata nuk besojnë se All-llahu i Madhërishëm do t'u kërkojë llogari për punët e tyre. Edhe këta që falen dhe që nuk i kushtojnë rëndësi faljes ose kohës së saj janë njerëz që nuk punojnë për hir të Zotit. Ata nuk i ndihmojnë njerëzit nevojtarë për nevojat që ata kanë.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Njeriu i keq nuk bën vepra të mira.
2. Islami na thërret për të shprehur keqardhje ndaj jetimit dhe për ta ndihmuar atë.
3. Muslimani i vërtetë i ndihmon nevojtarët dhe i nxit njerë-zit për t'i ndihmuar ata.
4. Ata, që nuk kujdesen për namazet e tyre janë përgënje-shtrues dhe për ta është përgatitur një dënim i rreptë.
5. Muslimanët e vërtetë e ndihmojnë njëri-tjetrin.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Përmendni dy çështje që na mëson kjo sure.
2. Përmendni dy cilësi të njeriut që nuk beson në Ditën e Gjykimit.
3. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me njërën prej fjalëve që janë në mes të kllapave:
  - a) Muslimani ..... të ndihmojë të varfrit. (dëshiron, nuk pranon, harron).
  - b) Dyfytyraku ..... në namazin e tij. (përqendrohet, shtiret)
  - c) Islami na porositi që të shprehim keqardhje dhe ta ndihmojmë ..... (jobesimtarin, jetimin).

## **SUREJA “EL KEUTHER “**

(E zbritur në Mekë, ka 3 ajete)

Ajetet 1- 3

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Ne, vërtet të dhamë ty Keutherin. 2. Prandaj, ti falu dhe bëj kurban për hir të Zotit tënd. 3. E s’ka dyshim se urrejtësi yt është farëhumbur.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për nderimin që i bën All-llahu të Dërguarit të Tij.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Keutheri - Lumë i madh në xhenet.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Në këtë sure, All-llahu i Madhërishëm e përgëzon të Dërguarin: “Me të vërtetë, All-llahu të dha mirësi të shumta dhe prej këtyre mirësive është një lumë i madh në xhenet.” I Dërguari i All-llahut thotë: “Është një lumë në xhenet, që ma ka premtuar All-llahu i Madhërishëm, në të cilin ka mirësi të shumta.” (Muslimi) Nga uji i tij i shijshëm do të begatohen i Dërguari dhe muslimanët. All-llahu i Madhërishëm e ka nderuar shumë Profetin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe ka kërkuar prej tij që ta falenderonte Krijuesin e vet dhe të falej për Të e të bënte kurban për hir të shpërblimit dhe të kënaqësisë së Tij.

Kështu duhet të veprojë çdo musliman: të falënderojë Zotin, të falë namazet dhe të bëjë kurban me bindje të plotë ndaj Tij.

All-llahu i Madhërishëm e ka nderuar të Dërguarin e Tij në këtë botë, kur e bëri të ftojë të tjerët për në rrugën e drejtë, dhe e ka vendosur emrin e tij pranë Emrit të Vet, që të kujtohet gjatë thirrjes së ezanit pesë herë në ditë, në çdo skaj të botës. Nuk kalon orë pa u përmendur i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), sepse në vende të ndryshme namazi falet në kohë të ndryshme.

## SUREJA “EL KAFIRUN “

(E zbritur në Mekë, ka 6 ajete)

Ajetet 1 - 6

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Thuaj: “O, ju jobesimtarë!” 2. Unë nuk adhuroj atë që adhuroni ju! 3. As ju nuk adhuroni Atë që adhuroj unë. 4. Unë kurrë nuk do ta adhuroj atë që adhuroni ju. 5. Por dhe ju nuk do ta adhuroni Atë që unë adhuroj. 6. Ju keni fenë tuaj e unë kam fenë time.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure flet për propozimin që bënë jobesimtarët për adhurimin e idhujve dhe se si Zoti nuk ua pranoi atë.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

All-llahu i Madhërishtëm dërgoi Profetin Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) të jobesimtarët kurejshë, që t'i ftonte ata të linin adhurimin e idhujve dhe t'i ktheheshin All-llahut të Madhërishtëm, që është Një e i Pashok. Por jobesim-tarët kurejshë nuk e pranuan ftesën e Muhammedit dhe vijuan të adhuronin idhujt. Pasi u menduan mirë, disa prej kryetarëve kurejshë i propozuan Pejgamberit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që për një vit të

pranonin Islamin dhe të bashko-heshin me muslimanët në adhurimin e Një Zoti të Vetëm; më pas, i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe muslimanët duhej të përqafonin fenë e jobesimta-rëve kurejshë dhe të merrnin pjesë me ta në adhurimin e idhuj-ve të tyre, gjithashtu për një vit. Jobesimtarët menduan që kjo zgjidhje do t'i gëzonte muslimanët dhe me këtë rast do të shuh-ej konflikti midis tyre. All-llahu i Madhërishtëm i zbriti këtë sure Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe kërkoi prej tij që të mos e pranonte në asnjë mënyrë propozimin e jobesimtarëve kurejshë. All-llahu i Madhërishtëm e urdhëroi të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që t'u thoshte jobesimtarëve kurejshë se nuk mund të adhuronin idhujt që adhuronin ata. All-llahu i Madhërishtëm nuk pranon kurrë që të adhurohen së bashku me Të edhe idhujt.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Islami fton në adhurimin e All-llahut, që është Një.
2. Nuk lejohet që ta përziejmë Islamin me fetë e tjera boshe.
3. Gjykimi i njëanshëm i çonte femohuesit kurejshë në propozime absurde.

## **PYETJE DHE USHTRIME**

1. Çfarë adhuronin idhujtarët kurejshë?
2. Çfarë adhuronte i Dërguari (paqja e All-llahut dhe beki-mi i All-llahut qofshin mbi të)?
3. Çfarë i propozuan idhujtarët kurejshë të Dërguarit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të)?
4. A e pranoi i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) propozimin e idhujtarëve kurejshë? Pse?
5. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalët e përshtatshme që janë në sure:
  - a. Unë nuk ..... veç All-llahun e Madhërishëm.
  - b. Ruhuni nga .....

## **SUREJA “EN NASR “**

(E zbritur në Medine, ka 3 ajete)

Ajetet 1 - 3

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur erdhi ndihma e All-llahut dhe çlirimi. 2. Dhe i pe njerëzit që po hynin turma-turma në fenë e All-llahut. 3. Lartësoje, pra, Zotin tënd duke e falënderuar dhe kërko falje prej Tij. Ai e pranon shumë pendimin dhe është Mëshirues i Madh.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja flet për ndihmën që All-llahu u dha muslimanëve për të çliruar Mekën dhe për të përqafuar Islamin.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

Kanë qenë banorët e Mekës ata që patën adhuruar idhujt dhe që i kishin vënë ato brenda Qabes së Nderuar. Meka ishte kryeqendra arabe në kohën e Padijes (para Islamit), për arsye se shtëpia e Zotit qe ndërtuar atje. Jobesimtarët kurejshë nuk e pranuan Islamin qysh në fillim. I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dhe muslimanët e Mekës emigruan në qytetin e Medines dhe pas tetë vjetësh i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) u kthye në Mekë, në krye të muslimanëve. Kur u futën në Mekë, ata i thyen të gjithë idhujt. Në këtë kohë të gjithë banorët e Mekës e pranuan Islamin. Kur pjesa tjetër e popullit arab

mësoi për këtë gjë dhe e njohu Islamin, filluan të vinin grupe-grupe duke e pranuar haptazi Islamin.

All-llahu i Madhërishëm i drejtohet Muhammedit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që të përgatitet të takojë Krijuesin e tij, pasi e kishte transmetuar mesazhin dhe e kishte çuar në vend amanetin. All-llahu i Madhërishëm i thotë të Dërguarit të Tij: *“Zoti ta çliroi ty Mekën dhe t’i realizoi ty shpresat, bëri që arabët të largohen nga shirku dhe adhurimi i idhujve; ti i pe arabët të vinin si muslimanë të bindur; prandaj përmende All-llahun e Madhërishëm shpesh e më shpesh. Kërko falje prej Tij, falenderoje Atë për ndihmën dhe suksesin që të dha. All-llahu është Mëshirues i Madh; Ai i fal ata që pendohen.”*

Pas kësaj sureje kanë zbritur vetëm pak ajete.

## Ç’NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishëm ia dha të Dërguarit të Tij çfarë i pati premtuar; e ndihmoi atë kundër jobesimtarëve dhe ia çliroi Mekën e nderuar.
2. All-llahu i Madhërishëm kërkoi prej të Dërguarit të Tij që t’i shtonte falënderimet dhe të kërkonte falje nga All-llahu.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Meka e nderuar është qyteti më i madh i shenjtë në rruzullin tokësor. A e di pse?
2. Cila është ajo shtyllë e Islamit, të cilën muslimanët mund ta plotësojnë vetëm duke shkuar në Mekë?
3. Plotësoni fjalitë vijuese me njëren nga fjalët e përshtatshme: Meka, arabët, i tetë.
  - a) Njerëzit, të cilët përqaftuan fenë e All-llahut grupe-grupe, ishin .....
  - b) I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) hyri në Mekën e Nderuar në vitin .....
  - c) Çlirimi më i madh i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) është çlirimi i .....

## SUREJA “EL MESED”

(E zbritur në Mekë, ka 5 ajete)

Ajetet 1 - 5

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi e i shkatërruar është ai!
2. Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet e as ajo që fitoi.
3. Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë.
4. Edhe gruaja e tij, ajo që barti dru.
5. Në qafën e saj ajo do të ketë një litar të përdredhur.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure flet për femohuesin Ebu Leheb dhe për gruan e tij.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Ebu Leheb - Emri tij i vërtetë është Abdul Izza, i biri i Abdul-Mutalibit dhe xhaxhai i Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).

Gruaja e tij - Gruaja e Ebu Lehebit, Ummu Xhemileja.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ka pasur një xhaxha jobesimtar, që thërritej me emrin Ebu Leheb. Ebu Lehebi e luftonte të Dërguarin e All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) me egërsi. Kur i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) dilte për të ftuar njerëzit në fenë e All-llahut, Ebu Lehebi i shkonte pas dhe u thoshte njerëzve se Pejgamberi na qenkësh gënje-shtar, prandaj të mos i besonin atij. Ebu Lehebi kishte një grua të keqe, jobesimtare, që e thërrisnin Ummu Xhemile. Edhe ajo e shqetësonte të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Çfarë bënte ajo? Me një urrejtje të madhe, ajo vendos-te në rrugën para shtëpisë së Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ferra, gurë dhe mbeturina të ndryshme dhe kur dilte i Dërguari (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), e gjente rrugën të mbushur plot.

All-llahu i Madhërishëm i zbriti Pejgamberit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) këtë sure që të sqaronte se Ebu Lehebi ishte i humbur, i shkatërruar dhe se do të hynte në Zjarr për shkak të mosbesimit e të punëve të tij të këqija dhe për armiqësinë që shfaqte ndaj të Dërguarit të All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të). Ebu Lehebit nuk do t'i bënin dobi pasuria, dhe as djemtë e ndihmëtarët e tij. Për të ishte përgatitur dënimi i All-llahut. Edhe gruaja e tij, e cila vendoste ferra, gurë dhe mbeturina në rrugën e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), do të ndëshkohet mjaft rreptë.

Engjëjt do t'i venë një litar në zverk dhe do ta tërheqin atë për në zjarrin e xhehenemit.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Kushdo që e lufton të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), do të hyjë në Zjarr.
2. Ditën e Kijametit, njeriut të keq nuk do t'i bëjë dobi as pasuria dhe as djemtë e tij edhe pse ka qenë i afërm i Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).
3. Ebu Lehebi dhe e shoqja, Ummu Xhemilja, do të hyjnë në Zjarr.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Çfarë lidhje farefisnore kishte mes Profetit dhe Ebu Lehe-bit?
2. A do t'i bëjë dobi lidhja farefisnore Ebu Lehebit?
3. Si e shqetësonte Ummu Xhemilja të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të)?
4. Çfarë do t'i vihet në qafë Ummu Xhemiles në Ditën e Gjykimit?
5. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalë të përshtatshme, që janë mes dy kllapave:  
a) Ebu Lehebi ka qenë ..... i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) (armik, shok)

- b) Gruaja e Ebu Lehebit ..... të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) (e respektonte, e shqetësonte).
- c) Ebu Lehebi dhe e shoqja do të hyjnë në ..... (xhenet, Zjarr).

## **SUREJA “EL IHLAS “**

(E zbritur në Mekë, ka 4 ajete)

Ajetet 1 - 4

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Thuaj: “All-llahu është Një.” 2. All-llahu është Ai, të Cilit i drejtohet (mbështetet) çdo krijesë për çdo nevojë. 3. Ai as nuk ka lindur kënd e as është i lindur. 4. Askush dhe asgjë nuk është si Ai.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Kjo sure tregon për disa cilësi që i takojnë vetëm All-llahut të Madhërishtëm.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) i ftoi të gjithë njerëzit që të adhuronin All-llahun e Madhërishtëm, që është Një e i Vetëm. Kurse, përpara Islamit, njerëzit i bënë shok All-llahut, duke adhuruar idhuj. Disa prej idhujtarëve e pyetën të Dërguarin (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) për All-llahun e Madhërishtëm. All-llahu i Madhërishtëm zbriti këtë sure të madhe.

Sureja sqaron se vetëm All-llahu i Madhërishtëm duhet të adhurohet, se askush dhe asgjë nuk është si Ai, se vetëm All-llahut duhet t'i lutemi, se vetëm All-llahut duhet t'i bindemi.

Sureja sqaron gjithashtu, se All-llahu i Madhërishtëm është Një. Për Të kanë nevojë të gjitha krijesat. Krijuesi është Ai, të Cilit të gjitha krijesat i drejtohen për plotësimin e nevojave të tyre e jo idhujt, të adhuruar e të deklaruar si zota.

Sureja sqaron po ashtu se All-llahu i Madhërishtëm nuk ka fëmijë, Ai nuk ka bashkëshorte. All-llahu i Madhërishtëm nuk është i lindur, nuk ka as baba dhe as nënë dhe as nuk duhet çuar nëpër mend se All-llahu është i lindur nga dikush. Këto cilësi të All-llahut të Madhërishtëm tregojnë se Ai nuk ka asnjëfarë ngjashmërie me krijesat.

I krijuari, i cili ka nevojë për të tjerët, është i dobët dhe nuk mund të jetë i adhuruar. I krijuari, i cili ngjan me të krijuar të tjerë, nuk mund të adhurohet. Ai që lind dhe formohet në barkun e së ëmës, nuk mund të adhurohet.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu i Madhërishëm është i Vetmi të Cilit i përket adhurimi ynë; Ai ka krijuar çdo gjë që e shohim dhe që nuk e shohim.
2. Sureja “El Ihlas” barazohet me një të tretën e Kur’anit, siç ka thënë i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të).
3. All-llahu i Madhërishëm nuk ka as fëmijë, as baba e as nënë.
4. Askush dhe asgjë nuk i ngjan All-llahut të Madhërishëm.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Plotësoni pikat me njërën prej fjalëve vijuese: Mesiu, baba, i ngjason.
  - a) Nuk ka ndonjë të krijuar që ..... All-llahut të Madhëri-shëm
  - b) Të krishterët thonë se ..... është biri i Zotit.
  - c) All-llahu i Madhërishëm nuk ka ..... dhe as nënë.
2. Tregoni se cila prej fjalive të mëposhtme është e saktë ose e gabuar:

- a) All-llahu i Madhërishëm është Një; për të kanë nevojë të gjitha krijesat, kurse All-llahu i Madhërishëm nuk ka nevojë për ta.
- b) Sureja “El-Ihlas” është e barabartë me një të tretën e Kur’anit.
- c) Ai që thotë se krijesat i ngjajnë All-llahut të Madhëri-shëm, do të hyjë në Zjarr.

## **SUREJA “EL FELEK “**

(E zbritur në Mekë, ka 5 ajete)

Ajetet 1 - 5

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Thuaj: “I mbështetem Zotit të agimit” 2. Prej dëmit të çdo krijese që Ai krijoi, 3. Prej errësirës së natës që Ai krijoi, 4. Prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja 5. Dhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron.

## **PËRMBAJTJA E SURES**

Sureja tregon se, për t'u mbrojtur nga të këqijat e krije-save, duhet të kërkojmë ndihmë vetëm prej All-llahut të Madhëri-shëm.

## **KUPTIMI I FJALËVE**

Mbështetem - Kërkoj mbrojtje

Fryjnë nyja - Bëjnë nyje për magji.

## **KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES**

Në këtë botë ka shumë prej krijesave që u shkaktojnë njerëzve lëndime e të këqija të ndryshme. Në këtë sure muslimanët sqarohen se si të shpëtojnë prej këtyre të këqijave. All-llahu i Madhëri-shëm mëson të Dërguarin e tij dhe të gjithë muslimanët se si të ruhen prej krijesave që janë të prirura për t'u shkaktuar të këqija të tjerëve. Muslimani kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhëri-shëm, sepse Ai është Krijuesi dhe Sunduesi i tyre dhe është i Plotfuqishëm mbi to. Muslimani i mirë, që e ruan veten e tij prej të këqijave, e fillon ditën e tij duke kërkuar ndihmën e

All-llahut të Madhërishëm, sepse vetëm Ai është Krijues i çdo gjëje dhe Sunduesi i të gjitha krijesave.

Edhe kur vjen errësira e natës, muslimani përsëri kërkon mbrojtje prej All-llahut të Madhërishëm, sepse kafshët e egra dalin natën; njerëzit e këqinj dalin natën për të bërë të këqija. Prandaj muslimani mbështetet tek All-llahu i Madhërishëm dhe i lutet Atij me bindje e përkushtim, me qëllim që ta ruajë atë ditën dhe natën.

Kjo sure e porositi muslimanin që të kërkojë ndihmë nga All-llahu i Madhërishëm për të siguruar mbrojtjen e Tij edhe prej së keqes së magjisë, që e bëjnë njerëz të këqinj, me sjellje dhe moral të keq. Në qoftë se muslimani kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhërishëm prej magjisë, Ai do ta mbrojë dhe do ta ruajë nga e keqja e saj. Magjistarët u përpoqën që t'i bënin keq Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të), por All-llahu i Madhërishëm e ruajti atë nga e keqja që deshën t'i bënin dhe e shpëtoi atë nga ata.

Muslimani kërkon prej All-llahut të Madhërishëm dhe e lut Atë që ta mbrojë edhe nga e keqja e smirës dhe nga smirëkëqinjtë, të cilët nuk ua duan të mirën të tjerëve, madje edhe zymtohen kur i shohin ata të gëzuar. All-llahu i Madhërishëm do ta ruajë muslimanin, në qoftë se i drejtohet Atij dhe kërkon prej Tij.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. Muslimani kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhërishtëm dhe kthehet nga Ai që ta ruajë nga shqetësimet dhe të këqijat.
2. Muslimani mbështetet te mbrojtja e All-llahut të Madhërishtëm prej së keqes që vjen natën, nga kafshët dhe nga njerëzit e këqinj.
3. Magjia është e ndaluar dhe muslimani duhet të kërkojë mbrojtje nga All-llahu që ta ruajë prej saj.
4. Smira është e ndaluar dhe muslimani e ka për detyrë të kërkojë mbrojtje nga All-llahu i Madhërishtëm që ta ruajë nga smira dhe smirëkëqinjët.

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Bëni fjali me fjalët e mëposhtme:
  - a) Në All-llahun, prej sherrit mbrohem, te krijesat.
  - b) Njeri, smirëkeqi, urrejtësi i tij.
  - c) Ateist, magjistari, në All-llahun.

2. Vendosni fjalët e mëposhtme në vendin e duhur, në fjalitë vijuese: smira, magjistari, nata.

a) Mos i besoj ..... .

b) ..... cilësi e keqe.

c) Kafshët e egra dalin .....

3. Vendosni fjalët e grupit të parë (A), që t'u përshtaten fjalëve të grupit të dytë (B), kur lidhen:

4. Gjeni hadithin e Profetit (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) që flet për ndalimin e smirës ndër muslimanë dhe shkruajeni atë.

A

Mbrohem në All-llahun

Smira

Magjistarët

B

Gënjejnë njerëzit

Prej njerëzve të këqinj

E ndaluar

## **SUREJA “EN NAS “**

(E zbritur në Mekë, ka 6 ajete)

Ajetet 1 - 6

Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Thuaj: “Mbështetem (mbrohem) në Zotin e njerëzve. 2. Sunduesin e njerëzve. 3. Të adhuruarin e njerëzve. 4. Prej së keqes së cytësit që fshihet, 5. I cili cyt zemrat e njerëzve, 6. Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit.

## KUPTIMI I FJALËVE

Cytësi - Shejtani, i cili fut në zemrat e njerëzve mendime të këqija.

## KOMENTIM I PËRGJITHSHËM I SURES

Sureja përmban udhëzime që All-llahu i Madhërishëm ia jep çdo muslimani. Njeriu kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhërishëm prej së keqes së shejtanëve, të cilët i ftojnë njerëzit në veprime të liga dhe e nxisin njeriun për mendime të këqija, që bien në kundërshtim me fenë.

Në qoftë se muslimani kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhërishëm dhe e kujton Atë, Shejtani largohet dhe fshihet. E në qoftë se muslimani nuk kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhërishëm, atëherë atij i vjen Shejtani e ia kujton punët e liga, e nxit për të bërë punë të tilla dhe e drejton atë në rrugën e së keqes. Ka edhe njerëz që i nxisin të tjerët në veprime të këqija dhe duke u treguar atyre rrugën drejt shkatërrimit. Këta janë shejtanët njerëz. Muslimani nuk duhet të shoqërohet me

njerëz të tillë, sepse ata janë shkatërrimtarë. Muslimani duhet të mbrohet me All-llahun e Madhërishtëm dhe të kërkojë ndihmë nga Ai prej të keqes së tyre.

## Ç'NA MËSOJNË AJETET

1. All-llahu është Krijuesi i njerëzve; është Ai që i rregullon punët e tyre.
2. Muslimani kërkon mbrojtje nga All-llahu i Madhërishtëm, që ta mbrojë prej së keqes së Shejtanit.
3. Njerëzit që thërrasin për shkatërrim dhe nxisin për vepra të këqija janë shejtanë.
4. Kujto All-llahun e Madhërishtëm, që të të largohet Shej-tani.
5. Kjo sure dhe sureja përpara saj (Sureja “El-Felek”) janë dy sure të mëdha.

I Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) ka thënë se vërtet këto dy sure kanë mirësi të madhe. Ai thekson: *“A nuk i ke parë ajetet e All-llahut që më kanë zbritur mbrëmë natën dhe që nuk janë parë asnjëherë më parë? Ato janë Sureja “El-Felek” dhe Sureja “En-Nas.”* (Transmeton Musli-mi)

## PYETJE DHE USHTRIME

1. Plotësoni pikat me fjalët që janë në sure:

a) All-llahu është Krijuesi i njerëzve, ..... i njerëzve, ..... i njerëzve.

b) Shejtani ..... njeriun të bëjë vepra të këqija.

c) Shejtanët, të cilët i thërrasin njerëzit në shkatërrime, janë nga xhinë dhe nga .....

2. Çfarë ka thënë i Dërguari i All-llahut (paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të) për suren “En Nas”?

3. Kur largohet Shejtani nga muslimanët?